




Raport i Gjendjes së Mjedisit 2006 - 2007



MINISTRIA E MJEDISIT
DHE PLANIFIKIMIT
HAPËSINOR



AGJENCIA E KOSOVËS
PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT



**Raport i Gjendjes së Mjedisit
2006-2007**

Prishtinë 2008

Përmbajtja

Raporti i gjendjes së mjedisit 2006-2007.....	2
Fjala e Ministrit.....	8
Fjala e Kryeshefit.....	9
Hyrje.....	10
Hartuesit dhe bashkëpunëtorët e raportit.....	12
Indeksi i shkurtesave.....	13
Lista e tabelave.....	14
Lista e grafikeve.....	16
Lista e hartave.....	18
I. Presionet.....	19
Aspektet socio-ekonomike.....	20
Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe parashikimet.....	20
Shtimi natyror i popullsisë.....	20
Urbanizimi.....	21
Dendësia e popullsisë.....	22
Struktura e popullsisë sipas moshës.....	22
Zhvillimi ekonomik.....	22
Papunësia.....	22
Të ardhurat për kokë banori.....	23
Varfëria.....	23
Popullsia bujqësore.....	23
Vendbanimet.....	23
2. Energjetika.....	24
Prodhimi i energjisë primare.....	24
Konsumi i përgjithshëm i energjisë.....	25
Konsumi i burimeve të energjisë.....	25
Intensiteti energjetik.....	26
Prodhimi i energjisë elektrike.....	27
Konsumi i energjisë elektrike.....	27
Burimet alternative të energjisë.....	27
Energjia diellore (diellorja ose insolacioni).....	28
Erërat.....	28
3. Industria.....	29
Vlerësimi i gjendjes.....	29
Prodhimtaria industriale.....	29
Aksidentet industriale.....	29
Minierat dhe mineralet.....	31

Plumbi, Zinku dhe Argjendi.....	31
Nikeli.....	31
Kromi.....	32
Boksitet.....	32
Magneziti.....	32
Urani.....	32
4. Bujqësia.....	33
Vlerësimi i gjendjes.....	33
Sipërfaqet bujqësore.....	33
Fondi i kafshëve.....	35
Fermat.....	35
Përdorimi i pesticideve dhe plehrave kimike.....	35
Peshkimi dhe akuakultura.....	36
5. Pylltaria	37
Vlerësimi i gjendjes	37
Shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore.....	37
Prodhimtaria e pyjeve.....	38
Dëmtimet e pyjeve.....	38
Prerja e drurëve.....	38
6.Transporti.....	40
Vlerësimi i gjendjes.....	40
Infrastruktura rrugore.....	40
Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve dhe urave.....	42
Transporti ajror.....	42
Transporti hekurudhor.....	43
7. Turizmi.....	45
Vlerësimi i gjendjes.....	45
Regjistri i turistëve.....	45
Kapacitetet e vendosjes.....	45
Vizita zonave të mbrojtura.....	45
8. Kemikatet.....	47

II. Gjendja.....	48
1. Ajri.....	49
Emisionet e ajrit.....	49
Cilësia e ajrit.....	49
Monitorimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë.....	49
Monitorimi i cilësisë së ajrit në KEK-Obiliq.....	50
Emisionet.....	51
Burimet e kompozimeve acide në ajër- Acidifikimi.....	51
Kosova dhe korniza e legjislacionit evropian për ajrin.....	51
2. Ujërat.....	52
Vlerësimi i gjendjes.....	52
Ujërat sipërfaqësore.....	52
Lumenjtë dhe pellgjet ujore.....	54
Liqenet artificiale.....	54
Ujërat nëntokësore.....	54
Menaxhimi i ujërave.....	55
Degradimi shtretërve të lumenjve.....	55
Furnizimi me ujë.....	57
Shfrytëzimi i ujërave në industri.....	59
Shfrytëzimi i ujërave për hidroenergjetikë.....	59
Shfrytëzimi i ujit për ujitje.....	59
Ndotja e ujërave.....	60
Shkarkimi i ujërave të zeza.....	60
Eutrofikimi i ujërave.....	60
Klasifikimi i lumenjve sipas klasave.....	60
Monitorimi i ujërave sipërfaqësore.....	61
Monitorimi i ujërave sipas institutit INKOS.....	67
3. Tokat/Dheu.....	69
Vlerësimi i gjendjes.....	69
Ndotja me metale të rënda.....	69
Erozioni dhe rrëketë.....	71
Destinimi i shfrytëzimit të tokës.....	71
Zonat e minuara.....	72

4. Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura.....	73
Vlerësimi i gjendjes.....	73
Flora dhe vegjetacioni.....	73
Fauna.....	74
Biodiversiteti agrar.....	75
Prania e OMGJ-ve.....	75
Zonat e mbrojtura të natyrës.....	75
Menaxhimi i zonave të mbrojtura.....	78
Parku Nacional "Malet e Sharrit".....	78
Zonat e propozuara për mbrojtje.....	79
Planet, aktivitetet për ruajtjen e Biodiversitetit.....	79
5. Mbeturinat.....	81
Vlerësimi i gjendjes.....	81
Mbeturinat komunale.....	83
Deponitë sanitare.....	83
Paketimi dhe ambalazhimi.....	86
Letra.....	86
Metalet.....	86
Qelqi.....	86
Plastika.....	86
Ambalazhi i substancave të rrezikshme.....	86
Mbeturinat e rrezikshme.....	86
Mbeturinat industriale.....	90
Automjetet mbeturinë.....	90
Gomat mbeturinë.....	90
Mbeturinat e prodhimit.....	90
Vajrat mbeturinë.....	90
Bateritë e hedhura dhe të shpenzuara.....	91
Mbeturinat medicinale dhe infektive.....	91
Mbeturinat elektrike dhe elektronike.....	91
Barërat me afat të skaduar.....	91
Pesticidet me afat të skaduar dhe ambalazhet e pesticideve.....	92
Mbledhja dhe riciklimi i mbeturinave.....	92
Transporti ndërkufitar i mbeturinave.....	92
Burimet e rrezatimeve radioaktive.....	92

6. Mjedisi dhe Shëndeti.....	94
Vlerësimi i gjendjes.....	94
Gjatësia e pritur e jetës.....	94
Cilësia e ujit të pijes.....	94
Epidemitë (Sëmundjet ngjitëse).....	95
Cilësia e ajrit.....	95
Sëmundjet profesionale.....	96
Realizimi i objektivave.....	96
III. Çështjet të përgjithshme.....	97
1. Vlerësimi i ndikimit në mjedis.....	98
Korniza ligjore.....	99
Përafrimi i legjislaturës mjedisore të Kosovës me atë me atë të BE-së.....	102
Investimet në mjedis.....	103
Programet edukative mësimore në lëmin e mbrojtjes së mjedisit.....	104
Informimi dhe pjesëmarrja e publikut.....	104
Organizatat joqeveritare mjedisore.....	105
Institucionet Mjedisore në Kosovë.....	106
Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit.....	107
Institucionet e UNMIK-ut.....	107
Niveli lokal i qeverisjes.....	107
2. Rekomandimet.....	108
3. Përmbledhje e shkurtër e raportit në fakte dhe shifra.....	113



Të nderuar lexues, dashamirës të mjedisit. Në duart tuaja keni një dokument që ju informon për gjendjen reale të mjedisit në Kosovë. Qëllimi i tij nuk është vetëm informimi për gjendjen e mjedisit, por përmes tij paraqitet edhe angazhimi i institucioneve qeveritare dhe joqeveritare për zbatimin e politikave adekuate mjedisore për përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

Ky dokument është i rëndësishëm sepse publikohet në kohën kur Kosova është orientuar në ndërtimin e një shteti modern e të integruar në Bashkimin Evropian. Në këtë rrugë krahas sfidave tjera ne do të përballemi edhe me plotësimin e kërkesave dhe nevojave mjedisore, ku padyshim, vlerësimi i gjendjes së mjedisit do të jetë një ndër fushat me prioritet të lartë.

Përmbushja e këtyre obligimeve detyrimisht do të kërkojë një angazhim më të madh, jo vetëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, por edhe të gjithë shoqërisë sonë. Andaj, përkushtimi ynë do të jetë që së bashku me institucionet dhe organizatat tjera relevante për mbrojtjen e mjedisit të angazhohemi për të hartuar politikat e duhura mjedisore. Pastaj, duke zbatuar këto politika të ndërtojmë mekanizma dhe instrumente efikase për mbrojtjen e kualitetit të mjedisit.

Jemi të vetëdijshëm që Republika e Kosovës do ta ketë prioritet zhvillimin ekonomik, i cili do të shoqërohet edhe me rritjen e shfrytëzimit të resurseve natyrore dhe ngritjen e kapaciteteve të reja energjetike, që domosdo do të rrisin edhe ndikimin në mjedis. Padyshim se ndikimi në mjedis do të rritet edhe nga zhvillimi i sektorëve tjerë si transporti, industria, urbanizimi, bujqësia etj. Duke marrë për bazë këto rrethana, MMPH do të mundohet maksimalisht që të respektoj parimin kryesor të mbrojtjes së mjedisit në relacion me zhvillimin ekonomik, parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, pra “të plotësojmë nevojat aktuale jetësore, pa i cenuar këtë të drejtë gjeneratave të ardhshme”.

Në kohën kur vëmendja e botës është orientuar në mbrojtjen e rruzullit tokësor nga ndryshimet klimatike, edhe ne do të angazhohemi të japim kontributin tonë në parandalimin e shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore, mbrojtjen e pyjeve, rritjen e sipërfaqeve të gjelbëruara, përmirësimin e teknologjisë së termoelektranave, favorizimin e përdorimit të energjisë alternative etj.

Andaj, shpresojmë që ky raport do të jetë një kontribut i vlefshëm në avancimin, përmirësimin dhe përsheptimin e zgjidhjes së çështjeve të mbrojtjes së mjedisit në Republikën e Kosovës.

Mahir Yagcilar
Ministër i Ministrisë së Mjedisit
dhe Planifikimit Hapësinor

FALENDERIM

Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit si institucion i ri me një periudhë relativisht të shkurtër të funksionimit ka arritur rezultate evidente në monitorimin e mjedisit, ngritjen e sistemit të informimit mjedisor dhe raportimin për gjendjen e mjedisit.

Si institucion monitorues dhe qendër nacionale për informim mjedisor, AKMM ndër detyrat tjera ka edhe përgatitjen e raportit të përgjithshëm të gjendjes së mjedisit. Raportimi real dhe i vazhdueshëm për gjendjen e mjedisit është një mjet shumë i rëndësishëm i informimit të publikut, dhe një instrument i mirë për orientimin e politikave, strategji dhe prioritetëve për të ardhmen e vendit.

Në Kosovë veprojnë disa institucione që merren me çështjen e mbrojtjes së mjedisit, gjithashtu, ka një numër të konsiderueshëm të të dhënave për gjendjen e ajrit, ujit, dheut, biodiversitetit etj. dhe këto të dhëna deri me tani kanë qenë të shpërndara, të pakompletuara, të pa përpunuara dhe shpesh qasja në to ka qenë e vështirë.

AKMM ka grumbulluar të dhëna për gjendjen e mjedisit, për presionet që i bëhen mjedisit nga sektorët si transporti, energjetika, industria, bujqësia etj, nga institucione qeveritare dhe joqeveritare dhe nga burime tjera. Këto të dhëna janë përpunuar dhe tani prezantohen në këtë raport të gjendjes së mjedisit.

Për të arritur rezultate në mbrojtjen e mjedisit, nevojitet bashkëpunim dhe angazhim i të gjithëve.

Falënderimi im nuk i drejtohet vetëm stafit të ngushtë të MMPH-së që ka punuar me përkushtim në këtë raport, por të gjithë individëve, institucioneve qeveritare dhe joqeveritare që kanë dhënë kontributin e tyre përmes ofrimit të të dhënave të nevojshme për hartimin e këtij raporti. Me këtë rast, u bëjë thirrje të gjithëve për thellimin e bashkëpunimit në dobi të mbrojtjes së mjedisit të Republikës të Kosovës.

Gjithashtu një falenderim i veçantë shkon për GTZ-n, e cila na ka ofruar mbështetje financiare për publikimin e raportit.

Shpresojmë, që me rritjen e bashkëpunimit dhe ngritjen e sistemeve të integruara monitoruese do të rritet edhe cilësia e raportimit, mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave mjedisore.

Ngritja e këtyre sistemeve do të na ofrojë edhe më tepër me synimet tona për tu integruar në BE dhe shoqëritë demokratike të zhvilluara botërore.

Me respekt,

Kryeshe



HYRJE

Hartimi i Raportit për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, është bazuar në Ligjin e Mbrojtjes së Mjedisit.¹ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor çdo dy vjet i raporton Qeverisë së Kosovës për gjendjen e mjedisit, e cila këtë raport ia paraqet Kuvendit të Kosovës.

Në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve qeveritare, Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit është institucioni që harton këtë dokument.

Ky raport, paraqet gjendjen e mjedisit për periudhën 2006/2007, por edhe të dhëna të mëhershme zënë vend të konsiderueshëm me qëllim krahasimi. Ky është raporti i parë zyrtar për gjendjen e mjedisit i cili procedohet zyrtarisht nga Ministri i MMPH. Bazuar në modelet e pranueshme të raportimit dhe në rrethanat ekzistuese mjedisore në Kosovë, AKMM ka grumbulluar të dhëna mjedisore nga institucionet monitoruese, kompanitë, operatorët, ndërmarrjet e ndryshme, publikimet, raportet dhe nga burime tjera. Për t'i përmbushur kërkesat e raportit, të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në informata kualitative mjedisore dhe tani ju prezantohen përmes këtij publikimi. Këto të dhëna janë në formë teksti, tabelash, hartash dhe paraqitjesh grafike.

Raporti ofron të dhëna për shtytësit dhe presionet në mjedis, përshkruan gjendjen e aktuale të mediumeve mjedisore dhe ndikimin e kësaj gjendje, trajton në një masë politikat e ndjekura për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, si dhe angazhimin e institucioneve qeveritare, joqeveritare dhe të shoqërisë në përgjithësi për përmirësimin e gjendjes. Një formë e tillë e raportimit që njihet si Modeli DPSIR² paraqet shqetësimet për të gjitha problemet mjedisore në vend dhe është një mënyrë shumë e përshtatshme për vlerësimin e gjendjes së mjedisit. Në masë të konsiderueshme hartimi i këtij raporti është orientuar edhe nga përzgjedhja e indikatorëve (treguesve) të cilët kanë qenë më të përshtatshëm për vlerësimin e gjendjes së

mjedisit. Jemi përpjekur që indikatorët e zgjedhur të kenë bazë shkencore dhe të jenë të kapshëm nga të gjithë ata që do të shërbejnë me këtë raport.

Përkundër angazhimit maksimal, ky raport ka edhe mangësitë e veta, që në radhë të parë janë pasojë e mungesës së të dhënave për shumë çështje të rëndësishme, mungesës së monitorimit të integruar të mjedisit, bazës ligjore dhe dobësive tjera institucionale e menaxhuese.

Duhet pranuar faktin se cilësia e raportimit varet nga cilësia e monitorimit që zbatohet në shkallë vendi dhe niveli i organizimit të sistemit të informimit mjedisor. Duke ditur se këto dy sisteme mjedisore tek ne nuk janë të organizuara në nivelin e duhur, mund të konkludohet se edhe mungesa e të dhënave të plota dhe besueshmëria e tyre është një tregues i rëndësishëm i gjendjes së mjedisit në Kosovë.

Qëllimi i këtij raporti në radhë të parë është të informojë opinionin e gjerë për gjendjen e mjedisit në Kosovë, mirëpo të dhënat e tij janë një bazë e mirë edhe për ndërtimin e politikave adekuate mjedisore, dhe për orientimin e zhvillimeve, planifikimeve dhe investimeve strategjike në sektorët të cilët kanë ndikim në mjedis siç janë: ekonomia, energjetika, transporti, bujqësia etj.

Përmes raportimit të të dhënave të grumbulluara në këtë dokument, AKMM synon që të plotësoj kushtet për të vënë bazën e bashkëpunimit dhe raportimit për Agjencinë Evropiane të Mjedisit dhe EIONET³-in, duke dërguar informata për gjendjen e mjedisit të Kosovës, në këto institucione mjedisore të Bashkimit Evropian.

Hartuesit e këtij publikimi u janë mirënjohës të gjithë atyre që kontribuan në finalizimin e këtij dokumenti, qoftë përmes ofrimit të të dhënave të nevojshme ose duke dhënë sugjerime dhe vërejtjet e tyre.

¹ Ligji për mbrojtjen e mjedisit, Rregullorja Nr. 2003/9

² D-Driving Forces, P-Pressure, S-Strength, I-Impacts, R-Response

³ Rrjeti ndërkombëtar i monitorimit mjedisor

Ne i vlerësojmë, çmojmë dhe mirëpresim të gjitha angazhimet, vërejtjet dhe sugjerimet e institucioneve, ekspertëve dhe dashamirësve të mjedisit, të cilat do të na ndihmojnë shumë gjatë hartimit të publikimeve të ardhshme, për ngritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së tyre.

Me botimin e këtij dokumenti, finalizohet procesi i përgatitjes së raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për periudhën 2006-2007, por nuk përfundon procesi i raportimit dhe angazhimit për mbrojtjen e mjedisit. Mbrojtja e mjedisit është e drejtë dhe përgjegjësi e të gjithëve, andaj nëse secili nga ne do të japim maksimumin në realizimin e përgjegjësisë që na takojnë, patjetër që nesër do të kemi një mjedis më të shëndoshë se sa sot.

HARTUESIT DHE BASHKËPUNËTORËT E RAPORTIT

Përgatitja e materialit bazë dhe përpunimi i informacionit për hartimin e raportit u krye nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, në bashkëpunim me institucionet e mëposhtme:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
 Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
 Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit
 Departamenti i Ujërave
 Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
 Agjencia Pyjore e Kosovës
 Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
 Ministria e Energjisë dhe Minierave
 Departamenti i Energjisë
 Departamenti i Minierave
 Departamenti i Strategjisë dhe Zhvillimit
 Instituti për Hulumtimin e Teknologjisë së
 Linjtit dhe Minierave
 Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit
 Departamenti i Automjeteve
 Departamenti i Transportit, Aviacionit Civil dhe
 Hekurudhave
 Departamenti i Infrastrukturës Rrugore
 Departamenti i Teknologjisë Informative dhe
 Telekomunikimit
 Departamenti i Transportit Rrugor
 Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
 Departamenti i Industrisë
 Departamenti i Meteorologjisë
 Departamenti i Turizmit
 Departamenti i Tregtisë
 Agjencia për Standarde dhe Akreditim

Ministria e Shërbimeve Publike
 Enti i Statistikës së Kosovës
 Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina
 Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
 Instituti INKOS
 Fabrika New Co Ferronikeli
 Fabrika Sharr-cem
 KEK
 AER
 USAID
 UNDP
 GTZ
 SIDA
 Ujësjiellësi Rajonal “Batllava”
 Zyra e Koordinatorit të TMK-së
 Aeroporti Internacional i Prishtinës
 Ibër- Lepenci
 Instituti i Mjekësisë së Punës
 Deponia Sanitare në SHARR
 KLMC
 Korporata Farmaceutike e Kosovës
 Doganat e Kosovës
 Agjencia Kadastrale e Kosovës

INDEKSI I SHKURTESAVE

MMPH-	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	PKVM-	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedisë
IHMK-	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës	IKMN-	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
MBPZHR-	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	IPH-	Instituti i Planifikimit Hapësinor
APK-	Agjencia Pyjore e Kosovës	PSSP-	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
IKSHP-	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publikë	OBSH-	Organizata Botrore e Shëndetsisë
MEM-	Ministria e Energjisë dhe Minierave	BE-	Bashksia Evropiane
MTPT-	Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit	VML-	Vlera Maksimale e Lejuar
MTI-	Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë	PML-	Perqendrimi Maksimal i Lejuar
<SHP-	Ministria e Shërbimeve Publike	AKM-	Agjencia Kosovare e Mirbesimit
ESK-	Enti i Statistikës së Kosovës	AESHB-	Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore
KLMC-	Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina	KKMF-	Qendra Komunale e Mjeksisë Familjare
Instituti-	INKOS	MASHT-	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
AER-	Agjencioni European për Rindertim	UP-	Universiteti i Prishtinës
UNDP-	Plani i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim	OJQ-	Organizatat Jo Qever
SIDA-	Agjencia Suedeze për zhvillim dhe bashkëpunim Nderkombëtar	QKUK-	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
REC-	Qendra Regjionale për Mjedisë	Twh-	Tera Wat / orë
AIRBP-	Aeroporti Internacional i Prishtinës		
ETMM-	Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mesimore		
FSHMN-	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore		
ESTAI-	Energy Sector Technical Assistance Project		
PJ-	Peta Joule		
Gwh-	Giga Wat / orë		
KEK-	Korporata Energjetike e Kosovës		
MW-	Mega Wat		
UNMIK-	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë		
BPSH-	Bruto Produkti Shoqëror		

LISTA E TABELAVE

Lista e tabelave

Aspektet Socio-Ekonomike

Tabela 1.	Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë 1948-2051
Tabela 2.	Struktura e popullsisë sipas moshës 1981-2006 (%)
Tabela 3.	Të ardhurat kombëtare për kokë banori 1985-2003
Tabela 4.	Varfëria e përgjithshme sipas nacionaliteteve dhe vendbanimeve 2004

Energjetika

Tabela 5.	Intensiteti energjetik sipas viteve dhe sektorëve, ktoe/milion €
Tabela 6.	Bruto prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë, GWh
Tabela 7.	Potenciali hidroenergjetik i Kosovës
Tabela 8.	Mesatarja e djellëzimit në stacionet kryesore meteorologjike, Prishtinë, Pejë dhe Prizren 1951-2007 (orë/ditë)

Industria

Tabela 9.	Numri i bizneseve të regjistruara sipas kategorive, numri i të punësuarve dhe sektorët e veprimtarisë ekonomike
Tabela 10.	Rezervat e xeheve të Kosovës
Tabela 11.	Rezervat e Pb, Zn dhe Ag, ne disa miniera te Kosovës
Tabela 12.	Rezervat e nikelit
Tabela 13.	Rezervat e magnezitit
Tabela 14.	Rezervat e disa burimeve minerare të Kosovës

Bujqësia

Tabela 15.	Lloji i pronës së tokës
Tabela 16.	Ndarja e tokës bujqësore sipas kulturave
Tabela 17.	Fondi blegtoral
Tabela 18.	Numri dhe madhësia e fermave
Tabela 19.	Përdorimi i pesticideve sipas sektorëve

Pylltaria

Tabela 20.	Pyllëzimi sipas llojit dhe pronësisë
Tabela 21.	Pyjet e Kosovës sipas llojit dhe pronësisë në ha dhe %
Tabela 22.	Klasa e vjetërsisë së pyjeve sipas pronësisë në %
Tabela 23.	Damete shkaktuara nga zjarret në periudhën Korrik - Gusht 2007

Transporti

Tabela 24.	Llojet e rrugëve dhe gjatësia e tyre në km
Tabela 25.	Automjetet e regjistruara gjatë vitit 2006
Tabela 26.	Shpenzimet e karburantit për nevoja të Aeroportit të Prishtinës 2006 - 2007
Tabela 27.	Transporti publik i udhëtarëve
Tabela 28.	Transporti i mallrave neto-ton

Ajri	Tabela 29.	Vlerat mesatare të pluhurit sipas INKOS-it, gjatë viteve
	Tabela 30.	Vlera mesatare e pH së reshjeve në rrjetin monitorues në Mitrovicë dhe IHMK-2006
Ujërat	Tabela 31.	Pellgjet ujëmbledhëse, sipërfaqja, sasia rrjedhëse e ujit dhe vend-derdhja
	Tabela 32.	Sipërfaqja dhe rrjedha e liqeneve artificiale në Kosovë
	Tabela 33.	Akumulacionet kryesore, sipërfaqja, rrjedhja ujore dhe vëllimi i akumulimit në Kosovë
	Tabela 34.	Akumuluesit ujqor nëntokësor
	Tabela 35.	Burimet e furnizimit me ujë dhe sasia ditore në m ³ .
	Tabela 36.	Shpërndarja e ujit nga NPH, Ibër Lepenc"
	Tabela 37.	Shfrytëzimi i ujit për ujtitje sipas regjioneve
	Tabela 38.	Ujitja e tokës sipas komunave
	Tabela 39.	Sasia e ujit të prodhuar nga kompanitë regjionale të licencuara për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë
	Tabela 40.	Vlerat mesatare të analizave fiziko kimike të ujërave sipërfaqësore sipas profileve në pellgjet e Kosovës 2005, 2006, 2007
	Tabela 41.	Parametrat dhe kufijtë e lejuar sipas klasave
	Tabela 42.	Rezultatet e monitorimit të ujërave të shkarkuar nga TCA-TCB, në recipientin e Sitnices, 2005 dhe 2006.
	Tabela 43.	Gjendja e ekzistuese e erozionit
	Tabela 44.	Lista e patrimet nga minat dhe mjetet e pashpërthyer në Kosovë 1999-2007
Biodiversiteti	Tabela 45.	Numri i disa llojeve të qenieve të gjalla në Kosovë në raport me ato evropiane dhe botërore sipas grupeve kryesore
	Tabela 46.	Zonat e mbrojtura të natyrës sipas kategorive.
Mbeturinat	Tabela 47.	Llojet e mbeturinave që gjenden në Kosovë
	Tabela 48.	Deponitë sanitare në Kosovë
	Tabela 49.	Sasia e mbeturinave (ton) në deponitë sanitare regjionale të Kosovës 2006
	Tabela 50.	Sasia e mbeturinave (ton) në deponitë sanitare regjionale të Kosovës 2007
	Tabela 51.	Lloji i mbeturinave të rrezikshme, lokacionet e grumbullimit dhe sasia e tyre 2006
	Tabela 52.	Sipërfaqet e deponive industriale dhe sasia e tyre
Mjedisi dhe Shëndeti	Tabela 53.	Numri i rasteve të sëmundjeve ngjitëse në Kosovë 2005-2006
	Tabela 54.	Morbiditeti nga disa lloje të sëmundjeve gjatë perioidhës 2005-2006 në, QKUK dhe spitalet regjionale
Vlersimi i Ndikimit në Mjedis	Tabela 55.	Pelqimet mjedisore sipas veprimtarive
	Tabela 56.	Lista e ligjeve të aprovuara në Kuvendin e Kosovës 2003-2007, të cilat lidhen ngusht me mjedisin
	Tabela 57.	Aktet nënligjore
	Tabela 58.	Rezultatet e monitorimit të progresit, të harmonizimit të legjislaturës mjedisore me atë të EU-së
	Tabela 59.	Investimet në mjedis

LISTA E GRAFIKONEVE

Lista e Grafikoneve

Aspektet Socio-Ekonomike

- Grafikoni 1. Lindshmëria, vdekshmëria dhe shtimi natyror i popullsisë së Kosovës 1948-2005
- Grafikoni 2. Lëvizja e popullsisë rurale dhe urbane në Kosovë 1948-2001
- Grafikoni 3. Pjesëmarrja e popullsisë rurale dhe urbane në popullsinë e përgjithshme në Kosovë 1948-2001
- Grafikoni 4. Dendësia e popullsisë në Kosovë 1948-2004
- Grafikoni 5. Numri i të papunësuarve në Kosovë 1988-2007
- Grafikoni 6. Pjesëmarrja e popullsisë bujqësore në Kosovë 1961- 2004

Energjetika

- Grafikoni 7: Furnizimi total me burime primare energjetike (ktoe)
- Grafikoni 8: Kontributi në furnizim me burime primare energjetike (ktoe)
- Grafikoni 9: Kontributi në furnizim me burime primare energjetike (%)
- Grafikoni 10: Konsumi i energjisë primare në Kosovë e shprehur në PJ (Peta Joule)
- Grafikoni 11: Konsumi i energjisë primare në Kosovë e shprehur në GWh
- Grafikoni 12: Trendi i parashikimeve të konsumit të energjisë (PJ)
- Grafikoni 13: Kontributi i secilit sektor në konsumin e energjisë (ktoe)
- Grafikoni 14: Konsumi final i energjisë (ktoe)
- Grafikoni 15: Kontributi i secilit burim energjetik në konsumin final të energjisë (ktoe)
- Grafikoni 16: Eficienca energjetike për Kosovën (%)
- Grafikoni 17: Konsumi final energjetik dhe humbjet energjetike në sistemin energjetik të Kosovës (ktoe)
- Grafikoni 18: Konsumi i energjisë elektrike në sezonin verë/ dimër nga viti 2001-2006

Bujqësia

- Grafikoni 19: Importi i pesticideve në Kosovë gjatë periudhës 2001-2005, shprehur në kg/l dhe në %
- Grafikoni 20: Importi i Pesticideve sipas llojit 2001 - 2005
- Grafikoni 21: Përdorimi i Pesticideve sipas llojit
- Grafikoni 22: Përdorimi i plehrave sipas llojit

Transporti

- Grafikoni 23. Numri i fluturimeve sipas viteve
- Grafikoni 24. Rritja e numrit të udhëtarve nga AP

Ajri

- Grafikoni 25. Verat mesatare vjetore të grimcave të depozituara në IHMK, qershor-dhjetor 2005
- Grafikoni 26. Vlerat mesatare vjetore për materiet grimcore të depozituara në IHMK-2006
- Grafikoni 27. Vlerat mesatare mujore të SO₂ për piken monitoruese IHMK, 2005-2007
- Grafikoni 28. Vlerat mesatare mujore të blozës për piken monitoruese IHMK, 2005-2007
- Grafikoni 29. Vlera mesatare e pluhurit total të depozituar (PTD) në Mitrovicë dhe IHMK 2005-2007
- Grafikoni 30. Përqendrimi i SO₂ gjatë viteve 2005-2006
- Grafikoni 31. Përqendrimi i blozës (mikrogram/ m³) në vitin 2006

Tokat

Grafikoni 32. Struktura e tokave sipas shfrytëzimit në ha

Grafikoni 33. Struktura e tokave sipas shfrytëzimit në %

Biodiversiteti

Grafikoni 34. Numri i llojeve endemike të florës vaskulare të Kosovës, në kuadër të numrit të përgjithshëm të llojeve të evidentuara

Grafikoni 35. Kronologjia e mbrojtjes së vlerave të natyrës në Kosovë

Grafikoni 36. Numri i vizitave në zonat e mbrojtura janar - tetor 2006

Mbeturinat

Grafikoni 37. Paraqitja grafike në % e llojit të mbeturinave

Mjedisi dhe shëndeti

Grafikoni 38. % e papërshtatshmëris bakterore e ujit nga iujësjellsit e Kosovës, 2007

Grafikoni 39. Papërshtatshëria bakterore e ujit për pije në regjionin e Prishtinës, janar-mars 2007

Grafikoni 40. Papërshtatshëria bakterore e ujit në komunën e Prishtinës,

LISTA E HARTAVE

Lista e hartave

Harta 1.	Harta e shpërndarjes së numrit të përgjithshëm të bizneseve sipas komunave
Harta 2.	Harta e minierave të Kosovës
Harta 3.	Harta e bonitetit të tokave
Harta 4.	Rrjeti i rrugëve në Kosovë
Harta 5.	Rrjeti i hekurudhave në Kosovë
Harta 6.	Harta turistike e Kosovës
Harta 7.	Harta e lumenjeve të Kosovës
Harta 8.	Zonat e degraduara në pellgun e Drinit të Bardhë, nga operatorët e rërës dhe zhavorrit
Harta 9.	Harta e cilësisë së ujërave sipërfaqësore në Kosovë
Harta 10.	Harta e rrjetit të stacioneve hidrometrike
Harta 11.	Harta pedologjike e Kosovës
Harta 12.	Harta e zonave të mbrojtura në Kosovë
Harta 13.	Harta e zonave të evidentuara për mbrojtje në Kosovë
Harta 14.	Harta e deponive regjionale në Kosovës

PRESIONET

I.
Presionet

Presionet sektoriale janë pjesë e metodologjisë standarde, që aplikohen si tipologji për pasqyrimin e ndikimeve në mjedis të sektorëve të caktuar ekonomik dhe sektorëve tjerë, përmes të cilëve njeriu duke kënaqur nevojat e veta socio-ekonomike shkakton ndikime të ndjeshme në mjedis. Shfrytëzimi i hapësirës, shfrytëzimi i resurseve natyrore dhe llojet e ndryshme të shërbimeve të cilat kanë ndikim në mjedis, reflektohen edhe në ndryshimin e baraspeshës natyrore, shtërjen e resurseve natyrore dhe në shëndetin e njeriut. Përmasat e këtyre ndikimeve, mekanizmi i veprimeve dhe pasojat në mjedis janë të varura nga shumë faktorë. Mosndërmarrja e masave adekuate në parandalimin dhe eliminimin e tyre në shumicën e rasteve shkaktojnë efekte të pariparueshme për mjedisin.

Me qëllim të vlerësimit më të lehtë të ndikimeve në mjedis praktikohet ashtu që efektet sektoriale të grupohen sipas aktiviteteve ekonomike, që në realitet trajtohen si sektorë të veçantë.

Disa aktivitete ekonomike si energjetika, industria, transporti, etj. padyshim janë burime me ndikim të theksuar në mjedis, ndërsa bujqësia, peshkimi, pylltaria etj. qëndrojnë në raporte të tjera me mjedisin dhe si të tilla varen mjaft nga gjendja e mjedisit. Shqyrtimi i ndikimeve të tyre në mjedis, assesi nuk duhet të anashkalohet. Ndërsa, turizmi është një sektor ekonomik, efektet e të cilit në mjedis janë identifikuar kohëve të fundit.

Shqyrtimi i ndikimeve të sektorëve në mjedis ka një përparësi sidomos gjatë planifikimeve zhvillimore dhe hartimit të strategjive përkatëse. Përveç shqyrtimit të efekteve sektoriale veç e veç, është me interes edhe shqyrtimi i zonave në të cilat vjen deri te ndikimi i veprimeve të përbashkëta të disa sektorëve të ndryshëm. Kimikatet i takojnë këtij grupi, prodhimi dhe përdorimi i të cilave sot është në rritje e sipër nga disa sektorë.

1. ASPEKTET SOCIO- EKONOMIKE

Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe parashikimet

Kosova për një periudhë të gjatë kohore (mbi 25 vjeçare) ballafaqohet me mungesë të dhënave statistikore për popullsinë, kështu që, përcaktimi i numrit të popullsisë bëhet kryesisht në bazë të vlerësimeve dhe parashikimeve.

Numri i përgjithshëm i popullsisë së Kosovës edhe për kundër shpërnguljeve dhe trysnive të shumta ndaj saj, vazhdimisht është rritur me ritme të ndryshme në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore.

Gjatë periudhës 53 vjeçare (1948-2001) popullsia e Kosovës kishte një rritje prej 235.5%. Në bazë të projeksioneve të popullsisë të Kosovës, numri i përgjithshëm do të vazhdon të rritet edhe në 50 vitet e këtij shekulli, edhe pse me ritme më të ngadalshme krahasuar me vitet e '60, '70 dhe '80 të shekullit të kaluar.

Rritja e numrit të përgjithshëm të popullsisë ka ndikim në mjedis në shumë aspekte, prej të cilave më të rëndësishmet janë: ndikimi në shkallën e prodhimit, shfrytëzimin e resurseve natyrore, mënyrën e shfrytëzimit të tokës, si dhe në krijimin e mbeturinave dhe ndotjen e mjedisit.

Lidhja në mes popullsisë dhe ndikimi në mjedis në shikim të parë është: më shumë njerëz harxhojnë më shumë produkte, potencial natyror, shkaktojnë më shumë dëme dhe prodhojnë më shumë mbeturina.

Tabela 1. Lëvizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë 1948-2051


Viti	Nr i banorëve	Komentet
1948	727820	Regjistrimi
1961	963988	Regjistrimi
1971	1243693	Regjistrimi
1981	1584440	Regjistrimi
1991	1956196	Vlerësimi
2001	2345000	Vlerësimi
2011	2890000	Parashikimi
2021	3360000	Parashikimi
2031	3800000	Parashikimi
2041	4180000	Parashikimi
2051	4500000	Parashikimi

Shtimi natyror i popullsisë

Popullsia e Kosovës, ritmin më të shpejt të rritjes e ka pasur gjatë viteve të '60- ta, kur shkalla e shtimit natyror ishte më e larta në periudhën e pas luftës së dytë botërore me 29.9% (lindshmëria 44.1‰, kurse vdekshmëria 14.2‰).

Në bazë të të dhënave që na ofron Enti i Statistikave të Kosovës, në vitin 2003 dhe 2006, në Kosovë është regjistruar niveli më i ulët i lindjeve dhe i shtimit natyror të popullsisë në 1000 banorë që nga përfundimi i luftës së dytë botërore deri më sot.

Grafikoni 1. Shtimi natyror i popullsisë




Urbanizimi

Në periudhën 1948-2001 në Kosovë ka pasur rritje të popullsisë së përgjithshme, urbane dhe rurale, mirëpo, trendët e rritjes së popullsisë urbane kanë qenë shumë më të shpejta se sa të popullsisë së përgjithshme dhe asaj rurale.

Në krahasim me vitin 1948, në vitin 2001 popullsia e përgjithshme tregon rritje për 235.5%, popullsia rurale 110.0%, kurse popullsia urbane tregon rritje prej 1430.8%. Sa i përket pjesëmarrjes në popullsinë e përgjithshme, popullsia urbane shkallën më të lartë të rritjes e arrin në periudhën 1991/2001, kur përqindja e popullsisë urbane rritet nga 37% në 44%. Kjo lidhet me kohën e pas luftës kur kemi lëvizje masive të popullsisë rurale drejt vendbanimeve urbane si pasojë e shkatërrimeve nga lufta.

Kosova me këtë nivel të urbanizimit hynë në radhën e shteteve me nivel më të ulët në Evropë. Por, edhe ky nivel është mjaft i diskutueshëm pasi që pjesët periferike të qyteteve të Kosovës në të shumtën e rasteve nuk ofrojnë as kushte minimale të jetës urbane. Edhe pse mjediset urbane në disa aspekte ofrojnë përparësi në krahasim me mjediset rurale (janë më kompakte, zënë sipërfaqe më të vogla për kokë banori, kanë efikasitet në shpërndarjen e ujit, rrymës, rrugëve dhe shërbime më të mira për mbeturina etj, ndikimi i tyre negativ në mjedis është shumë më i madh në krahasim me mjediset rurale.

Grafikoni 2. Levizja e numrit të përgjithshëm të popullsisë urbane dhe rurale në Kosovë




Sidomos, ndikimi negativ në mjedis rritet me emigrimet e pa kontrolluara të cilat shfaqen përmes: rritjes së dendësisë (mbipopullimi), të viseve urbane dhe depopullimit të viseve rurale.

Po ashtu, ndërtimet pa kriter urbanistik në periferi, me mungesë të infrastrukturës, vështirësi në strehim, në shërbimet e mbledhjes së mbeturinave, hedhja e pa kontrolluar e hedhurinave të ndërtimeve, rritja e sasisë së ujërave të zeza që përfundojnë pa trajtim në mjediset

natyrore, pastaj problemet socio-ekonomike siç janë: rritja e papunësisë, mungesa e shërbimeve cilësore shëndetësore, gjendja higjienike, mbingarkesa e institucioneve shkollore në qytete dhe braktisja e atyre në fshatra, siç është rasti me zonat kodrinore-malore të Kosovës, zvogëlimi i sipërfaqeve të gjelbra në qytete etj.

Komunikacioni në mjediset urbane është shumë më i dendur dhe është burim i madh i ndotjes së mjedisit.

Grafikoni 3. Pjesëmarrja e popullsisë rurale dhe urbane në popullsinë e përgjithshme në Kosovë




Dendësia e popullsisë

Me rritjen e popullsisë së Kosovës është rritur edhe niveli i popullimit mesatar për njësi të sipërfaqes nga 62.7 (1948) në 227 (2004) banorë për km². Kjo rritje paraqet njëherësh edhe rritjen e ndikimit të popullsisë mbi mjedisin. Dendësia më e lartë e popullsisë është në zonat e ulëta fushore (mbi 600 b/km² fusha e Kosovës). Në viset e ulëta kodrinore lëvizë rreth mesatares së Kosovës, kurse në viset e larta kodrinore-malore kanë dendësi më të ulët se mesatarja e Kosovës.

Në viset e ulëta është koncentruar numri më i madh i popullsisë, objekteve industriale dhe urbanizimit, faktorë këta që kanë ndikimin më të madh në ndotjen e mjedisit. Ndryshimet në dendësi të popullsisë në mjedisin gjeografik lidhen me disa probleme mjedisore siç janë: braktisja e mjediseve agrare (emigrimet drejt qyteteve), rritja e trysnisë mbi mjedis në disa zona (veçmas urbane) dhe pamundësia për të kënaqur kërkesat në banim, punësim, sigurim infrastrukture etj, si dhe ndërhyrjet tjera përmes zënies së sipërfaqeve bujqësore me ndërtime, ndërhyrjet pa kritere në ujësjellës, rritja e sasisë së mbeturinave, ujërave të zeza që hedhen në ambient të pa trajtuara etj.

Grafikoni 4. Dendësia e popullsisë në Kosovë 1948-2004



Zhvillimi ekonomik

Në kuadër të zhvillimit ekonomik, Kosova karakterizohet me strukturë të pa volitshme të degëve industriale, pasi që dominonin degët ekstensive me shkallë të ulët të finalizimit, të cilat krijojnë pak vende pune, si dhe çmimet e prodhimeve ishin më të ulëta dhe të kontrolluara etj.

Deri në vitet e 50-ta, Kosova ishte regjion i pa industrializuar, meqë në industri dhe xehetari ishin të punësuar vetëm 3.1% e popullsisë aktive. Në mes viteve 1954/73, Kosova ishte dobët e industrializuar me 5.1-12.5 %, kurse prej vitit 1974 ,Kosova hynë në fazën e industrializimit të pjesshëm me 12.6-25% të popullsisë aktive në industri dhe xehetari. Në vitin 1981, në industri dhe xehetari ishin të punësuar 17.5% të popullsisë aktive. Pas viteve 1981, si pasojë e krizës ekonomike zhvillimi i industrisë stagnon, kurse pas viteve 1990, me përjashtimin e punëtorëve shqiptarë nga puna, ekonomia edhe industria në Kosovë fillojnë të shkatërrohen me përmasa të mëdha.

Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik të Kosovës do të trajtohet përmes tre parametrave kryesor ekonomik, që janë: papunësia, të ardhurat për kokë banori dhe varfëria.


Tabela 2. Struktura e popullsisë (%) sipas moshës, 1981-2006

Grup moshat	1981	1991	2001	2006
0-19 vjeç	52	48	41	38
20-64 vjeç	43	47	54.1	56
Mbi 65 vjeç	5	5	5.9	6

Papunësia

Kosova karakterizohet me shkallën më të lartë të papunësisë në Evropë, si pasojë e përjashtimit të punëtorëve shqiptarë nga puna në vitet e '90, si dhe pasojë e luftës së vitit 1998-99, ku ekonomia e Kosovës pësoj shkatërrim të përgjithshëm. Gjatë gjithë periudhës së pas luftës shkalla e papunësisë në Kosovë ka qenë mbi 40% me tendencë rritje të numrit të përgjithshëm të papunëve.

Grafikoni 5. Numri i të papunësuarve 1988-2007



Struktura e popullsisë sipas moshës

Popullsia e Kosovës është me moshë të re. Në vitin 2006 grup moshë 0-19 vjeç përbën 38 %, grup moshë e 20-64 përbën 56 %, kurse grup moshë e vjetër mbi 65 vjeç përbën 6 % të popullsisë së përgjithshme. Struktura e popullsisë sipas moshës në mjedis ndikon përmes prodhimit dhe konsumit, sepse nga kjo strukturë formohet kontingjenti i punës dhe kontingjenti i popullsisë që paraqitet si konsumator.

Sidomos, është shqetësues fakti që niveli më i lartë i papunësisë përfshin grup moshat e reja 15-24 vjeç (63.4%) dhe 25-34 vjeç (47.8%), si dhe shkallë shumë e lartë e papunësisë së gjinisë femërore mbi 60%.

Papunësia do të jetë problem serioz edhe për një periudhë të gjatë kohore për ekonominë e brishtë të Kosovës.

Të ardhurat për kokë banori

Pas viteve '80-ta, përkeqësimi i situatës ekonomike në Kosovë është shprehur edhe me zvogëlimin e të ardhurave për kokë banori. Nga viti 2000 të ardhurat për kokë banori fillojnë të rriten, më tepër si pasojë e ndihmave dhe donacioneve të ndryshme, se sa të zhvillimit ekonomik të vendit.

Tabela 3. Të ardhurat kombëtare për kokë banori në Kosovë 1985-2003⁴

Vitet	1985	1990	1995	2000	2001	2002	2003
Të ardhurat për banorë në €	1125	689	340	730	823	826	848

Kosova ka nivelin më të ulët të të ardhurave për kokë banori në Ballkan dhe Evropë. Gjithashtu hynë në radhën e shteteve me të ardhura më të ulëta edhe në përmasa botërore.

Varfëria

Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe shkalla shumë e lartë e papunësisë janë shkaktarë të nivelit të lartë të varfërisë në Kosovë. Nëse bazohemi në definicionin se: e varfër konsiderohet ekonomia familjare me më pak se 2\$ në ditë, atëherë del se në vitin 2004 në Kosovë në varfëri jetonin 60.6% e popullsisë (12.9% , në varfëri ekstreme nën 1 \$ për banorë dhe 47.6% në varfëri të plotë me 2\$ për banorë në ditë). Në krahasim me vitin 2000 nuk vërehet ndonjë përmirësim sa i përket shkallës së varfërisë në Kosovë, por niveli i varfërisë ekstreme tregon rritje nga 11.9% (2000) në 12.9% (2004), kurse niveli i varfërisë së plotë është i njëjtë dhe përfshinë më tepër se gjysmën e popullsisë (50.3%).

Duke u bazuar në strukturën etnike të popullsisë dhe të nivelit të varfërisë mund të konstatohet lidhje korrelative ndërmjet varfërisë dhe strukturës etnike të popullsisë. Komunitet me popullsi shqiptare karakterizohen me shkallë më të lartë të varfërisë, kurse komunitet me popullsi shumicë serbe karakterizohen me shkallë më të ulët të varfërisë. Shpërndarja e varfërisë sipas vendbanimeve tregon se varfëria kombëtare më e lartë është në vendbanimet rurale, kurse varfëria e skajshme (ekstreme) më e lartë është në vendbanimet urbane.


Tabela 4. Varfëria e përgjithshme sipas nacionaliteteve dhe vendbanimeve në Kosovë⁵

Kosovë	%	Shqiptar	Serb	Ashkalinjë	Të tjerët	Vend. rurale	Vend. urbane
Varfëria në nivel kombëtar	50.3	50.4	36.9	80.9	67.6	51.7	48.7
Varfëria e skajshme	12.7	12.6	5.9	37.5	19.6	10.8	14.9
Personat me 1 dollar në ditë	12.9	12.8	3.9	36.7	16.8	10.6	15.1
Personat me 2 dollarë në ditë	47.6	48.6	26.4	79.0	57.7	49.2	45.7

Popullsia bujqësore

Krahas rritjes së nivelit të industrializimit në Kosovë, përqindja e popullsisë bujqësore ka ardhur vazhdimisht duke u zvogëluar deri në vitet e '90 të shekullit të kaluar. Si pasojë e përkeqësimit të gjendjes së përgjithshme ekonomike në vend, në vitin 2004 në raport me vitin 1991 kemi rritje të pjesëmarrjes së popullsisë bujqësore në kuadër të popullsisë së përgjithshme. Ulja e shpejtë e popullsisë bujqësore para viteve '90-ta ishte rezultat jo vetëm i zhvillimit ekonomik, por edhe i ndërrimit të metodologjisë së regjistrimit të kësaj popullsie.

Grafikoni 6. Pjesëmarrja e popullsisë bujqësore në Kosovë 1961-2004



Vendbanimet

Kosova ka numër relativisht të madh të vendbanimeve. Në vitin 2006 numri i përgjithshëm i vendbanimeve ishte 1466 tipash të ndryshme. Mesatarja e numrit të banorëve për një vendbanim ishte 1600 banorë, duke i takuar mesatarisht nga 7.4 km² të sipërfaqes, ndërsa distanca mesatare mes vendbanimeve prej afër 3 kilometrash flet për dendësinë e madhe të vendbanimeve të Kosovës. Me 1991 nga 1449 vendbanime sa kishte Kosova, 26 ishin vendbanime urbane, kurse 1423 të tjera (të përziera dhe rurale). Mesatarja e numrit të banorëve për një vendbanim ishte 1350 banorë, për vendbanimet urbane 28073 banorë, kurse për vendbanimet rurale 1423 banorë. Vendbanimet me të mëdha në Kosovë janë 7 qendrat regionale (vendbanime urbane) - Prishtina, Mitrovica, Ferizaj, Gjilani, Prizreni, Peja dhe Gjakova në të cilat në të njëjtin vit jetonin rreth 30% e popullsisë së përgjithshme të Kosovës.

⁴ Raporti i zhvillimit njerëzor në Kosovë 2002 (fq. 106) dhe 2004 (fq. 14)

⁵ 2004 - Raporti i zhvillimit njerëzor në Kosovë 2004, UNDP, Prishtinë, 2004, fq. 126.

2. ENERGJETIKA

Energjetika luan rol të rëndësishëm e të pazëvendësueshëm në jetën e modernizuar të njeriut. Por, edhe ndikimet e saj në mjedis janë mjaft të theksuara. Çfarëdo qoftë mënyre e prodhimit të energjisë ka ndikim të ndjeshëm në mjedis, për shkak të operacioneve që e përcjellin që nga sigurimi i lëndës së parë dhe transportit të saj e deri te procesi i prodhimit dhe vet shfrytëzimi i energjisë. Në rend të parë analizohen emisionet e përgjithshme nga vargu energjetik duke përfshirë: ndotjen e ujit, ajrit, tokës, menaxhimin e mbetjeve, zhurma dhe radioaktiviteti. Është me interes që të vlerësohen edhe aksidentet e mundshme që ndodhin gjatë procesit të prodhimit, transportit dhe shfrytëzimit të energjisë. Arritja e një baraspeshe në mes kërkesës për energji dhe ruajtjes së gjendjes së mjedisit është një sfidë e madhe. Duke zgjedhur lloje e burimeve të energjisë dhe teknologjive të përshtatshme zvogëlohet ndikimi në mjedis. P.sh nëse në vend të thëngjillit përdoret gazi natyror, atëherë emetimi i CO₂ zvogëlohet për 40%.

Megjithatë, secili objekt energjetik në përmasa dhe forma të ndryshme ka ndikim në mjedis. Me ndërtimin e një hidrocentrali vije deri te çrregullimi i regjimit të ujërave nëntokësore dhe mikroklimës me ç'rast çrregullohet ekosistemi në hapësirën ku shtrihet objekti hidroenergjetik.

Prodhimi i energjisë primare

Në kuadër të energjisë primare përfshihet energjia e fituar nga burimet me prejardhje fosile (thëngjilli, druri, nafta, gazi etj.), energjia nga sistemet e hidroelektranave, energjia e erës, diellit, energjia nga ndezja e drurit dhe energjia nga mbetjet. Struktura e energjisë së konsumuar në Kosovë në vitin 2005 dhe 2006 nuk ka ndryshuar krahësuar me vitet paraprake. Gazi natyror nuk kontribuon në bilancin e energjisë së.

Kosovës, pasi që nuk ka prodhim të saj në vend, ndërkohë që importi i tij vlerësohet të jetë i pa konsiderueshëm për shkak të pjesëmarrjes së ulët në bilancin e përgjithshëm.

Gjatë vitit 2006 Kosova ka konsumuar sasi të energjisë prej 2073 ktoe (ngjashëm edhe në vitin 2005⁶). Kontributi i importit të naftës është rritur, nga 576 ktoe sa ishte në vitin 2005, në 595 ktoe në vitin 2006. Prodhi i energjisë elektrike dominohet nga prodhimi në termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B". Sasia e energjisë elektrike nga këto dy termocentrale njehsohet të jetë rreth 372 ktoe, ndërsa sasia e energjisë elektrike nga hidrocentralet e Kosovës ishte rreth 10 ktoe. Kontributi i energjisë diellore është ende simbolik, por megjithatë regjistrohet trendi i rritjes së kësaj forme të prodhimit të energjisë nga burime të ripërtritshme.

Figura 7: a) Furnizimi Total me Burime Primare Energetike (ktoe)





Figura 8: b) Kontributi në Furnizim me Burime Primare Energetike (ktoe)
c) Kontributi në Furnizim me Burime Primare Energetike (%)



⁶ MEM, Bilanci i energjisë së Kosovës për vitin 2006, tetor 2007

Banka botërore, bazuar në studimet e ESTAP⁷ (Energy Sector Technical Assistance Project) ka prezantuar konsumin e energjisë primare të Kosovës, duke llogaritur pjesëmarrjen e thëngjillit, naftës me derivateve të naftës dhe drurit. Bilanci energjetik është paraqitur në PJ (Peta Joule), por edhe në Gëh si njësi e praktikuar dhe e popullarizuar në këtë fushë. Një paraqitje e veçantë është bërë për prognozën e kërkesës për energji deri në vitin 2015, ku vërehet rritje e konsiderueshme. Është normale se mbulimi i kërkesës për energji do të orientohet edhe më tutje në ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike në bazë të thëngjillit. Mbetet të iniciohen projekte për mbulimin e ngrohjes në objekte të banimit, duke aplikuar metodologji adekuate për rritjen e efikasitetit energjetik. Prognozat e mbulimit të kërkesave energjetike në bazë hidrike, të erës, gazit natyror dhe atij solar nuk janë marrë parasysh për shkak të pjesëmarrjes së ulët të tyre në bilancin total të energjisë.

Fig. 9. Konsumi i energjisë primare në Kosovë e shprehur në PJ (Peta Joule)






Fig. 10. Konsumi i energjisë primare në Kosovë e shprehur në GWh



⁷ Banka Botrore, Sektori i energjisë së Kosovës studimi i tregut, 2007

Fig.11. Trendi i parashikimit të konsumit të energjisë elektrike (PJ)



Problemet kryesore, të cilat janë identifikuar dhe nënvizuar përmes analizës së zhvillimit historik dhe trendëve të mundshme në të ardhmen në furnizimin e sektorit të energjisë në Kosovë, janë:

> Rritja e konsumimit të energjisë elektrike nga konsumatorët gjatë periudhës së tranzicionit ka çuar në rritje të nivelit të humbjeve joteknike të niveleve të larta (humbjet në rrjetin e shpërndarjes) dhe reduktimin e sigurimit të furnizimit;

✎ Mungesa e burimeve alternative të energjisë, si dhe niveli i ulët i kulturës eficiente të konsumatorëve, kanë Bërë që energjia elektrike të shpenzohet pa kriter dhe në mënyrë joeficiente, sidomos në sektorin e shërbimeve të ndryshme, siç janë amvisëria dhe sektorë të tjerë të shërbimit (komunikacion, ngrohje etj.);

> Çmimet relativisht të larta për burimet e tjera të energjisë, i shtynë konsumatorët të fokusohen më shumë në përdorimin e energjisë elektrike;


> Rritja e nivelit të interesit në konsumimin e naftës dhe benzines, posaçërisht në transport, shton kërkesën për import të këtyre produkteve nga furnizuesit kosovarë.

Konsumi i përgjithshëm i energjisë - Konsumi i energjisë është një parametër kyç për vlerësimin e zhvillimit industrial të vendit. Sipas përkufizimeve të EUROSTAT-it, me konsum të energjisë nënkuptohet konsumi final i burimeve për çdo nën sektorë veç e veç. Ky përkufizim përfshin energjinë e shpenzuar e jo atë të dobishme.

Konsumi i burimeve të energjisë - në të gjithë sektorët e ekonomisë në vitet 2005 e 2006 (është paraqitur në figurën 17) nuk dallon pothuaj fare në strukturën e konsumit përfundimtar. Por, krahasuar me vitin 2004 konsumi i energjisë së përgjithshme është rritur për 18 %. Në vitin 2006 konsumi final i energjisë në Kosovë ka qenë 1113

Nga fig. 12 vërehet dominim i konsumit të energjisë në amvisni (30-31%), transport (25-28%) dhe trendi i rritjes së konsumit të energjisë në degët e ndryshme të industrisë (18-21%). Pjesëmarrje më të ulët shfaqin shërbimet e përgjithshme (13%) dhe bujqësia (5 %⁸).

Figura 12: kontributi i secilit sektor në konsumin e energjisë (ktoe)



Konsumi i përgjithshëm i energjisë në periudhën 2003-2006 tregon se nafta dhe nënproduktet e saj janë kontribuuesit kryesor me rreth 60%, energjia elektrike me 25,87 %, drutë e zjarrit me rreth 20 %, thëngjilli me 2,67 %, ngrohja qendrore me rreth 1% dhe energjia solare me 0.1 %.

Intensiteti energjetik - Intensiteti energjetik paraqet raportin në mes të konsumit të realizuar të energjisë ndaj njësisë së bruto produktit vendor. Intensiteti energjetik po trajtohet për herë të parë në Kosovë, andaj në këtë raport

Figura 13. konsumi final i energjisë:





Figura 14. Kontributi i secilit burim energjetik në konsumin final të energjisë (%)



Eficiency energjetike - është një parametër i rëndësishëm për pasqyrimin e gjendjes së sistemit energjetik në Kosovë. Shprehet përmes raportit të konsumit final të energjisë dhe konsumit të përgjithshëm/bruto të saj. Pjesë e këtij raporti është edhe prezantimi i humbjeve të energjisë.

Figura 15. Eficenca energjetike për Kosovë




Figura 16. Konsumi final energjetik dhe humbjet e ener. në sistemin energjetik të Kosovës (ktoe)




Tabela 5. Intensiteti energjetik sipas viteve dhe sektorëve shprehur ktoe/milion €

Viti	Shërbimet			Industria			Transporti			Bujqësia			Total BPV (Mil.€)
	BPV (Mil.€)	Intensiteti (ktoe/Mil.€)	Ktoe	BPV (Mil.€)	Intensiteti (ktoe/Mil.€)	Ktoe	BPV (Mil.€)	Intensiteti (ktoe/Mil.€)	Ktoe	BPV (Mil.€)	Intensiteti (ktoe/Mil.€)	Ktoe	
2003	430.44	0.319896	133.94	255.86	0.846099	210.58	351.94	0.9155447	342.35	1124.76	0.0480212	52.54	2163
2004	443.03	0.294902	118.99	267.44	0.696298	169.60	374.50	0.7444079	341.08	1175.3742	0.0407741	43.65	2260
2005	462.80	0.315717	140.05	269.22	0.846297	218.39	407.19	0.8780696	390.29	1234.1429	0.0451517	53.41	2373
2006	495.20	0.322031	152.01	285.37	0.837834	227.92	423.47	0.8605082	403.67	1299.8404	0.0442486	54.83	2504

⁸ MEM, Bilanci i energjisë së Kosovës për vitin 2006, tetor 2007

Prodhimi i energjisë elektrike

Sektori i energjisë elektrike në Kosovë është i dominuar nga Korporata Energjetike e Kosovës⁹ KEK Sh.A. Sistemi i integruar i energjisë elektrike përbëhet nga dy miniera të linjtit, në Bardh dhe Mirash, nga dy termocentrale të linjtit “Kosova A” dhe “Kosova B”, me kapacitet të përgjithshëm efektiv prej 645 deri 710 Më (nga një kapacitet i instaluar prej 1478 Më), nga rrjeti i bartjes (KOSTT Sh.A.) dhe dispeçingu, nga rrjeti shpërndarjes, dhe nga furnizimi. Gjithashtu, një sasi modeste e energjisë elektrike prodhohet nga hidrocentralet. Burimet kryesore të energjisë (linjtit) në Kosovë gjenden në dy basenat më të mëdha të linjtit, të emërtuara “Kosova” dhe “Dukagjini” Sasia e vlerësuar e linjtit sillet rreth 11.55- 14 miliard tonelata. Hidrocentralet e vetme jashtë KEK-ut, janë hidrocentrali i Gazivodës/Ujmanit (2X 17.5 = 35 Më), i cili administrohet nga kompania e ujitjes (Hidrosistemi Ibër-Lepenc) dhe hidrocentrali “Lumëbardhi”, me kapacitet të instaluar 8,3 Më, i cili operohet nga investitori privat.

98 % e energjisë elektrike në Kosovë prodhohet duke shfrytëzuar linjtin si burim energjie në termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B”. Nga shfrytëzimi i tillë i sasive të mëdha të linjtit, mjedisi përreth objekteve të KEK-ut është mjaft i ndotur. Linjiti i Kosovës, përveç përdorimit në termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B”, më se 20 vite është përdorur edhe për prodhimin e gazit gjeneratorik në repartet e Gazifikimit, në repartin për terjen e tij në Tertore si dhe në kapacitetet tjera industriale. Po ashtu, edhe Ngrohtorja me tri Kaldaja ka qenë shpenzues i konsiderueshëm i linjtit.

Pas ndërprerjes së prodhimit të gazit gjeneratorik, në vitin 1988, KEK-u aktivitetet e veta prodhuese i orienton kryesisht në prodhimin e energjisë elektrike, ngase Kompleksi i Energjetikës dhe Kimisë (Gazifikimi, Azotiku, Tertorja dhe Ngrohtorja) pushuan së vepruari (Azotiku plotësisht, nga Gazifikimi punën jokinuetele e vazhdoi vetëm Ndarja e ajrit), ndërsa i zvogëluan kapacitetet e veta Tertorja, Ndarja e ajrit dhe Ngrohtorja. Shkak i ndërprerjes së prodhimit në këtë kompleks të industrisë kimike ishte ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore me fenole, të cilat ishin pjesë e produkteve të procesit të gazifikimit të linjtit. Në bruto prodhimin e energjisë elektrike është përfshi prodhimi i energjisë elektrike në termocentralet “Kosova A”, “Kosova B” dhe nga hidrocentrali i Ujmanit.¹⁰

Tabela 6. Bruto prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë, GWh

Viti	Bruto prodhimi, GWh
2004	3885
2005	4946
2006	5143
2007	4411


⁹ Strategjia për sektorin e energjisë 2007-2013, MEM-GTP i energjisë, 2006

¹⁰ Zyra e Rregullatorit për energji, Raporte vjetore

Konsumi i energjisë elektrike

Sipas të dhënave nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), bruto konsumi i energjisë elektrike nga viti 2001 deri 2006 ka shënuar rritje të vazhdueshme. Në mënyrë të veçantë vërehet rritja e konsumit të energjisë elektrike në sezonin e dimrit për shkak të shfrytëzimit të saj për ngrohje. Kjo rritje arrin deri në 20 % në krahasim me

Fig. 17. Konsumi i energjisë në sezonin dimër / verë 2001 - 2006



konsumin gjatë sezonit të verës. Krahas rritjes së konsumit gjatë sezonit të dimrit, mjaft të theksuara janë humbjet teknike dhe jo teknike, ngarkesat në rrjetin e transmisionit etj. Këta faktorë kanë ndikuar në mungesën e energjisë elektrike, edhe përkundër importit nga vendet e rajonit nuk janë eliminuar reduktimet e furnizimit të konsumatorëve.

Burimet alternative të energjisë

Potenciali hidroenergjetik i Kosovës - Potenciali hidroenergjetik i Kosovës është mjaft i vogël dhe shfrytëzimi i tij po ashtu, deri në ditët e sotme është modest. Kosovën e karakterizojnë edhe prania e një numri të lumenjve dhe përrenjve me potencial hidroenergjetik i cili mund të shfrytëzohet për prodhimin e energjisë elektrike. Potenciali i shfrytëzueshëm hidroenergjetik i Kosovës është 0.7 Tëh/vit. Pjesa përëndimore e Kosovës disponon potencialin hidroenergjetik të Drinit të Bardhë, i cili përbën me shumë së gjysmën e potencialit hidroenergjetik të Kosovës. Hidrocentrali më i rëndësishëm që mund të ndërtohet në Kosovë është ai i Zhurit, në rrjedhën e Drinit të Bardhë, me potencial 0.377 Tëh/vit. Përveç Drinit të Bardhë, edhe rrjedha e Ibrit, Moravës, Lepencit dhe Llapit karakterizohen me potenciale të rëndësishme për prodhimin e hidroenergjisë. Aktualisht në Kosovë funksionon hidrocentrali i Ujmanit që ka kapacitet prodhues të energjisë prej 2 x 17 Më, dhe pesë hidrocentrale të vogla në rrjetin e shpërndarjes me kapacitet 11.82 Më. Hidrocentrale tjera të vogla janë: Dikanci, Burimi dhe Prizreni. Në Kosovë është në prodhim

edhe hidrocentrali i Kozhnjerit në Deçan, i cili është dhënë me koncesion dhe prodhon një sasi të vogël të energjisë. Sipas Ministrisë së Minierave dhe Energjetikës në Kosovë janë identifikuar edhe 18 burime potenciale për prodhimin e energjisë elektrike.

Si forma të prodhimit të Energjisë nga burimet e ripërtitshme përveç hidrocentraleve janë edhe energjia e diellit, energjia e erës dhe energjia e biomasës. Duhet cekur se Kosova si nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, ka obligim që deri në vitin 2015 t'i plotësoj 10-12%

Të nevojave të energjisë nga burimet e ripërtitshme.

Tabela 7. Potenciali hidroenergjetik i Kosovës¹¹

Hidrocentralet	Fuqia MW	Energjia Gwh
HC ekzistuese ne rrjetin e Distribucionit	11.82	38
HC e rinj që do të ndërtohen	63.7	294
HC Ujmanit	35.0	101
HC Zhur	292.8	398
Totali	403.32	831

Energjia Diellore, (Dielloshja ose insolacioni) - Është element klimatik i cili ka rëndësi në veprimtaritë e ndryshme ekonomike (bujqësi, turizëm, mjekësi) etj. Zgjatja e diellosjes varet nga faktorët astronomik, meteorologjik dhe nga relievi. Dielloshja është më e vogël në luginat e ngushta dhe grykat lumore si dhe në viset malore për shkak të rritjes së vranësirave me rritjen e lartësisë mbidetare.

Në bazë të vërtetimeve të diellzimit në katër stacionet meteorologjike (Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Pejë), Kosova ka mesatarisht 2066 orë me diell gjatë vitit ose mesatarisht 5.7 orë në ditë. Vlerën më të madhe të diellosjes e ka Prishtina me 2140 orë në vit, Peja me 1958 orë, Ferizaj 2067 orë dhe Prizreni me 2099 orë më diell gjatë vitit. Gjatë vitit në muajin korrik ka më së shumti diellosje, kurse në dhjetor më së paku.¹²

Tabela 8. Mesatarja e diellzimit në stacionet kryesore meteorologjike: Prishtinë, Pejë dhe Prizren, 1951 - 2007¹³

Stacionet, Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XIII	Shuma vjetore
Prishtinë	79.8	90.8	123.4	188.4	236.5	248.9	320.2	298.8	230.2	174.7	100	61.3	2153.2
Pejë	67.3	82.2	127.7	178.6	222.6	222.6	293.6	289.4	215.8	147.2	80.2	45.7	1974
Prizreni	66	84.3	121.9	188	235.6	251.9	322.1	305.2	232.2	172.8	95	56.8	2131.8
Vlera mesatare/h	71	85.7	124.3	146	231.9	241	311.9	297.8	226	164.9	91.8	54.6	2086.3

Erërat - Në Kosovë janë dukuri të rëndomta meteorologjike. Në trëndafilin e erërave (mesatarja vjetore dhe sezonale) vërehet ndikimi i topografisë së terrenit në harkun e erërave. Në të gjitha stacionet meteorologjike ku bëhet matja e erërave vërehet rastisja mjaft e lartë e qetësive, dhe vlerën më të madhe e ka Peja (62% të numrit të përgjithshëm të rasteve). Erërat e krahut dominues, zakonisht kanë edhe forcë (shpejtësi) më të madhe. Shpejtësia mesatare e erërave në Kosovë oscillon prej 1,3 m/ sec.9(në Pejë) deri në 2,4 m/sec (në Ferizaj). Dukuritë ekstreme të shpejtësisë së erërave arrijnë mbi 31m/sec, kurse rastisja më e madhe në Mars dhe në Prill, dhe cilësohen si fatkeqësi elementare me pasoja të ndryshme. Në shumë lokalitete erërat kanë emërtime lokale.¹⁴

¹¹ Burimi, MEM

¹² Burimi: prof. Dr. Ruzhdi Pllana, Gjeografia e Kosove 8

¹³ IHMNK, 2007

¹⁴ Burimi: prof. Dr. Ruzhdi Pllana, Gjeografia e Kosove 8

3. INDUSTRIJA

Industria është çelësi i zhvillimit ekonomik të një vendi, por njëkohësisht hynë në radhën e ndikuesve më të mëdhenj në mjedis. Përmes zhvillimit të industrisë harxhohen resurset si: burimet energjetike, uji dhe resurset tjera. Nga aktivitetet industriale lirohen emisione në ujë, ajër dhe tokë. Fatkeqësitë industriale paraqesin një tjetër kërcënim të vazhdueshëm për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Ndërsa, prodhimi i mbeturinave nga shumica e industrive është edhe një segment tjetër i ndikimit të këtij sektori në mjedis.

Vlerësimi i gjendjes

Para vitit 2000, në Kosovë nuk kanë qenë në funksion shumica e ndërmarrjeve të industrisë së rëndë si: Trepça, Ferronikeli, Ballkani dhe shumica e ndërmarrjeve të tjera industriale të sektorit publik. Gjatë kësaj periudhe ndikimi i industrisë në mjedis ka qenë me i vogël, mirëpo edhe përkundër mosfunksionimit të ndërmarrjeve të mëdha industriale në Kosovë, ato kanë pasur ndikim të theksuar në mjedis për shkak se kanë lënë pas vetes një ndotje të madhe dhe shumë kimikate të rrezikshme. Rajoni i Mitrovicës përkundër faktit që Trepça nuk punon, vuan pasojat e ndotjes së kaluar.

Pas vitit 2000, përveç Korporatës Energjetike të Kosovës, e cila ka funksionuar vazhdimisht, kanë filluar aktivitetin e tyre disa nga industritë e rënda përpunuese (Ferronikeli, Llamkosi, Sharr-Cemi, Fabrika e Amortizatorëve, Energoinvesti etj), njëkohësisht janë aktivizuar edhe shumë veprimtari të tjera industriale.

Korporata Energjetike, edhe përkundër investimeve për riparimin e saj mbetet ndotësi më i madh i mjedisit në Kosovë, qoftë përmes lirim të emisioneve në ajër, mbetjeve të hirit dhe ndotjeve tjera. Edhe pse Industria Kimike në Obiliq është jashtë funksionimit, problemi i fenolëve dhe mbetjeve tjera industriale nuk është zgjidhur. Fabrika e Llamkosit, Fabrika e Amortizatorëve dhe Energoinvesti, janë ndotës potenciale të ujërave sipërfaqësore, përmes lirim të ujërave industriale pa bërë trajtimin paraprak të tyre.

Aktualisht zhvillimi i industrisë në Kosovë është ende në nivel të ulët dhe i orientuar kryesisht në industri ushqimore dhe veprimtari tjera me kapacitet të vogël.

Prodhimtaria industriale

Sipas regjistrimit të bizneseve,¹⁵ Industria e minierave, e ekstraktuesve dhe industria përpunuese përbëjnë rreth 10

% të numrit total të bizneseve të regjistruara ose 5531 biznese nga numri total (54412).

Zonat me koncentrim më të madh të ndërmarrjeve industriale janë: Prishtina dhe Prizreni me 864 respektivisht 880 ndërmarrje. Ende nuk ka të dhëna të sakta për numrin e ndërmarrjeve industriale që aplikojnë normat ISO 14001. Po ashtu, nuk ka të dhëna detale as për numrin e ndërmarrjeve që japin prodhime të pastra.

Tabela 9: Numri i bizneseve të regjistruara sipas kategorive, numrit të të punësuarve dhe sektorit të veprimtarisë ekonomike

Kategoritë	Gjithsej	Ndërmarrje			Ndërmarrës individual		
	Subjekte të regjistruara	Gjithsej	1-4	Mbi 5	Gjithsej	1-4	Mbi 5
Veprimtari ekonomike							
Gjithsej	54412	31220	27178	4042	23192	21806	1286
Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria	743	470	353	117	273	180	93
Peshkimi	10	6	4	2	4	4	0
Industria e minierave dhe ekstraktuesve	326	221	145	76	105	75	30
Industria përpunuese	5205	3227	2366	861	1978	1790	188
Furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë	28	22	1	21	6	2	4
Ndërtimtaria	3617	3305	1993	1312	312	213	99
Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave dhe pajisjeve për përdorim personal dhe shtëpiak	27805	15914	15429	485	11891	11438	453
Hotele dhe Restorante	4699	1379	1182	197	3320	3142	178
Transporti, magazinimi dhe komunikacioni	7120	4231	3629	602	2889	2800	89
Ndërmjetësimi financiar	93	48	38	10	45	22	23
Afarizmi me pasuri të patundshme, dhënia me qira dhe shërbime të afarizmit	1383	824	706	118	559	517	42
Arsimi	476	358	309	49	118	91	27
Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	582	419	352	67	163	150	13
Veprimtari të tjera shoqërore të shërbimeve dhe personale	2325	796	671	125	1529	1482	47


Aksidentet industriale

Nga aksidentet industriale që kanë ndodhur gjatë periudhës 1999-2007, duhet të veçohet zjarri në Termocentralin e Korporatës Energjetike të Kosovës në Obiliq në vitin 2002. Sipas njoftimeve zyrtare objektet e "Kosovës B" ishin goditur nga rrufeja, që shkaktoi zjarr të madh me ç'rast humbi jetën një person dhe u lënduan 32 veta. Nuk është bërë vlerësimi i ndikimit në mjedis nga kjo fatkeqësi industriale.

¹⁵ Enti i Statistikave të Kosovës, 2003

Numri i bizneseve aktive sipas komunave në Kosovë

Harta 1. Harta e shpërndarjes së bizneseve aktive sipas komunave



Ministria e Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor
Agjencia e Kosovës për
Mbrotjtjen e Mjedisit



Sistemi Informativ Mjedisor / GIS

Emri i Hartës:
Numri i bizneseve aktive sipas
komunave
Burimi i të dhënave: MTI / AKMM

Projeksioni : UTM-WGS 84
Zona: 34 HV
Data: nëntor, 2007
Prishtinë

Adresa: Rr. Nazim Gafurri nr.31
info@akmm.gov.net

LEGJENDA

Numri i Bizneseve	
0 deri 1000 (8)	
1000 deri 1500 (3)	
1500 deri 2000 (8)	
2000 deri 4100 (4)	
4100 deri 19500 (7)	

Minierat dhe Mineralet

Linjiti-ka rëndësi të jashtëzakonshme për Kosovën. Ai kontribuon 97 % të prodhimit të energjisë totale elektrike. Me 14.7 miliard ton, Kosova zotëron vendin e pestë me rezervat industriale të linjtit në Evropë. Linjiti është i shpërndarë përmes pellgjeve të Kosovës, Dukagjinit dhe Drenicës. Shfrytëzimi i linjtit ka qenë i kufizuar vetëm në pellgun e Kosovës. Historikisht shfrytëzimi i linjtit daton qysh prej vitit 1922, kur filloi shfrytëzimi me punime nëntokësore të cekëta në shkallë të vogël në pellgun e Kosovës. Shfrytëzimi në shkallë të gjerë filloi me prodhimin e parë në qiell të hapur në Mirash (1958) dhe Bardh (1969) duke përdorur ekskavatorë modernë dhe transportierë. Shfrytëzimi kumulativ nga fillimi i minierës në vitin 1922 deri në fund të vitit 2004 ka arritur në 265 milion ton. Gjeologjikisht shfrytëzimi i minierave të linjtit të Kosovës është një nga vendburimet më të favorshme të linjtit në Evropë. Raporti mesatar i heqjes së mbulesës është 1.7 m³ për 1 ton qymyr, dhe në total i vlerësuar ekonomikisht vendburimi i shfrytëzueshëm përfaqëson një nga më të pasurit në Evropë, që do të lejojë prodhimin ambicioz të energjisë elektrike dhe zgjerimin e skemave për dekadat e ardhshme.¹⁶

Plumbi, Zinku dhe Argjendi - Shfrytëzimi minerarë i rezervave të Pb, Zn dhe Ag, në Kosovë ka filluar në vitin 1930, kur kompania britanike Selection Trust Ltd, rikonstruktioi Kompleksin Trepça, duke përfshirë zhvillimin e fabrikës së baterive që përdorte plumbin. Shfrytëzimi minerarë aktiv i pesë minierave pushoi gjatë fushatës së bombardimeve nga NATO.

Vendet e minierave të Trepçës përcaktojnë Brezin Mineral të Trepçës. Atje ndodhen tri zona minerailimi me drejtim shtrirjeje Vvp JLL, brenda këtij brezi dhe përmbajnë vendburime xeherore.

- > Zona I, përfshin minierën e Artanës (Novo Berda) dhe ndjek kufirin midis zonës së Vardarit dhe sektorit të Kosovës, që është e karakterizuar nga shkëmbinj vullkaniko kalcium alkaline ekstensive të Neogjenit dhe intruzive.

- > Zona II, përfshin minierat Belo Brdo, Stan Terg dhe Hajvalia. Kjo zonë ndjek shkarjen madhore që shënon brezin lindorë të pellgut Miocenik të Prishtinës dhe shtrirjen e saj në V-VP dhe komplekset intruzive dhe vullkanike në Kosovën veriore.
- > Zona III përfshin minierën e Crnait dhe ka në gjirin e vet një numër vendburimesh të plumb zinkut gjatë kufirit perëndimor, ku është në kontakt me bllokun strukturor të Dinarideve.

Për të pesë minierat dhe rezervat e shfrytëzueshme janë ndërmarrë vlerësime, por thellësia dhe gjatësitë e përhapjes së tyre janë të pasigurta, pasi mungon kërkimi sistematik dhe përcaktimi me shpime. Gjatë shfrytëzimit të plumb zinkut argjendit, në Përroin e ngjyrosur (Artana-Novo Brdo), u zbuluan rreth 3 Mt hollojzitet i shkallës së lartë Al₂O₃(OH)z.

Tabela 11. Rezervat e Pb, Zn dhe Ag, në disa miniera të Kosovës¹⁷

Miniera	Ton	Pb%	Zn%	Ag g/t
Belo Brdo	1,340,000	6.59	5.74	97.4
Crnac	1,648,000	7.57	2.93	102.0
Stan Terg	432,000	5.10	2.21	80.5
Hajvalia	723,000	9.65	18.26	126.4
Artana-Novo Brdo	2,700,000	4.43	5.42	140.6
Totali	6,843,000	6.20	6.04	117.6

Nikeli - Shfrytëzimi sipërfaqësor në vitet e mëparshme bazuar në lateritë, u ndërmor në Çikatovë (Dushkaja dhe Suke) dhe Gllavicë. Rezervat e shfrytëzueshme të mbetura kanë qenë të llogaritura në 13.2 Mt me 1.42 % Ni dhe 0.05 % Co mesatarisht. Prodhimi ka rifilluar në vitin 2006.


Tabela 12. Rezervat e Nikelit

Vendi	Ton	Ni%	Co%	Fe ₂ O ₃	SiO ₂	MgO
Dushkaja	6,350,000	1.29	0.05	24.29	44.09	9.33
Suke	630,000	1.36	0.06	30.56	49.17	9.48
Gllavica	6,240,000	1.55	0.05	21.53	50.89	13.52
Totali	13,220,000	1.42	0.05	23.29	47.54	11.32

¹⁶ Komisioni i pavarur i minierave dhe mineraleve, www.kosovo-mining.org

¹⁷ Sipas, Riinvest

Kromi - Nga fundi i Luftës së II Botërore deri në vitin 1956, xeheroret e kromit shfrytëzoheshin në fillim nga miniera e Gjakovës nga “Deva Holding Company” dhe drejtpërsëdrejti transportohej për në Shqipëri për trajtim. Kur xeherori i pasur u pakësua, Kosova filloi të importojë nga Shqipëria 30 000 50 000 t/vit kromit. Kjo gjë u ndërpre kur impianti u mbyll në vitin 1991, dhe për shumë dekada nuk janë ndërmarrë kërkime për kromit.

Harta 2. Harta e minierave të Kosovës²²

Boksitet - Vendburimet e boksiteve të Kosovës gjenden në gëlqerorët e karstezuar dhe janë shfrytëzuar me një sërë punimesh minerare, që përbejnë minierën e Grebnikut. Gëlqerorët që kanë boksitet në gjirin e tyre janë shfrytëzuar gjithashtu si material ndërtimi dhe mjaft mbetje të gëlqerorëve të coptuar gjenden në vend. Shfrytëzimi mineral ka filluar në vitin 1966 dhe është ndaluar në vitin 1999.²³

Magneziti - Kosova zotëron dy miniera magneziti ($MgCO_3$) në Golesh dhe Strezovc, të cilat kanë zhvilluar punimet nëntokësore për shfrytëzimin e magnezitit deri në mbylljen e tyre në vitin 1999. Përpara vitit 1990, në Golesh prodhohej 110 000 ton magnezit, 22 000 ton magnezium dhe 10000 ton magnezium kaustik të kalçinuar, për vit. Miniera e Goleshit është shfrytëzuar me një pus minerar, ndërsa miniera Strezovc me anë të një galerie në anë të kodrës.

Tabela.13. Rezervat e magnezitit

Miniera	ton	MgO%	SiO2%	CaO%
Golesh	1,740,000	46.23	2.66	0.95
Strezovc	3,660,000	40.49	6.29	5.45
Totali	5,400,000	42.34	5.12	4.00

Hekuri- Xeherorët hekurit e në Kosovë janë të njohura në rajonin Çar - Sadllarë dhe Tërstenik-Carralevë - Ivajë, në formë të vendburimeve mesatare ose të trupave të xeherorëve të shpërndarë. Me hulumtimet geologjike në Carralevë- Sadllarë janë verifikuar rezerva të hekurit prej afër 750.000 tonë, me 40% Fe, ndërsa në zonën Tërstenik Carralevë -Ivajë, rezervat e hekur-nikelit janë afër 2.500.000 ton, me përbërje Fe 45/55 %, $Cr_2O_3 = 3\%$ dhe Ni = 069 %. Në Carralevë deri në vitin 1940 janë shfrytëzuar afër 20.000 tonë xeheror për shkrirje në shkretoren e Jasenicës. Xeheroret e Carralevës përveç hekurit përmbajnë edhe nikel dhe krom, kështu që me shkrirjen e drejtpërsëdrejti të tyre mund të fitohet legura (aliazhe) të çeliqueve të dobëta.

Urani- Në lokalitetin Stubovaqë (15 km në jug të Gjilanit) në trohte është konstatuar një damar (dell) i pasur me Uranium. Është vlerësuar që në këtë lokalitet mund të shfrytëzohen afër 20/tonë të uranit, me përbërje mesatarisht 0.0263 %.

Kosova është e pasur me minerale ndërtimi të cilësisë së lartë, si: andezitet, bazaltet, diabazet, gabrot, granitet, gëlqerorët dhe mermerët. Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhënat për burimet kryesore dhe rezervat për këto minerale.

Tabela 14. Rezervat e disa burimeve minerare të Kosovës²⁴

Burimet	Lloji	Rezerva
Karaçevce (Dardane)	Kaolinit	3.000.000 t
Hani i Elezit (Ivaje + Terpeze)	Shkrirje + gëlqere + shtuf gëlqeror	7.500.000 t
Hani i Elezit (Mullinjet e palit)	Shkrirje	2.500.000 (m ³)
Ferizaj (Mirosalc) Lypjan (Sllovi)	Rere kuarc	13.000.000 t
Gjakove, Dardane Landovice, Skenderaj, Kline, Ferizaj, Peje, Viti, Prishtine, Podujeve	Argjile	2.500.000 (m ³)
Viti (Gushice, Sadovine e Jerlive)	Bentonit	36.000.000 t
Glame, Çikatovc, Kroj i mbretit, Grebnik, babush i Muhaxhereve, Shale e Drenices, Lipoglave et	Gëlqere dhe dolomit	42.000.000 (m ³)
Volljak, Leshan, Piranë, Krushë, Pejë	Rërë dhe zhavor	>10.000.000 (m ³)

²² MEM²³ Komisioni i pavarur i minierave dhe mineraleve, ëëë.kosovo-mining.org²⁴ Komisioni i pavarur i minierave dhe mineraleve, ëëë.kosovo-mining.org

4. BUJQËSIA

Vlerësimi i gjendjes

Bujqësia në Kosovë në të kaluarën ka qenë njëri ndër sektorët kryesor të punësimit dhe i sigurimit të të ardhurave. Krahasuar me vitet '90, pas vitit 2000 ka qenë e theksuar tendenca e rritjes së prodhimitarisë bujqësore dhe po ashtu, edhe tendenca e ndryshimit të zhvillimit të bujqësisë. Është shtuar numri i fermave dhe prodhuesve bujqësorë. Është shtuar përdorimi i kemikateve dhe produkteve tjera me ndikim negativ në mjedis. Në Kosovë ende nuk ka ndonjë interesim të theksuar për prodhimin e produkteve ekologjike.

Edhe pse 53 % e sipërfaqes së Kosovës është cilësuar tokë bujqësore, vetëm 3.9 % e forcës punëtore janë të punësuar në bujqësi. Nga totali i tokës bujqësore rreth 73% është tokë e punuar, ndërsa pjesa tjetër është toka nën pyll si dhe oborre të shtëpive.

Kosova nuk i përmbush nevojat e popullsisë në prodhimtarinë e ushqimit andaj, importi i produkteve ushqimore është i domosdoshëm. Në mungesë të laboratorëve të certifikuar importohen ushqime me kualitet të dyshimtë dhe shpesh pa ndonjë kontroll të mirëfillt në pikat hyrëse

Sipërfaqet bujqësore

Tokë bujqësore në pronësi private është 88,6 %, ndërsa pjesa tjetër është në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore. Sipërfaqja e tokës bujqësore për kokë banori vlerësohet se është rreth 15 ari.

Tabela 15. Lloji i pronës së tokës²⁵

	Sipërfaqja (‘000 ha)	Sipërfaqja (%)
Agrokombinatet	76	13
Kooperativat	7	1
Fermtat familjare	494 ¹⁴	86
Gjithsej	577¹⁵	100

Bujqësia i kontribuon rreth 30% Bruto Produktit Shoqëror (BPSH) të Kosovës dhe aktualisht mbështet nga mbi 60 % e popullsisë, kurse bashkë me pylltarinë japin 35 % të BPSH. Vetëm 6% e të korrave vjetore shiten, të tjerat përdoren ose për konsum njerëzorë apo si ushqim për kafshët. Produktet e bagëtisë shiten deri në vlerën € 20.3. Shpenzimet agronomike të përdorura në Kosovë janë €20, përderisa shpenzimet totale të bujqësisë janë €89.7.

Bazuar në të dhënat statistikore, banorët e Kosovës rreth 55 % të buxhetit familjarë e ndajnë për sigurimin e ushqimit, e që është më i lartë se mesatarja e vendeve të BE (22%). Përderisa dendësia e banimit në Kosovë është rreth 204 banorë /km², sipërfaqja e tokës bujqësore për kokë banori është rreth 0.15-0.18 ha tokë. Krahasuar me mesataren e BE-së (0.52 ha/banorë), kjo shifër është me pak se gjysma.²⁶

Përafërsisht 87% të tokës bujqësore, përfshirë këtu 90 % deri 95 % të tokës së kultivuar, 30% të kullosave dhe 38% të tokës pyjore është nën pronën private. Prodhimtaria bimore në Kosovë është e dominuar nga prodhimtaria e drithërave që përfshinë 33.5% të sipërfaqes bujqësore.

Tabela 16: Ndarta e tokës bujqësore sipas kulturave

Kulturat	ha	%
Drithëra	193.078	33.46
Bimë vajore	2.520	0.44
Perime	21.500	3.73
Patate	7.500	1.30
Vreshta	4.944	0.85
Pemë	4.542	0.80
Kullosa	166.769	28.90
Livadhe	86.000	14.90
Bimë foragjere	38.000	6.59
E pa kultivuar (djerrinë)	52.200	9.03
Gjithsej	577.200	100

Cilësia e tokës në Kosovë vlerësohet si e ndryshueshme, si rezultat i ndikimit të shumë faktorëve gjatë historisë gjeologjike. Toka e punueshme është klasifikuar në 8 klasë të bonitetit. 5 klasat e para përdoren në prodhimtarinë bujqësore. Tokat e klasës I dhe II, me 91,900 ha bëjnë pjesë në ato më pjelloret, me aftësi të larta prodhuese. Tokat e klasës së III, me 96,000 ha janë ende toka të mira për punim dhe shfrytëzim, por për nga pjelloria ngecin nga dy të parat. Tokat e këtij grupi kërkojnë disa përmirësime për tu kthyer në toka me aftësi të lartë produktiviteti. Tokat e klasës së IV, me 208,000 ha, karakterizohen me aftësi të kufizuara pjellore, si toka të cekëta dhe me përmbajtje të lartë të rërës. Në mungesë të mbrojtjes institucionale, një pjesë e tokave pjellore përdoren për nevoja tjera. Kjo ka rezultuar në zvogëlimin e vazhdueshëm të sipërfaqeve.]


-  Humbjet e përhershme të tokës (vendbanimet, veprimtaritë komerciale, industria, komunikacioni, akumulimet e ujit, aeroportet etj);
-  Humbjet e përkohshme të tokës (mihjet sipërfaqësore, eksploatimi i rërës, zhavorrit dhe argjilës, hedhurinat e automjeteve, depozitimi i mbeturinave industriale, mbeturinat komunale, procesi i erozionit, degradimi, gjërryerjet e lumenjve etj.).

²⁵ MBPZHR, Libri i gjelbër i Kosovës, 2003

²⁶ MBPZHR, Libri i gjelbër i Kosovës, 2003

Harta 3. Harta e bonitetit të tokave

Harta e Bonitetit



Ministria e Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor
Agjencia e Kosovës për
Mbrotjtjen e Mjedisit



Sistemi Informativ Mjedisor / GIS
Emri i Hartës:
Harta e Bonitetit në Kosovë
Burimi i të dhënave:
Atlasi Hidroekonomik / AKMM
Projeksioni : UTM-WGS 84
Zona: 34 HV
Data: nëntor, 2007
Prishtinë
Adresa: Rr. Nazim Gafuri nr.31
info@sim@ks-gov.net


LEGJENDA

- Kufiri i Kosovës
- Klasa e bonitetit 1
- Klasa e bonitetit 2
- Klasa e bonitetit 3
- Klasa e bonitetit 4
- Klasa e bonitetit 5
- Klasa e bonitetit 6
- Klasa e bonitetit 7
- Klasa e bonitetit 8

Tabela 19. Përdorimi i pesticideve sipas sektorëve³¹


Sektori	%
Bujqësi	88.8
Blegtori dhe veterinari	3.4
Higjiene komunale	3.3
Industri dhe përpunim të ushqimit	2.9
Të tjera	1.6

Grafikoni 20. Përdorimi i pesticideve sipas llojit



Shërndarja dhe përdorimi i plehrave minerale sipas regjioneve në Kosovë nuk është i njëtrajtshëm. Nivelet më të larta të përdorimit më shumë se 50 kg/ha materie ushqyese të tretshme për bimë (N+ P₂O₅ dhe K₂O) vihen re në regionet ku kultivohen drithërat dhe perimet, ndërsa në pemishte dhe vreshta kjo sasi është shumë e ulët. Plehtrat minerale gjatë qarkullimit të vetë nuk mbesin në të shumtën e rasteve në formë fillestare. Prandaj ato hyjnë në reaksione dhe fitohen materie më shumë toksike ose kompozime sekondare, kështu që, nëse ka një përdorim jo profesional dhe i pa bazuar në kërkesat e tokës do të shkaktonte ndotje të mjedisit. Plehtrat që përmbajnë azot dhe kalium janë helmuese, prandaj sasi të tepërta në tokë janë ndotës për mjedisin, ndërsa sasi të përdoren në Kosovë janë deri 600 kg/ha, me një ndryshim me sasi më të madhe apo më të vogël, varësisht nga kërkesat dhe lloji i kulturave. Në treg zakonisht gjenden plehtrat minerale: NPK, NAG, URE e më pak MAP, DAP apo superfosfat dhe plehra në formë të lëngshme si ushqim foliar. Përafërsisht 4,757,500 kilogram të pesticideve janë importuar në Kosovë në vitin 2005.

Grafikoni 21. Përdorimi i plehrave artificiale sipas llojit



Peshkimi dhe akuakultura

Në Kosovë ka vetëm peshkim sportiv - rekreativ (anglers në anglisht) që nënkupton peshkimin me grepa për sport dhe rekreacion. Peshkim ekonomik nuk bëhet, sepse Kosova nuk ka resurse për zhvillimin e këtij lloji peshkimi i cili nënkupton peshkimin me qëllim të përfitimit ekonomik. Kjo veprimtari e peshkimit ka pak gjasa të ndodhë në një të ardhme të afërt. Deri me tani nuk ka ndonjë zonë të mbrojtur me ligj sa i përket peshkimit.

Peshkimi sportiv rekreativ deri diku është i organizuar nëpërmjet Federatës së Peshkatarëve e cila e bënë kontrollin nëpërmjet 14 shoqatave lokale të peshkatarëve. Dukuri shqetësues paraqet peshkimi ilegal. Kjo veprimtari e peshkatarëve ilegal shpeshherë haset në periudhën e riprodhimit të peshqve duke ndikuar në zvogëlimin e fondit të tyre, gjë që është e ndaluar rreptësisht me Ligjin e Peshkatarisë dhe Akuakultures.

Aktualisht, në Kosovë prodhohen rreth 500 deri 600 ton peshk të llojit trofta e Kalifornisë (Oncorhynchus mykiss)

Janë gjithsej 13 ferma për kultivimin e troftës dhe një e krapit. Kjo do të thotë që afërsisht përdoren rreth 600 ton ushqim i pasur me proteina (si ndotës të ambientit me N dhe P) në fermat e troftës. Ndotës tjerë janë edhe medikamentet e ndryshme siç janë antibiotikët, dezinfektantët si dhe antiparazitikët.

Peshku në ferma është i përmirësuar gjenetikisht; kjo mund të ketë një ndikim gjenetik në peshkun e egër, aty ku ka troftë në lumenj.

Një problem tjetër potencial mund të jetë bartja e sëmundjeve nga fermat e peshkut në peshkun e egër. Sëmundja mund të vjen edhe nga vendet jashtë Kosovës, kur dihet se importohen peshk dhe vezë (ikra).

Gjithashtu, prodhohen edhe rreth 40 ton krap, që është ndotës me i vogël për shkak të llojit të ushqimit të përdorur (drithëra).

5. PYLLTARIA

Pyyjet janë ekosistemet më të përparuara natyrore dhe kanë rendësi shumë të madhe, sepse janë ekosisteme me biodiversitet shumë të pasur. Pyjet janë rregullatorë natyror të klimës, ruajnë kualitetin e ujit, ajrit, ato mbrojnë tokën nga erozioni dhe nga shpëlarja e shtresës produktive të tokës. Pyjet po ashtu, janë akumuluesit më të mëdhenj të sasisë së CO₂ në tokë dhe furnizuesit kryesorë të atmosferës me Oksigjen. Janë resurse natyrore ripërtëritëse, produktet e të cilave mund të shfrytëzohen në industri, për djegie dhe për qëllime tjera. Pyjet janë ekosisteme në të cilat rriten një numër i madh i llojeve bimore dhe shtazore me rendësi ushqyese dhe mjekësore për njeriun. Ato përveç se pengojnë erërat e fuqishme janë edhe ambient çlodhës për njeriun. Megjithatë, ndikimi i njeriut në pyje është shumë i theksuar. Janë të ndjeshme sidomos në ndotje të ajrit. Prerja e pakontrolluar e pyjeve ndikon në shfaqjen e shumë ndryshimeve mjedisore, si ndryshimet klimatike, vërshimet etj.

Vlerësimi i gjendjes

Rreth 47% të gjithë territorit të Kosovës përbëhet nga pyjet, tokat pyjore dhe djerrinat, ose rreth 512.400 ha të sipërfaqes së përgjithshme. Prej kësaj, sipërfaqe pyjore janë 460.800, ose 89.93%, toka tjera pyjore janë 28.200 ha ose 5.50%, dhe djerrina 23.400 ha ose 4.57%. Pyjet në Kosovë paraqesin një resurs shumë të rëndësishëm. Mirëpo, si pasojë e menaxhimit jo adekuat të pyjeve në të kaluarën ka ardhur deri të degradimi i tyre. Rreth 284.000 ha (61.63%) e sipërfaqes pyjore është në pronësi publike, pjesa tjetër 176.800 ha (38.37%) është në pronësi private. Rreth 222.000m³ të drurit teknik dhe drurit për djegie, eksploatohet nga të dy sektorët në vit. Masa drunore e tërësishme është rreth 54 milion m³. Vëllimi mesatar i drunjëve për ha është përafërsisht 90m³, dhe rritja mesatare vjetore arrin përafërsisht 3m³ për ha. Kërkesat e mëdha për drurin në kohën e pasluftës vendosin presion të madh në qëndrueshmërinë e pyjeve dhe ekosistemeve të Kosovës. Druri kryesisht përdoret për ngrohje dhe ndërtim.

Eksploatimi ilegal i pyjeve është një problem i madh dhe nuk ekziston ndonjë zgjidhje alternative për ngrohje. Prerja ilegale dhe të pakontrolluara kanë shkaktuar edhe erozione në zonat malore. Pyjet janë shkatërruar edhe nga zjarret. Sipas Departamentit të Pylltarisë në Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 3.263 ha të pyjeve janë shkatërruar nga zjarri vetëm në vitin 2000.³³

Shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve pyjore

Shfrytëzimi dhe menaxhimi i pyjeve rregullohet me Ligjin për Mbrojtjen e Pyjeve. Me pyjet e Kosovës, menaxhon Agjencioni Pyjor i Kosovës. Në vitin 2006 ka filluar të zbatohet një projekt dy vjeçar i financuar nga AER, i cili ka për qëllim shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyjeve, duke përfshirë edhe menaxhimin e pyjeve brenda Parqeve Kombëtare. Pyjet e Kosovës janë të ndara në: pyje të larta, pyje të ulëta, shkurre dhe pyje të degraduara. Pjesën më të madhe të pyjeve të Kosovës e përbejnë pyjet e ulëta (42 %), ndërsa pjesën më të vogël pyjet e larta (15 %).

Tabela 21. Pyjet e Kosovës sipas llojit dhe pronësisë në ha dhe %³⁵

Lloji i pyjeve	Pronësia			%
	Shtetërore	Private	Gjithsejtë	
Pyje të larta	51000	15000	66000	15
Pyje të ulëta	116000	63000	179000	42
Pyje të degraduara	34000	48000	82000	20
Shkurre/kaçuba	67000	36000	103000	23
Gjithsej	268000	162000	430000	100

Sipas inventarizimit nacional të pyjeve, me pyllëzim natyror janë përfshirë rreth 82.000 ha pyje të sektorit publik dhe 74.000 ha pyje të sektorit privat, kurse me pyllëzim artificial 1.800 ha pyje të sektorit publik dhe 400 ha pyje të sektorit privat. Sipërfaqja e pyjeve, përkohësisht pa trungje, përfshinë rreth 21.200 ha të pyjeve në sektorin publik dhe 7.600 ha pyje të sektorit privat. Mbi 50.000 ha të pyjeve janë të shtrira në Zona të Mbrojtura. Pjesa më e madhe e tyre i takon Parkut Nacional "Mali Sharr" (18.884 ha) dhe "Gërmisë" (885 ha) Sipërfaqja e pyjeve të mbrojtura ka tendencë rritjeje.³⁶

Tabela 20. Pyllëzimi sipas llojit dhe pronësisë³⁴

Lloji i pyllëzimit	Pyje publike	Private	E panjohur	Gjithsej
Përkohësisht pa trungje	21.200	7.600	3.400	32.200
Pyllëzim natyror	82.000	74.000	15.200	171.200
Pyllëzim artificial	1.800	400	---	36.600
Pyllëzim i përzier	64.000	54.000	19.000	137.000

³² Agjencioni Pyjor i Kosovës

³³ PKVM, 2006

³⁴ Burimi: Inventarizimi nacional i pyjeve (MBPZHR, 2003)

³⁵ APK

³⁶ IKMN

Prodhimtaria e pyjeve

Sipas të dhënave nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës, shtimi vjetor i masës drusore të pyjeve të Kosovës është 1.16500 m³/vit. Volumi mesatar i pyjeve është 114 m³/ha, ndërsa mundësia e shfrytëzimit është llogaritur të jetë rreth 900.000 m³. Volumi mesatar i masës drusore në pyjet e Kosovës është 53 milion m³. Volumi i masës drusore në pyjet publike është 33.5 milion m³, ndërsa në pyjet private volumi i masës drusore është rreth 19.5 milion m³. Sipas inventarizimit të pyjeve të realizuar në vitin 2003, sasia e propozuar për prerje është 935.00 m³ në vit. Ndërsa sipas planit vjetor të menaxhimit të pyjeve sasia e planifikuar e prerjes së pyjeve për të dy sektorët është 255.000 m³/vit. (APK, 2006)

Pjesa më e madhe e pyjeve të Kosovës rreth 50 %, i takon vjetërsisë prej 0-20 vjet, ndërsa pjesa më e vogël e pyjeve rreth 17 % i takon vjetërsisë 60-80 vjet.

Tabela 22. Klasa e vjetërsisë së pyjeve sipas pronësisë në %³⁷

Klasa e vjetërsisë	Pyje publike	Pyje private
0-20	29 %	23 %
20-40	18 %	32 %
40-60	11 %	23 %
60-80	9 %	8 %

Dëmtimet e pyjeve

Zjarret - Sipas të dhënave të prezantuara në Raportin e publikuar nga komisioni për vlerësimin e gjendjes së pyjeve të dëmtuara nga zjarri, rreth 6.690 ha e pyjeve të Kosovës gjatë vitit 2007 është përfshirë nga zjarri. Nga kjo sipërfaqe 4.142 ha janë pronë publike, ndërsa 2.548 ha janë pronë private. Rreth 1.439 ha e sipërfaqes së dëmtuar nga zjarri është kullota. Vëllimi i humbur në m³ dru zjarri shprehur në Euro llogaritet rreth 29.645, ndërsa vëllimi i humbur në m³ dru teknik është 17.170. Vlera e humbur e masës drusore në këmbë është 2.942.338.

Prerja e drurëve - Sipas Agjencionit Pyjor të Kosovës, në Kosovë brenda vitit, në të dy sektorët (publik dhe privat) në mënyrë legale mesatarisht priten 185.890 m³ dru teknik dhe për djegie. Mesatarja vjetore e prerjeve për dru teknik është rreth 30.200 m³, ndërsa dru zjarri 146.000 m³. Për prerjen ilegale të drurëve nuk ka shënime të sakta, por sipas vlerësimeve të APK-së, ajo është më e lartë se sa prerja legale. Bazuar në Raportin e Agjencisë Pyjore të Kosovës për vitin 2003 vetëm nga prerjet ilegale janë evidentuar 10.471 m³ dru, shprehur në vlerë financiare është 1.713.132,00 €.

³⁷ APK 2006

Tabela 23. Damet e shkaktuara nga zjarret në periudhën korrik - gusht 2007

Komuna	Sipërfaqja në ha me pyje	Pyjet					Demet në Bujqësi	Demet tjera shtëpi, objekte, trafo, shrylla	Gjithsej t në € (8+9+10)	Rivitalizim i sanimi i gjendjes	Gjithsej humbjet në pyje (8+12)	Gjithsej (11+12)
		Pronë publike	Pronë private	Kullosa (ha)	Vellimi i humbur në m3 dru zjarri	Vellimi i humbur në m3 dru teknik						
Vushtri	311	175	136	0	22116	0	14493	0	180325	637550	803382	817875
Dragash	24	0	0	0	16786	0	0	0	6189	49200	55389	55389
Podujevë	147	73	74	0	0	0	24083	47413	277218	301350	507072	578568
Ferizaj	37	18	19	0	0	0	750	17890	71840	75850	129050	147690
Kastriot	0	0	0	0	0	0	1300	1381	2681	0	0	2681
Skenderaj	125	50	75	0	0	0	0	27000	60000	256250	289250	316250
Suharekë	346	131	215	0	0	0	11085	33950	82671	709300	746936	791971
Drenas	421	164	257	0	0	0	37600	38967	202867	863050	989350	1065917
Gjilani	253	183	70	0	0	0	18720	26770	145129	518650	618289	663779
Shtime	45	15	30	0	0	0	0	0	23040	92250	115290	115290
Kaçanik	37	37	0	0	0	0	0	0	78741	75850	154591	154591
Deçan	72	35	37	0	0	0	20000	50200	102684	147600	180084	250284
Malishevë	128	65	62	0	0	0	2000	42300	82700	262400	300800	345100
Lipjani	231	183	48	0	0	0	1995	15470	108485	473550	564570	582035
Peja	101	99	2	0	0	0	0	10400	217908	207050	414558	424958
Kamenicë	644.5	283.5	361	0	0	0	5400	27625	257715	1321225	1545915	1578940
Hani i Elezit	11	0	11	0	0	0	400	0	11300	22550	33450	33850
Rahoveci	142	139	3	0	0	0	0	0	30791	291100	321891	321891
Viti	140	130	10	0	0	0	15000	56700	129760	287000	345060	416760
Novo Bërda	2.45	0.95	1.5	0	0	0	0	0	1880	5022.5	6903	6903
Istogu	607	207	400	683	5125	14980	0	0	480150	1244350	1724500	1724500
Gjakovë	659	473	216	0	0	0	0	0	82352	1350950	1433302	1433302
Mitrovica	197.5	139.5	58	100	0	0	20700	139450	441174	404875	685899	846049
Klina	496.81	82.81	414	0	0	0	0	0	229119	1018460.5	1247580	1247580
Fushë Kosova	69	24	45	0	0	0	0	0	27600	141450	169050	169050
Prizren	1405	1401.5	3.5	206	1871	2190	62560	0	357721	2880250	3175411	3237971
Zubin Potok	15	15	0	203	160	0	0	0	9600	30750	40350	40350
Leposaviq	15	15	0	247	205	0	0	0	12300	30750	43050	43050
Shtërpçë												
Zveçan												
Gjithsej	6690	4142	2548	1439	29645	17170	236086	535516	3713940	13698633	16640971	17412573

6. TRANSPORTI

Transporti ndikon në cilësinë e përgjithshme të mjedisit, posaçërisht në mjediset urbane. Shumica e automjeteve përdorin naftën, çka nënkupton lirim të emisioneve në ajër, ujë dhe tokë. Gjithashtu, gjatë ndërtimit të rrugëve bëhen ndryshime të peizazhit dhe të tokave, përfshirë këtu edhe degradimin e mundshëm të habitateve. Automjetet e papërdorshme paraqesin po ashtu, një rrezik serioz për mjedisin. Nga transporti i materieve të rrezikshme mund të vijë edhe deri të aksidentet me pasoja fatale për mjedisin.

Vlerësimi gjendjes

Kosova ka rrjet rrugor prej 1925.10 km, me rrugë magjistrale dhe regjionale, 330 km sistem një binarësh hekurudhor, si dhe aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës. Bazuar në këto të dhëna dendësia e rrjetit rrugor është relativisht e ulët, përafërsisht 0.18 km/km². Pjesa dërmuese e rrjetit rrugor mirëmbahet, por në standarde shumë të ulëta, 25% e rrjetit të rrugëve kryesore dhe rajonale kanë nevojë për rehabilitim. Shumë prej automjeteve janë më të vjetra se 20 vjet, dhe një numër i konsiderueshëm i tyre teknikisht nuk janë në rregull. Përdorimi i karburanteve të cilësisë së ulët dhe automjete pa katalizator të përshtatshëm janë mjaft prezentë. Sektori i transportit është mjaft specifik në raport me mjedisin, ngase paraqet ndikime negative serioze gjatë ndërtimit dhe operimit. Transporti ndikon në cilësinë e përgjithshme të mjedisit në Kosovë posaçërisht në mjediset urbane, duke ndotur ajrin, ujërat dhe tokën. Transporti kontribuon edhe në ndryshimet klimatike, ndryshimet e peizazhit dhe shfrytëzimit të tokës, përfshirë këtu edhe degradimin e habitateve dhe trashëgimisë kulturore gjatë fazave të ndërtimit. Automjetet mbeturinë paraqesin po ashtu, problem për mjedisin.³⁸

Tabela 24. Kategorizimi i rrugëve

Kategoria e rrugës	Lloji i sipërfaqes së qarkullimit (konsumit)				
	Rrugë të asfaltuara		Rrugë të paasfaltuara		Gjithsejtë
	Km.	%	Km.	%	
Magjistrale	625.50	99.2	4.9	0.78	630.40
Regjionale	1013.70	78.3	281.0	21.70	1294.70
Gjithsej:	1639.20	85.15	285.9	14.85	1925.10

Infrastruktura rrugore


Kosova ka 7425.10 kilometra rrugë publike, duke mos llogaritur rrugët nëpër qytete dhe vendbanime rurale. Rrugë magjistrale janë 630.40 km, rrugë regjionale 1294.70 km dhe rrugë lokale rreth 5500 km. Rrugët magjistrale dhe regjionale menaxhohen nga MTPT, ndërsa ato lokale nga komunat.³⁹



³⁸ PKVM

³⁹ Departamenti i Infrastruktūrës Rrugore- MTPT

Harta 4. Harta e rrjetit të rrugëve



Në bazë të evidencës për regjistrimin e automjeteve (viti 2000 -2006) në departamentin e regjistrimit të automjeteve pran MPB, në rrugët e Kosovës qarkullojnë gjithsejtë 332375 automjete të kategorive të ndryshme, duke përfshirë automjetet ushtarake të KFOR-it dhe UNMIK-ut, organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, si .

Dhe atyre që si transit shfrytëzojnë infrastrukturën rrugore të Kosovës. Ndikmi i automjeteve në mjedis në masë të madhe varet nga lloji dhe kategoria e automjeteve, prandaj në vijim do të paraqesim tabelën e llojit të automjeteve të regjistruara në vitin 2006

Tabela 25. Automjetet e regjistruara gjatë vitit 2006

LLOJI I AUTOMJETIT	Muaj / 2006												total
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
Vetura	1832	1789	2384	2514	2937	3002	3469	4173	5055	5213	4920	4658	41946
Furgona	254	253	355	330	475	355	369	483	630	644	538	497	5183
Kamion i lehte nder 3.5 t	98	115	178	205	226	193	160	230	273	234	189	199	2300
Kamion i rende mbi 3.5 t	64	94	181	225	265	179	138	203	259	248	226	158	2240
Autobus i vogël me pak se 14 persona	4	/	3	5	4	5	3	3	2	4	2	4	39
Autobus me i madh se 14 persona	7	13	13	19	36	25	12	23	80	84	77	59	448
Traktor	12	24	29	32	38	26	13	14	21	15	14	21	259
Rimorkio	14	34	58	62	80	63	43	41	74	58	37	32	596
Motoçiklete	6	3	27	83	126	110	133	110	46	15	6	10	675
Total	2291	2325	3228	3475	4187	3958	4340	5280	6440	6515	6009	5638	53686

Rehabilitimi dhe ndërtimi i rrugëve dhe urave

Në vitin 2006 janë realizuar 18 projekte. Prej tyre 4 projekte janë vazhdimësi e vitit paraprak (2005), ndërsa 14 projekte të tjera janë kontraktuar në këtë vit. Gjatë vitit 2006, janë asfaltuar 61.80 km, kurse deri në shtresën e asfaltit janë përgatitur 41.18 km. Po gjatë këtij viti, MTPT ka realizuar 7 projekte për ndërtimin dhe riparimin e urave, kryesisht në rrugët magjistrale. Po ashtu , janë ndërtuar edhe 4100 km trotuare për këmbësorë përgjatë rrugëve, kryesisht në afërsi të shkollave.

Transporti ajror

Transporti ajror në territorin e Kosovës zhvillohet nga dy aeroporte, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (fluturime civile dhe ushtarake) dhe Aeroporti i Gjakovës (fluturime ushtarake).

Në hapësirën ajrore të Kosovës nuk realizohen mbi fluturime (kalimi transit i aeroplanëve), gjë që është e lidhur me statusin politik ende të pazgjidhur. Fillimi i mbi fluturimeve në hapësirën ajrore të Kosovës pritet të rrisë nivelin e ndotjes të ajrit, posaçërisht të shtresave të larta të atmosferës.

Grafikoni 22. paraqitja e rritjes së vazhdueshme e fluturimeve



Komunikacioni ajror me zhurmën dhe emisionet e liruara, ka ndikim të madh në mjedis, posaçërisht në zonën e korridoreve ajrore. Zona me zhurmë intensive të avionit është gati dy herë më e madhe sesa sipërfaqja e aeroportit.

Përmes transportin ajror vije deri të zvogëlimi i trashësisë së mbështjellësit ozonik. Transporti ajror është karakteristikë për shpenzimin e oksigjenit që është i nevojshëm për procesin e djegies në turbomotorë.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës në vitet e fundit ka pas një zhvillim të hovshëm në të gjitha aspektet. Në vitin 2007 numri i udhëtarëve ka kaluar shifrën mbi 1 milion.

Grafikoni 23. paraqitja e rritjes së numrit të udhëtarëve në Aeroportin e Prishtinës.



Të dhënat për shpenzimet e karburantit në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës

Nga shënimet e marra nga aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës shihet se shpenzimet e karburantit për nevojat e aeroportit të Prishtinës në vitin 2006 kanë qenë 18 916 413 litra, ndërsa në periudhën janar - qershor 2007 janë 9 213 625 litra. Kjo shifër tregon se shpenzimet deri në fund të vitit 2007 do të jenë përafërsisht të njëjta me ato të vitit 2006.

Tabela 26. Shpenzimet e karburantit për nevoja të Aeroportit të Prishtinës 2006 dhe 2007⁴⁰

BP Aircraft fueling	Liters	Viti	Antifrizi (litra)
2006	18916413	2006	54.383
2007	9213625	2007	30.203

Llojet e antifrizit që janë përdorur gjatë këtyre viteve janë: Clariant MPII 1951 air, Kilfrost ABC 3

Transporti Hekurudhor

Hekurudha në aspektin ekologjik është formë e qëndrueshme e transportit. Ajo është një ndër transportet

Më të sigurta për transportin e udhëtarëve dhe mallrave. Hekurudha shkarkon liron rrugët, ruan natyrën, zvogëlon numrin e fatkeqësive dhe katastrofave ekologjike. Mirëpo, edhe komunikacioni hekurudhorë ka ndikim në mjedis përmes komponentëve avullues nga lokomotivat, vagonët, vajrat, etj. që hasen në çdo nyje dhe linjë hekurudhore.

Vagonët hekurudhorë dhe linjat hekurudhore spërkatën me herbicide të ndryshme në mënyrë që të pengohet dalja e bimëve të ndryshme. Herbicidet që përdoren për këtë qëllim kanë dozë të caktuar të ndikimit toksik në mjedis.

Hekurudhat e Kosovës operojnë me 6 linja dhe 333 km rrjet hekurudhor pa përfshirjen e binarëve industrial.

Tabela 27. Transporti publik i udhëtarëve, numri i tyre sipas viteve

VITI 2004	VITI 2005	VITI 2006
416.996	265.533	401.487

Transporti i mallrave në vitin 2006 ka pasur një rënie në krahasim me vitet paraprake, ndërsa në periudhën Janar-Gusht 2007 është 278,248 neto ton, të mira materiale ku 47% e kësaj sasive janë derivate të ndryshme.


Tabela 28. Transporti i mallrave neto-ton

VITI 2004	VITI 2005	VITI 2006	Janar -Gusht 2007
383.531	359.659	345.287	278 248

⁴⁰Raporti i AIR BP

Harta 5. Harta e rrjetit të hekurudhave

Rrjeti i Hekurudhave në Kosovë



Ministria e Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor
Agjencia e Kosovës për
Mbrotjtjen e Mjedisit



Sistemi Informativ Mjedisor / GIS

Emri i Hartës:
Rrjeti i Hekurudhave në Kosovë
Burimi i të dhënave: MTPPT / AKMM

Projeksioni : UTM-WGS 84
Zona: 34 HV
Data: nëntor, 2007
Pristinë

Adresa: Rr. Nazim Gafuri nr.31
info@sim@ks-gov.net

LEGJENDA

- Kufiri komunal
- Hekurudhë

7. TURIZMI

Turizmi paraqet njërën ndër fushat kryesore të zhvillimit të një vendi. Zhvillimi i tij ka ndikime në mjedis, sidomos nëse nuk merren parasysh parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Resurse turistike kanë pothuaj të gjitha trevat e Kosovës, “Malet e Sharrit” dhe “Bjeshkët e Nemuna” janë zonat më të rëndësishme. Vlerat e paprekura të natyrës së Kosovës si dhe diversiteti i monumenteve kulturore-historike krijojnë mundësi të mira të zhvillimit turistik.

Vlerësimi i gjendjes

Sipas të dhënave që posedojmë, Industria Turistike e Kosovës realizon 8-10 % të produktit shoqëror vendor.⁴¹ Pas vitit 2000 sektori i turizmit në Kosovë karakterizohet me një zhvillim intensiv dhe në një masë të madhe spontan dhe të pa kontrolluar, i cili shoqërohet me pasoja të humbjes së ekuilibrit për mjedisin. Shikuar nga aspekti turistik, Kosova është vend në zhvillim.

Sektori i turizmit në Kosovë aktualisht ballafaqohet me problemin e ofertës turistike i cili ka ngecur prapa nga zhvillimi ndërkombëtar në këtë lëmi. Këtij sektori i duhet ende të definojë pozitën e tij, t'i rrisë të hyrat dhe të ruajë potencialin dhe resurset natyrore. Kërkesat turistike në Kosovë janë të lidhura me mysafirë të huaj dhe vendorë. Nuk kemi të dhëna të sakta për strukturën dhe vendet prej nga vijnë turistët në Kosovë.

Turizmi në Kosovë rregullohet sipas Ligjit për Turizëm i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Është në procedim hartimi i Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit.

Regjistri i turistëve

Edhe pse trendi i rritjes së numrit të turistëve që nga viti 2000 e deri tani ka shënuar tendencë rritjeje, ende nuk ka të dhëna të sakta për numrin e turistëve, kohëzgjatjen mesatare të qëndrimit të tyre dhe parametra tjerë që lidhen me regjistrin e turistëve. Sipas të dhënave turistët nga Kosova më shumë preferojnë turizmin malorë që përfaqësohet nga rajoni turistik i “Bjeshkëve të Nemuna” dhe rajoni turistik i “Sharrit”, ndërsa produkte tjera turistike që ofron Kosova dhe që janë më pak të preferuara janë: turizmi dimëror-rekreativ, turizmi kulturor, turizmi afarist, turizmi transit, turizmi shëndetësorë dhe speleoturizmi.⁴²

Kapacitetet e vendosjes

Hotelet e sektorit shoqëror që kanë rreth 70 % të shtretërve në Kosovë janë të vjetër dhe u mungojnë pajisjet e duhura, dhe për këtë arsye është i vogël numri i vendosjes së mysafirëve në hotele me pronësi shoqërore (IPH 2004 - Raporti sektorial i zhvillimit hapësinor për sektorin e turizmit).

Sipas të dhënave nga Departamenti i Turizmit i MTI, që nga viti 2000 e deri sot janë rritur ndjeshëm kapacitetet e pranimit të turistëve. Deri më tani janë licencuar 87 subjekte hoteliere për vendosje, mirëpo, nuk ka të dhëna për kapacitetet e vendosjes që posedojnë këto subjekte dhe ende nuk është bërë kategorizimi i tyre. Janë të licencuara po ashtu, edhe 33 Agjenci për organizim të turizmit.⁴³

Vizita Zonave të Mbrojtura

Përveç “Maleve të Sharrit” dhe “Bjeshkëve të Nemuna”, në Kosovë vizitohen edhe zonat tjera të mbrojtura të natyrës si: “Kanioni” dhe “Ujëvarat e Mirushës”; “Kanioni i Rugovës”; “Burimi i Drinit të Bardhë”; “Bifurkacini i Nerodimes”; “Shpella e Mermerit” etj. Zonat e mbrojtura në Kosovë nuk kanë zyra të informimit përmes të cilave do të merreshin informata për numrin dhe strukturën e turistëve që vizitojnë këto zona.




⁴¹ IPH 2004 Raporti sektorial i zhvillimit hapësinor për sektorin e turizmit

⁴² IPH 2004 Raporti sektorial i zhvillimit hapësinor për sektorin e turizmit

⁴³ Departamenti i Turizmit, 2007

HARTA TURISTIKE E KOSOVËS



LEGJENDA

- Kufi shtetëror
- Kufi i zonës së mbrojtur
- Pishinë
- Pishinë - liqe
- Peshkimi
- Rekreacion ujor
- Xhami
- Kishë
- Objekt kulture
- Kullë shqiptare
- Keshijellë e vjetër
- Hotel
- Motel
- Banjë
- Kamping
- Teren për gueti
- Shëng për skijim
- Aeroporti
- Shëng për alpinizëm
- Pye dushku



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit

Sistemi Informativ Mjedisor / GIS

Emri i hartës: Harta turistike e Kosovës
Burimi i të dhënave: MTI - MMPH
Projeksioni: UTM - WGS - 84 Zona - 34 - HV
Data: Nentor, 2007, Prishtinë
Adresa: Rr. Nazim Ghaluri, nr. 31
info@sim.gov.net



0 10 20
kilometers

8. KEMIKATET

Industria kimike ka qenë degë e rëndësishme e industrisë në Kosovë. Aktualisht nuk ka prodhim vendor të kimikateve të rrezikshme, mirëpo ato importohen. Në zonat e fabrikave kanë mbetur sasi të mëdha të kimikateve.

Sistemi për menaxhimin e kimikateve nuk është zbatuar në Kosovë. Aktualisht nuk ka strategji për menaxhimin e kimikateve, as kornizë legjislative për të rregulluar menaxhimin e përgjithshëm të kimikateve në pajtim me legjislacionin e BE. Sidoqoftë, ka dy ligje ekzistuese⁴⁴ në zbatim që mbulojnë dy çështje të veçanta⁴⁵ të menaxhimit të kimikateve.

Mbikëqyrja e importit dhe shfrytëzimi i elementeve kimike të rrezikshme ende nuk është implementuar. Kompetencat në këtë fushë u takojnë: Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Shërbimeve Publike, Ministrisë së Transportit dhe Post-telekomunikacionit etj. Kosova nuk është e përfshirë në Programin Ndërkombëtar për Siguri Kimike (International Program for Chemical Safety - IFCS). Sistemi monitorues, sistemi për informim publik dhe ai për shkëmbimin e të dhënave në mes të organeve të ndryshme qeveritare nuk është i zhvilluar.

-  Mungon sistemi edukativ i prodhuesve individual mbi shfrytëzimin e kimikateve;
-  Mungon Strategjia për menaxhimin e kimikateve;
-  Mungon baza ligjore, procedurat dhe udhëzimet për menaxhimin e kimikateve;
-  Mungon sistemi i përgjithshëm për monitorim;
-  Mungon sistemi për regjistrimin, vlerësimin dhe autorizimin e kimikateve; ndikojnë në shëndetin dhe mjedisin;
-  Nuk ka program për ndotësit e qëndrueshëm organik (POPs).
-  Nuk funksionon sistemi i informimit publik;
-  Mungojnë procedurat për mbikëqyrjen e transportit ndërkufitar të kimikateve dhe për shkëmbim të të dhënave. Këto duhet përpiluar në pajtim me kërkesat e Konventës mbi mbikëqyrjen e transportit ndërkufitar të kimikateve të ndaluara dhe kimikateve për përdorim të kufizuar (PIC Convention);

 Në procesin e ristrukturimit dhe privatizimit nuk ka obligime për të paraqitur informata lidhur me kimikatet, mbeturinat e rrezikshme dhe elementet tjera që ndikojnë në shëndetin dhe mjedisin;

 Nuk ka program për ndotësit e qëndrueshëm organik (POPs) Nisur nga Plani i Veprimit për Mjedisin në Kosovë, është paraqitur nevoja imediate për hartimin e Ligjit për kimikate, pasi që ishte përcaktuar si prioritet në punën e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të Qeverisë së Kosovës.

Ky ligj është hartuar nga MMPH dhe miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe tani pret miratimin nga PSSP.

⁴⁴ Ligji mbi Pesticidët Artificialë (2003/22) dhe Ligji për Pesticidë (2003/35), Ligji për Transportin e mallrave të rrezikshme (2004/17).

⁴⁵ Kosova në prodhimin e ushqimit përdor 15% më pak plehra artificiale dhe pesticide se në vendet përreth, mirëpo për arsye të përdorimit jo adekuat dhe jo profesional koncentrimi i kimikateve në ushqim dhe ujë është më i lartë se ajo që pritet prej sasisë së përdorur të kimikateve.

II. GJENDJA

Ndotja e mjedisit është njëri ndër problemet më të mëdha të shekullit XXI. Industrializimi, rritja e popullsisë, urbanizmi, mbeturinat, radioaktiviteti dhe kimikatet janë disa nga faktorët kryesor të cilët kontribuojnë në ndotjen e mjedisit.

1. AJRI

Atmosfera mund të jetë e ndikuar nga shumë substanca të ngurta, të lëngëta ose të gazta. Ajri është njeri nga mediumet mjedisore kryesore në përhapjen e ndotjes, efekti i të cilit direkt dhe indirekt ndikon në njeriun dhe përbërësit e tjerë mjedisor. Andaj, është e nevojshme që masat për parandalimin e ndotjes së ajrit të jenë çështje me prioritet. Ndotja e ajrit ka efekte negative dhe rrezikon shëndetin e njeriut, biodiversitetin dhe ekonominë. Si pasojë e ndotjes së ajrit vjen deri te dëmtimi i shtresës së ozonit, formimi i të reshurave acidike dhe efekti i gazrave serra. Nivelet e indikatorëve mjedisor të ajrit mund t'i vejmë në tri aspekte:

- ✎ Emisionet (indikatorët shtypës);
- ✎ Cilësia e ajrit (gjendja e indikatorëve); dhe
- ✎ Masat e marra dhe efikasiteti i tyre (indikatorët përgjegjës).

Emisionet e ajrit

Burimet kryesore të emisioneve ndotëse janë:

- ✎ Burimet industriale të palëvizshme: zakonisht të koncentruara në zonat industriale dhe vendbanimet me popullsi të dendur;
- ✎ Komunikacioni;
- ✎ Zonat e ndërtimit, gurëthyesit, çimentoret; etj
- ✎ Termocentralet;
- ✎ Burimet me djegie të mëdha;
- ✎ të tjera

Si emisione ndotëse janë: NO_x , CO_2 , CO , O_3 , SO_2 , bloza, pluhuri, tymi, etj. Monitorimi i emisioneve ndotëse është i domosdoshme për të ditur vlerën e tyre dhe për të përcaktuar shkallën e ndotjes së mjedisit.

Cilësia e ajrit

Objektivat kryesore të politikave mjedisore në Kosovë janë dizajnuar që të garantohet një mjedis i pastër për popullsinë, të ulët niveli i degradimit të mjedisit, të rigjenerojë bazën ekonomike bazuar në parimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe në harmonizim me standardet mjedisore ndërkombëtare. Cilësia e ajrit mund të vlerësohet vetëm në bazë të dhënave të marra nga sistemi i monitorimit të ajrit, përmes operatoreve ose institucioneve adekuate që merren me monitorim.

Monitorimi i cilësisë së ajrit përfshinë:

- ✎ Burimet dhe emisionet e ndotjes së mjedisit;
- ✎ Transmisionet e ndotësve në atmosferë;
- ✎ Niveli, koncentrimi dhe shpërndarja e ndotësve në kohë dhe hapësirë;
- ✎ Ndikimi i ndotësve në shëndetin e popullatës.


Monitorimi i cilësisë së ajrit në Kosovë

Monitorimi i cilësisë së ajrit në Kosovë është shumë i mangët, për shkak të mungesë së pajisjeve dhe stacioneve monitoruese. Monitorohen vetëm përqendrimi i: SO_2 , blozës dhe pluhurit. Parametrat e njëjtë me metodologji të njëjtë, monitorohen nga IHMK, INKOS-i dhe IKSHP. Në këtë raport do të prezantohen rezultatet e IHMK-së (një pjesë e disa rezultateve nga programi me OBSH, realizuar në Mitrovicë) dhe INKOS-it. Padyshim se me këto rezultate nuk mund të jepet vlerësimi i plotë i nivelit të ndotjes, e as identifikimi i burimeve të shkarkimeve të ndotësve të caktuar.


Monitorimi i cilësisë së ajrit në Prishtinë⁴⁶

Në Prishtinë si qendër administrative dhe kryeqytet i Kosovës, me një numër aq të madh të banorëve, komunikacion tejet të ngarkuar e me aktivitete ekonomike me ndikim në mjedis, është e domosdoshme të ketë monitorim gjithëpërfshirës të mjedisit, në veçanti për monitorimin e cilësisë së ajrit. Ky monitorim duhet të jetë i dizajnuar që të përfshijë parametrat e kërkuar nga BE dhe OBSH, sipas kriterëve për mbulueshmërinë e territorit dhe respektimin e performansave tjera


Grafikoni 24 Vlera mesatare vjetore të grimcave të depozituara, IHMK qershor - dhjetor 2006




Grafikoni 25. Vlera mesatare vjetore për materjet grimcore të depozituara, IHMK qershor - dhjetor 2005



⁴⁶ Raporti nga IHMK)

Grafikoni 26. Vlera mesatare mujore e So₂ për pikën monitoruse në IHMK, 2005-2007


Grafikoni 27. VM mujore e Bolozës, për pikën monitoruse në IHMK, 2005-2007



Monitorimi i cilësisë së ajrit në Mitrovicë⁴⁷

Monitorimi i cilësisë së ajrit në Mitrovicë, sipas programit të OBSH-së dhe IHMNK-së, është kryer në këto pika: AM1-Shkolla "Bedri Gjinaj", AM11/AMP7-Shkolla "Migjeni", AM12-ALBA Park-Shupkovc, AM13-Vëllezërit Kuqi, AM14-Shkolla "Elena Gjika", AM15-Parku Industrial i Trepçës, AM16-OSBE, AM17-Fabrika e duhanit, AM18-Fabrika e ujit, IHMK-Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

Grafikoni 28. VM e pluhurit total, të depozituar (PTD) Mitrovicë dhe IHMK 2005 - 2007



Monitorimi i cilësisë së ajrit në KEK-Obiliq⁴⁸

Obiliqi me rrethinë është territor mjaft i ndotur, si rezultat i emisioneve nga termocentralet ekzistuese që prodhojnë energji elektrike me një teknologji të vjetruar. Ndotja e ajrit shpesh tejkalon vlerat maksimale të lejuara për pluhurin, vlerat e të cilit e bëjnë edhe më të rëndë situatën e

përgjithshme mjedisore në këtë rajon. Monitorimin e cilësisë së ajrit në zonën e KEK-it e bënë Instituti INKOS.




Grafikoni 29. Përqendrimi i So₂ gjatë vitit 2005Grafikoni 30. Përqendrimi i So₂ gjatë vitit 2006Grafikoni 31. Përqendrimi i blozës (mikrogr/m³)

Tabela 29. Vlerat mesatare të pluhurit sipas INKOS-it, gjatë viteve

Ndotësi/vendi	INKOS	Kastriot	Bardh	PML
Thërmijat ajrore	2002	85.13	-	119.04
	2003	100.4	91.85	113.43
	2004	56.8	-	-
	2005	56.0	-	-
Pluhuri depozit	2002	727	-	817.2
	2003	1865	553.61	410.85
	2004	313	460	195
	2005	429	428	-

Shpjegim: Vlerat me ngjyrë të kuqe tregojnë për tejkalim të PML (përqendrimi maksimal i lejuar)

⁴⁷ Raporti nga IHMK)

⁴⁸ Raporti Mjedisor 2006-Departamenti i Mjedisit ne KEK

Nga të dhënat e paraqitura për vitin 2005, 2006 dhe 2007, në disa pika monitoruese janë regjistruar tejkalime të vlerave maksimale të lejuara. Bloza dhe grimcat e pluhurit të depozituar janë shënuar me tejkalime në disa raste, ndërsa SO₂ ka shënuar më pak tejkalime të VML.

Emisionet

Përveç mangësive në monitorimin e cilësisë së ajrit, monitorimi i emisioneve nga kapacitet ekonomike që ndikojnë në cilësinë e ajrit po ashtu, ka ngec në tërësi. Obligimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, nuk janë duke u zbatuar, në këtë kontest dhe vonesat janë të pajustificueshme. Në këtë raport nuk janë futur ato pak të dhëna për emisione, ngase shumica e tyre janë rezultate të vjetra që nuk përkojnë me rrethanat aktuale të operimit të kapaciteteve si KEK-u, Ferronikeli, Sharr-cemi, emisionet nga komunikacioni etj. Në mungesë të të dhënave adekuate, nuk është dhënë ndonjë vlerësim për nivelin e ndotjes që shkaktohet nga emisionet në ajër.

Burimet e komponimeve acide në ajër- Acidifikimi

Dukuria e acidifikimit përbën një problem serioz për mbarë globin. Kjo dukuri është rezultat i shkarkimeve të mëdha të ndotësve në atmosferë si: dyoksidit të sulfurit-SO₂, dhe Oksideve të azotit-NO_x. Kjo dukuri ndryshe mund të quhet “Depozitimi acid”, meqenëse komponimet acidike bien në sipërfaqen e tokës nëpërmjet dy rrugëve: depozitimit të njomë, (të tretura në të reshura) dhe depozitimit të thatë, që ndodh nëpërmjet rënies dhe përthithjes së komponimeve acidike të sulfurit në sipërfaqe të tokës, bimëve, ndërtesave dhe ujërave.

Pra, më termin acidifikim janë të lidhura depozitimet acide në sipërfaqen e tokës e më konkretisht depozitimet:

-  Tretësirat ujore të acideve më të forta se sa acidi karbonik (H₂SO₄, HNO₃);
-  Oksidet acidike (SO₂, NO_x);
-  Kripërat acidike (si NH₄HSO₄).

Të reshurat acidike llogariten në qoftë se pH e tij do të jetë nën 5, sepse të reshurat në kushte normale kanë pH 5-6 që i përgjigjet tretjes së CO₂ në ujë. Ky ndryshim do të vijë më rastin e rritjes së SO₂ në atmosferë. Burimet antropogjenë që kontribuojnë negativisht në rritjen e kësaj dukurie janë të shumta; p.sh djegia e lëndëve fosile, industria metalurgjike, industria kimike, zjarret në pyje, shkarkimet elektrike atmosferike, transporti etj. Në Kosovë, monitorimin e të reshurave atmosferike e sidomos të atyre acidike, që shprehet me ndryshimin i pH e bën IHMK, në dy qendra: në Prishtinë dhe në Mitrovicë,⁴⁹ (shih tabelen nr.30).

Kosova dhe korniza e legjislacionit evropian për ajrin

Inkuadrimi i Kosovës në aprovim të konventave dhe protokolleve ndërkombëtare mundësohet përmes adoptimit të legjislacionit vendor për reduktimin e emisioneve ndotëse si; SO₂, NO_x, CO₂, emisionet e pluhurit nga kapacitet me djegie të mëdha të fabrikave etj. Një ndër objektivat sipas ligjeve në fuqi, Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis dhe Strategjisë së Mjedisit është respektimi i direktivave dhe konventave ndërkombëtare për emisionet ndotëse dhe mbrojtjen e mjedisit. Kosova është para një sfide të madhe sa i përket respektimit të legjislacionit evropian të cilin në të ardhmen e afërt duhet respektuar dhe nënshkruar si të vetmin kusht për integrim të mëtutjeshëm.

Tabela 30. Vlerat mesatare e pH së reshjeve në rrjetin monitorues në Mitrovicë dhe IHMK, 2006

Pikat monitoruese	AM ₁₀	AM ₁₁	AM ₁₂	AM ₁₃	AM ₁₄	AM ₁₅	AM ₁₆	AM ₁₇	AM ₁₈	IHMK
Vl.mesatare	6.16	6.18	6.61	6.13	6.22	6.32	6.54	6.47	6.18	7.17
VML	7	7	7	7	7	7	7	7	7	7

⁴⁹ Raporti nga IHMK

2. UJËRAT

Vlerësimi i gjendjes

Kosova ka rezerva të kufizuara ujore që në të ardhmen mund të jenë pengesës për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Rrjeti i ujërave sipërfaqësore të Kosovës ndahet në 4 pellgje lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës, dhe Lepenci.⁵⁰ Mesatarja vjetore e të reshurave në Kosovë ndryshon prej 658 mm (Sitnica) deri 1515 mm (Ereniku). Koeficienti rrjedhës sillet prej 4.92 l/sec/km² (Morava e Binçës) deri 42.46 l/sec/km (Lumëbardhi i Deçanit). Nga territori i Kosovës në vitet me lagështi, mesatarisht rrjedhin rreth $3.8 \times 10^9 \text{ m}^3$ ujë, përkatësisht 121.2 m³/sec.

Kosova ka përafërsisht 1600 m³ /ujë për kokë banori. Mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i resurseve ujore ka rëndësi të madhe dhe është një ndër sfidat më të mëdha mjedisore.⁵¹

Karakteristikë hidrologjike e Kosovës është shpërndarja jo e barabartë e resurseve ujore në krahasim me nevojat, e cila reflektohet me mungesa të mëdha të ujit, sidomos gjatë muajve të verës.

Rezervat e ujërave nëntokësore janë të kufizuara dhe gjenden kryesisht në pjesën perëndimore të Kosovës. Edhe rezervat e ujërave sipërfaqësore janë më të mëdha në këtë pjesë të Kosovës në krahasim me pjesën lindore dhe jug-lindore.

Kosova ka kryesisht liqene artificiale (Batllava, Gazivoda, Radoniqi, Përlepnica dhe Badovci), si dhe një numër të liqeve të vegjël për ujitje. Kushtet topografike për ndërtimin e rezervuarve artificial për mbledhjen e ujit nuk janë të përshtatshme. Për këtë arsye kërkohen investime të mëdha. Kosova ka burime të rëndësishme të ujërave termale të cilat shfrytëzohen për qëllime shëndetësore dhe rekreative. Ekzistojnë tri qendra shëndetësore shëruese në Pejë, Kllokot dhe Mitrovicë. Megjithatë, ka edhe burime tjera termale të cilat nuk shfrytëzohen, dhe në të ardhmen ato duhet të hulumtohen dhe t'u kushtohet më shumë vëmendje. Potenciali i ujërave termale mund të shfrytëzohet edhe për zhvillimin e turizmit rekreativ.

Ujërat sipërfaqësore - Resurse ujore sipërfaqësore janë: lumenjtë, burimet, akumulimet artificiale, liqenet, dhe rrjedhjet e tjera ujore.

Lumenjtë dhe pellgjet ujore

Të gjithë lumenjtë e Kosovës⁵² janë të ndarë në katër vija ujëndarëse (pellgje ujëmbledhëse), të cilat kanë rrjedhje në drejtime të ndryshme.




Foto: Drini i Bardhë, 2006

⁵⁰ Raporti mbi gjendjen e mjedisit në Kosovë 2003


⁵¹ PKVM-2006

⁵² Departamenti i ujërave (MMPH) 2007

[illegible]

Adresa: Rr. Nazim Gafurri nr.31
infogis_sim@ks-gov.net

Kufiri i Kosovës
Liqejtë
Lumnejtë
Rrjedhje humore



Liqenet artificiale

Me qellim të rregullimit të regjimit hidrologjik të lumenjve në Kosovë dhe shfrytëzimit kompleks dhe me racional të pasurive ujore në disa lumenj janë ngritur penda dhe janë formuar liqene artificiale ose akumulues të ujit.

Këto akumulime kanë rëndësi të madhe jo vetëm në begatimin e inventarit hidrologjik dhe përmirësimin e kushteve mikroklimatike, por edhe në zgjedhjen e problemeve të shumta hidroekonomike: zvogëlimin e vërshimeve, furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë dhe industrisë, zhvillimin e rekreacionit, turizmit, peshkimit etj.

Sipas tabelës del se rezervat e ujit janë $V_r = 395.291.540 \text{ m}^3$ (vëllimi i akumulacioneve $V_a = 569.690.000 \text{ m}^3$ minus sasia e ujit të harxhuar për furnizim të popullsisë për pije $V_p = 174.398.460 \text{ m}^3$, pra $V_r = V_a - V_p = 569.690.000 - 174.398.460 \text{ m}^3$).

Tabela 32. Sipërfaqja dhe rrjedha e liqeneve artificiale në Kosovë

Liqeni	Sipërfaqja	Rrjedha
Liqeni i Radoniqit	130 km ²	16 m ³ / sec
Liqeni i Batllavës	226 km ²	16 m ³ / sec
Liqeni i Ujmanit (Gazivodes)	1060 km ²	13.5 m ³ / sec
Liqeni i Badovcit	103 km ²	105 m ³ / sec

Nga të dhënat e prezantuara shihet se kapaciteti i vlerësuar i ujit në akumulimet nëntokësore është:⁵⁴ 511.000.000 m³. Pra sasia e përgjithshme e ujërave në Kosovë është 1.080.690.000 m³

Ujërat nëntokësore

Ujërat nëntokësorë⁵³ dhe rezervat e tyre në Kosovë nuk janë të hulumtuar sa duhet. Ujërat nëntokësore në Kosovë gjenden në shkëmbinj të llojeve dhe vjetërsisë së ndryshme, që nga Paleozoiku e deri në Kuaterneri dhe janë të rëndësishme për furnizimin me ujë të pijshëm për nevoja të popullatës, për industri, bujqësi etj. Shfrytëzimi i ujërave nëntokësorë bëhet përmes puseve dhe burimeve që në të shumtën e rasteve ndodhen në zonat kodrinore-malore. Në tabelën në vijim janë paraqitur disa të dhëna për disa akumulues nëntokësorë.

Tabela 33. Akumulacionet kryesore, sipërfaqja, rrjedhja ujore dhe vëllimi i akumulimit

Nr.	Lumi	Emri i akumulimit	Sasia e ujit në m ³	Përqindja (%)
1	Ibër	Gazivoda	390.000.000	68.45
2	Përrue	Radoniq	113.000.000	19.98
3	Gračanka	Badovci	31.000.000	5.44
4	Batllava	Batllavë	30.000.000	5.26
5	Përlepnica	Përlepnice	4.200.000	0.73
6	Livoç	Livoç	1.000.000	0.17
7	Ibër	Pridvorcë	490.000	0.08
Gjithsej			569.690.000	100

Tabela 34. Akumuluesit ujqor nëntokësorë

Nr.	Akumulimi nëntokësor	Pellgu (km ²)	Vëllimi i dobishëm (m ³)	Kapaciteti vlerësues	
				m ³ /sec	Gjithsej (m ³)
1	Istog	76	12x10 ⁶	2,8	89x10 ⁶
2	Vrellë	28	14x10 ⁶	0,600	19x10 ⁶
3	Drini i Bardhë	90	14x10 ⁶	3,23	102x10 ⁶
4	Lubizhdë	42	45x10 ⁶	4,2(150)	55x10 ⁶
5	Pejë	300	37,5x10 ⁶	4,0(150)	52x10 ⁶
6	Deçan	144	33x10 ⁶	3,5(150)	45x10 ⁶
7	Lloqan	39	12x10 ⁶	1,2(150)	15x10 ⁶
8	Krk Bunar	81	10x10 ⁶	1,6	50x10 ⁶
9	Korishë	18	3,6x10 ⁶	0,38	12x10 ⁶
10	Fusha e Therandës	50	75x10 ⁶	2	63x10 ⁶
		998	271x10 ⁶		511x10 ⁶

⁵³ Raport nga DU, 2007

⁵⁴ (U_p = U_a + U_n, U_p sasia e përgjithshme e ujit, U_a sasia e ujit në akumulime, U_n sasia e ujit nëntokësor).

Menaxhimi i ujërave⁵⁵

Menaxhimi i ujërave përmban aktivitete të shumta, vendime dhe masa, qëllimi i të cilave është mirëmbajtja, ruajtja dhe përmirësimi i kualitetit të tij. Menaxhimi i mirë i ujërave të Kosovës duhet të jetë në listën e prioritetëve për mbrojtjen e mjedisit. Kjo është paraparë edhe me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Menaxhimi i mirëfilltë i resurseve ujore mbështetet në disa parime themelore:

- ✎ Uji është burim i pa zëvendësueshëm i jetës në tokë, dhe është obligim i çdo qytetari për ruajtjen e këtyre resurseve;
- ✎ Me ujëra duhet të menaxhohet sipas standardeve evropiane dhe të një zhvillimi të qëndrueshëm, ku do të ketë të drejtë të kenë qasje të gjithë sipas parimeve të OBSH;
- ✎ Kufijtë administrativo-territorial të njësive nuk mund të jenë pengesë për qeverisje integrale të ujërave;
- ✎ Njësitë për menaxhimin me ujëra janë rajonet dhe pellgjet ujore si tërësi hidrografike dhe ekonomike;
- ✎ Për shfrytëzimin e ujërave përtej kufijve të lejuar si dhe kufijtë administrativo-territorial të njësive nuk mund të jenë pengesë për qeverisje integrale të ujërave;
- ✎ Për shfrytëzimin e ujërave përtej kufijve të lejuar si dhe për çdo keqësim të cilësisë së ujit duhet paraparë kompensimi i cili do të jetë proporcional me leverdi, respektivisht duhet të varet nga shkalla e ndikimit në ndërrimin e gjendjes së ujërave.



Foto: Batllava, 2006



Foto: Bistrica e Deçanit, 2006

Degradimi i shtretërve të lumenjve - Nga aktivitetet antropogjenë shtretërit dhe brigjet e lumenjve në Kosovë i janë nënshtruar eksploatimit të pakontrolluar të rërës e cila ka shkaktuar degradimin e këtyre sipërfaqeve. Shkallë më të larta të degradimit nga eksploatimi i rërës kanë Drini i Bardhë dhe Lumëbardhi i Pejës.

Gjendja është përmirësuar pas nxjerrjes së Vendimit me të cilin ndërpritën këto aktivitete në distancë 50 metra nga shtrati i lumit.

⁵⁵ Raporti për gjendjen e mjedisit 2003

Harta 8. Harta e zonave të degraduara

Zonat e Degraduara në Pellgun e Lumit Drini i Bardhë nga Operatorët e Rërës dhe Zhavorit

Sistemi Informativ Mjedisor / GIS

Emri i Hartës: Zonat e Degraduara
Burimi i të dhënave: DMM / AKMM


Projeksioni : UTM-WGS 84

Zona: 34 HV

Data: dhjetor, 2007

Prishtinë

Adresa: Rr. Nazim Gafuri nr.31
info@sim@ks.gov.net



Furnizimi me ujë

Gjendja e furnizimit me ujë e sidomos ajo me ujë të pijes, nuk është e mirë si rrjedhojë e disa faktorëve:

- ✎ Shkalla e ulët e furnizimit të popullatës me ujë nga sistemi publik, sidomos në zonat rurale;
- ✎ Shkalla e ulët e mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujërave;
- ✎ Amortizimi i rrjetit të ujësjellësve dhe kanalizimeve;
- ✎ Mungesa e planit për mbrojtjen e rezervave ujore;
- ✎ Mungesa e investimeve.

Popullata e Kosovës furnizohet me ujë të pijes nga akumulimet sipërfaqësore në njëmbëdhjetë komuna të Kosovës (Mitrovica, Vushtrria, Skenderaj, Drenasi, Podujeva, Prishtina, Kastrioti, Gjlani, Gjakova dhe Rahoveci, Fushë Kosova), për çka shpenzohet një sasi prej rreth 93 milion m³ në vit. Vendbanimet tjera furnizohen nga ujërat nëntokësore dhe nga burimet. Vendbanimet rurale furnizohen nga pusët dhe ujësjellësit lokal, duke marrë ujin përmes kaptimit të burimeve.

Sistemi i furnizimit me ujë është i organizuar përmes shtatë kompanive për furnizim me ujë të pijshëm që menaxhohen nga AKM-ja:

- ✎ KRUK "Prishtina" - Prishtinë
- ✎ KR "Hidromorava" Gjilan
- ✎ KR "Bifurkacioni" Ferizaj
- ✎ KR "Hidroregjioni Jugor" Prizren
- ✎ KR "Mitrovica" Mitrovicë
- ✎ KR "Hidrodrini" - Pejë
- ✎ KR "Radoniqi" Gjakovë.⁵⁷

Rreth 73% e popullsisë ka qasje në sistemin publik të furnizimit me ujë të pijshëm.⁵⁸ Disa vendbanime sistemin e ujësjellësit e kanë pjesërisht të rregulluar. Tabela në vijim pasqyron burimet e furnizimit me ujë dhe sasinë ditore në m³.

Tabela 35. Burimet e furnizimit me ujë dhe sasinë ditore në m³.

Nr.	Vend marrja e ujit	Sasia e ujit e shfrytëzuar në [m ³ / ditë]	Sasia e ujit e shfrytëzuar në [m ³ / vit]	Përqindje [%]
1	Burim natyrore	153.264	55.941.360	32.10
2	Rezervuar	7.749	2.828.385	1.62
3	Lum	11.191	4.084.715	2.34
4	Liqe (akumulim i përfaqësor)	279.260	101.929.900	58.44
5	Pus	26.340	9.614.100	5.51
Gjithsej		477.804	174.398.460	100

Nga tabela vërehet se sasia më e madhe e ujit të pijshëm shfrytëzohet nga akumulimet sipërfaqësore (liqenet), ndërsa ajo më e vogël nga rezervuarët.

Të gjitha vendbanimet në Kosovë përballen me probleme të theksuara të ujit. Problemet janë të natyrave të ndryshme, si: kapaciteti i pamjaftueshëm i burimeve nga

merret uji; shpenzimi jo racional dhe humbjet e mëdha në rrjet, stacionet e filtrimit të vjetruara dhe me kapacitet të kufizuar, mungesa e urbanizimit adekuat në vendbanime, zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit edhe në raste kur kapaciteti është i kufizuar, mungesa e masave shtytëse për kursimin e ujit, mungesa e resurseve njerëzore profesionale për menaxhim të ujërave etj.

⁵⁶ Raporti i performances për vitin 2006, aneksi C1, publikuar nga ZRRUM, Qershor 2007

⁵⁷ Raporti nga DU, 2007

⁵⁸ Raporti i performances 2006 ZRRUM

Tabela 36. Sasia e ujit të prodhuar nga 7 kompanitë regjionale të licencuara për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë⁵⁹

Të dhënat	Ofruesit Regjional të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë në Kosovë							Gjithsej
	KRUK 'Prishtina' (Prishtine)	KRUK 'Hidroregjion i Jugor' (Prizen)	KRUK 'Hidrodri ni' (Peje)	KRUK 'Ujësjiellësi Regjional' (Mitrovica)	KRUK 'Radoniqi' (Gjakove)	KRUK 'Bifurkacioni' (Ferizaj)	KRUK 'Hidromorav a' (Gjilan)	
	Komunat: Prishtinë Fushë Kosovë Obiliq Podujevë Lypjan Shtime Drenas	Komunat: Prizren Dragash Therandë	Komunat: Pejë Istog Klinë Deçan Junik	Komunat: Mitrovicë Skenderaj Vushtrri	Komunat: Gjakovë Rahovec	Komunat: Ferizaj Kaçanik	Komunat: Gjilan Viti Kamenicë	
Numri i popullatës në zonën e shërbimit	617,500	380,000	258,000	400,000	220,000	200000	107,000	2,182,500
Popullata e shërbyer	586,700	191,500	130,871	320,000	160,000	130000	94,500	1,613,571 (73%)
Uji i prodhuar (m3/vit)	45,080,060	14,856,386	31,282,887	16,750,478	19,960,537	4,278,939	6,627,071	138,836,358

Vërejtje:

Komunat në veri të Kosovës si: Zubin Potok, Leposaviq, Zveçan dhe komunat Shtërpçë dhe Bovobërdë nuk janë përfshi me këtë tabelë meqenëse nuk janë pjesë e kompanive regjionale të licencuara nga Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM).

Shfrytëzimi i ujërave në industri

Përdorimi i ujit në sektorin e industrisë nuk është i madh, për faktin se pjesa më e madhe e ndërmarrjeve industriale që ishin dikur aktive, tani janë jashtë funksionit apo në fazën e privatizimit.⁶⁰ Shumica e ndërmarrjeve industriale aktive, shfrytëzojnë ujërat nga ujësjellësi publik, ndërsa nuk ka të dhëna për ato që përdorin sistem vetanak të furnizimit me ujë. Për nevojat e industrisë (në procesin teknologjik, prodhues, ftohje, sanitari, etj.) llogaritet se shpenzohen rreth 150 milion m³ në vit, që paraqet 30% të shpenzimit të përgjithshëm. Për shembull sasia e ujit e cila shfrytëzohet nga NPH "Ibër-Lepenc" prej liqenit të Gazivodës, për pije, ujitje dhe ftohje të Termocentralit "Kosova B", është; 113.923.00 m³ / ditë ose 41.581.895 m³ / vit.

Tabela 37. Shpërndarja e ujit nga NPH, Ibër - Lepenc"

Nr.	NPH, Ibër - Lepenci"	Sasia e ujit në [m ³ / ditë]	Sasia e ujit në [m ³ / vitë]
1	Popullsia	43200	15.768.000
2	Industria	55.104	20.112.960
3	Bujqësia	15.619	5.700.935
Gjithsej		113.923	41.581.895

Me zhvillimin e industrisë në të ardhmen në Kosovë pritet që shfrytëzimi i resurseve ujore të rritet, gjë që do të rrezikoj edhe më shumë gjendjen e furnizimit të popullatës me ujë të pijes, sidomos në basene akumuluese që kanë qasje të përbashkët industria dhe popullata.

Shfrytëzimi i ujit për hidroenergjetikë

Ujë në Kosovë shfrytëzohet edhe për qëllime hidroenergetike me një potencial të vogël. Deri tani në Kosovë janë ndërtuar këto hidrocentrale: Kozhnjeri me fuqi prej 8.4* Më dhe me një fuqi të disponueshme prej 6,4 Më * dhe prodhim vjetor prej 37 Gëh*,

- ✎ Dikanci (1956), me 1,4 MVA dhe fuqi të instaluar aktive prej 1,20* Më,
- ✎ Istogu me 0.56 MVA dhe fuqi të instaluar aktive prej 0,45 MVA (1934),
- ✎ Gazivoda me prurje të instaluar prej 2x18=36 m³ /s*, fuqia e instaluar është 2 x 17 = 34 Më me një prodhim të planifikuar mesatar prej 95 Gëh*.

Shfrytëzimi i ujit për ujitje

Resurset ujore përdoren edhe për qëllim të ujitjes së tokave bujqësore. Në Kosovë para vitit 1990 në sistemin e ujitjes janë përfshirë 25% e sipërfaqes së tokave bujqësore, ndërsa në vitin 2001 janë ujitur më pak se 25% e sipërfaqes së tyre.⁶¹ Sipas studimeve të ekonomive shtëpiake bujqësore 2005, sipërfaqja e tokave që ujiten janë rreth 41.860 ha (ose 28 % e tokës së përgjithshme të kultivuar). Sipas regjioneve pjesa me

E madhe e tokës së ujitur është në komunën e Pejës dhe Gjakovës. Peja dhe Deçani kanë sisteme të gjera të ujitjes e cila përfshinë rreth 20% të sipërfaqes së përgjithshme të ujitur në Kosovë.⁶²

Tabela 38. Shfrytëzimi i ujit për ujitje sipas regjioneve

Regjioni	Sipërfaqja e ujitur (ha)	% e tokës së ujitur	Shpërndarja e tokave të ujitura sipas regjioneve në %
Gjithsej	41.860	27.9	100
Prishtinë	5.136	27.0	25
Mitrovicë	3.416	16.5	7.8
Pejë	13.429	50.4	17.4
Gjakovë	12.967	48.7	20.1
Prizren	4.588	19.4	11
Ferizaj	1.484	29.0	9.7
Gjilan	840	17.2	9.1

Sipas raportit të ESK-së (2005)⁶³ për ujitjen e tokave të kultivuara nëpër komunat e Kosovës, gjendja është si në vijim.

Tabela 39. Ujitja e tokave sipas komunave

Komunat	Sip. e ujitur (ha)	% e tokës së ujitur	% e tokës së përgjithshme të ujitur në Kosovë
Gjithsej	41.860	27,9	100,0
Deçan	5.783	61,3	9,2
Gjakovë	2.662	35,3	4,3
Glllogoc	395	31,6	6,6
Gjilan	251	14,6	3,2
Dragash	579	13,1	1,7
Istog	4.753	47,7	5,8
Kaçanik	611	34,6	3,5
Klinë	722	20,6	1,8
F.Kosovë	1.174	35,1	2,4
Kamenicë	275	16,9	2,5
Mitrovicë	684	21,0	1,8
Leposaviq	243	12,8	0,6
Lipjani	832	26,7	4,6
Novobërda	218	23,3	0,8
Obiliqi	476	15,6	0,8
Rahoveci	4.522	45,9	6,6
Peja	7.954	71,9	9,8
Podujeva	1.179	22,5	5,7
Prishtina	862	29,5	4,0
Prizreni	2.073	33,8	3,5
Skenderaj	461	15,5	2,5
Shtime	264	23,2	1,6
Shtërpçë	242	45,7	0,8
Suharekë	1.451	26,5	4,4
Ferizaj	366	25,7	3,8
Viti	314	21,0	3,4
Vushtrria	1.873	15,6	1,9
Z.Potok	99	22,3	0,7
Zveçani	55	11,5	0,2
Malisheva	486	8,0	1,3

⁶⁰ Raport nga DU

⁶¹ Raporti i departamenti të ujërave

⁶² Burimi: SOK, raporti zero

⁶³ ESK, Enti i Statistikave të Kosovës

Gjendja e furnizimit me ujë nuk është e mirë as në këta sektorë: peshkim, turizëm, sport dhe rekreacion. Këtyre fushave nuk u është kushtuar kujdes as në të kaluarën, edhe pse ekzistojnë kushte të volitshme për zhvillimin e tyre.

Ndotja e ujërave⁶⁴

Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore nuk janë të mbrojtura nga ndotja dhe nuk respektohen në nivel të duhur zonat sanitare.⁶⁵

Industria është shpenzues i madh i ujit. Sasia e ujit që përdoret në industri në të shumën e rasteve kthehet prapë në rrjedhat ujore me cilësi të përkeqësuar. Po ashtu, në ekonomitë familjare përdorimi i ujit është tejet i madh dhe njëkohësisht paraqitet si ndotës i konsiderueshëm i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Detergjentet si mjete efikase në mbajtjen e higjienës kanë gjetur përdorim të madh në amvisëri. Ato llogariten në mesin e ndotësve me ndikim në mjedis, si ndotës biologjikisht jo të zërthyeshëm të cilët kontribuojnë në procesin e eutrofikimit të ujit.

Edhe përdorimi i karburanteve dhe vajrave nga makineria me djegie të brendshme, që në mënyrë direkte apo indirekte arrijnë deri të burimet e ujit, paraqesin një burim potencial të ndotjes së ujërave.

Shkarkimi i ujërave të zeza

Shkarkimet e ujërave të zeza përbejnë burimin kryesor të ndotjes së ujërave natyrore, sepse ato përmbajnë shumë lëndë që shpenzojnë oksigjenin e tretur, komponime të tretshme të fosforit dhe azotit (eutrofikimin), baktere dhe viruse patogjene, metalet të rënda si Cd, Hg, Zn, Pb, Cr, Cu, si dhe lëndë që prishin cilësinë e ujërave.

Nuk ka sistem të monitorimit të ujërave të zeza. Menaxhimi i sistemeve të kanalizimit bëhet nga shtatë kompani regjionale të ujësjellësit. Rreth 30% e popullatës në Kosovë kanë qasje në sistemin e largimit të ujërave të zeza.⁶⁶

Kosova nuk ka impiante për trajtimin e ujërave. Është përfunduar ndërtimi i impiantit në Skenderaj, por ende nuk është aktivizuar.

Eutrofikimi i ujërave

Eutrofikimi është indikator i shtimit të materieve ushqyese që ka për pasojë rritjen e numrit të algave dhe bimëve të larta në ujëra, duke shkaktuar dëmtimin e cilësisë së ujit dhe prishjen e baraspeshës ekologjike në ekosistemet ujore. Ujërat në kushte natyrore, të pa ndotur, kanë përmbajtje relativisht të ulët të azotit dhe fosforit, dhe kjo gjendje e ujërave njihet si gjendje “oligotrofike”. Kur ujërat e shkarkuara përmbajnë lëndë me origjinë antropogjenë të pasur me azot dhe fosfor, krijohet mundësia e rritjes së algave dhe humbja e kthjelltësisë së ujit. Një gjendje e tillë e ujërave njihet si gjendje “eutrofike”.⁶⁷

Gjendja eutrofike e ujërave ka pasoja të mëdha për organizmat ujorë, sepse shoqërohet me zvogëlimin e përqendrimit të oksigjenit të tretur në ujë.

Për gjendjen e eutrofikimit të ujërave në Kosovë nuk ka të dhëna, për shkak të mungesës së monitorimit të shkarkimit të ujërave të ndotura në lumenj. Mirëpo, vlerësohet se ujërat e përdorura industriale dhe urbane që shkarkohen direkt në rrjedhat e lumenjve pa trajtim paraprak ndikojnë në eutrofikimin e ujërave rrjedhëse.

Klasifikimi i lumenjve sipas klasave

Në bazë të monitorimeve të bëra të cilësisë së ujërave sipërfaqësore nga IHMK në vitin 2007, lumenjtë e Kosovës, u takojnë klasave me sa vijon:⁶⁸

Pellgu i Drinit të Bardhë: lumenjtë Ereniku, Lumëbardhi i Pejës (Bistrica), Lumëbardhi i Deçanit, Mirusha, Lumi Klina, Lumëbardhi i Prizrenit (Bistrica) deri në hyrje të qyteteve janë ujëra me kualitet të klasës së I, kurse nga dalja prej qyteteve i takojnë klasës së II.

Pellgu i Lepencit: Lumi Nerodime nga burimi deri në hyrje të qytetit të Ferizajt është i klasës së I, respektivisht klasës II, mirëpo, ai pëson ndotje të madhe pas shkarkimeve të ujërave të zeza dhe industriale nga qyteti dhe kalon në klasën e III dhe të IV.

Pellgu i Ibrit: Sitnica deri në derdhje të Graçankës ka karakteristikat e klasës së II, ndërsa pas derdhjes së ujërave urbane nga qyteti i Prishtinës dhe ato të kompleksit të KEK-ut kalon në klasën e III dhe të IV varësisht prej derdhjeve në lumë.

Ndërsa, Ibri nga prurjet e lumit Sitnicë për shkak të punës së hidrocentralit dhe derdhjeve artificialisht të baraspeshuara në rezervuarin e Gazivodës mbetet në klasën e II.

Pellgu i Moravës së Binçës, me derdhjet e kanalizimeve nga vendbanimet e Vitisë dhe Gjilanit nga klasa e II kalon në klasën e III deri në grykë derdhje të Lumit Kriva (Kriva

⁶⁴ Raport nga DU
⁶⁵ PKVM, 2006-2010

⁶⁶ SHUKOS

⁶⁷ Kimia e Mjedisit, Tirane, 2005, Aliqi Çullaj

⁶⁸ Departamenti i ujërave

Rekës). Nga Grykë derdhja e Lumit Kriva (Kriva Rekës) e deri në kufi me Serbinë për shkak të aftësive vetë pastruese të lumit, uji arrin kualitetin e klasës së II.


Monitorimi i ujërave sipërfaqësore

Në Kosovë monitorimin e ujërave sipërfaqësore e bënë Instituti Hidrometeorologjik me 28 stacione monitoruese. Në 54 profile ujore bëhet matja e parametrave fizik dhe kimik të cilësisë së ujit. Monitorim të pjesërishëm të ujërave bëjnë edhe: INKOS (për KEK-un), Ferronikeli, Sharr-cemi, etj.

Ujërat nëntokësore dhe akumulacionet nuk monitorohen. Ky fakt tregon nevojën e ngritjes së kapaciteteve të përgjithshme për një sistem të kompletuar të monitorimit të ujërave, si për nga shtimi i pikave monitoruese, numri i parametrave dhe shpeshtësia e marrjes së mostrave. IHMK planifikon të organizojë edhe monitorimin e parametrave biologjiko-bakterilogjik.


Harta 9. Harta cilësia e ujërave sipërfaqësore

Harta e cilësisë së Ujërave sipërfaqësore



Harta 10. Harta e stacioneve hidrometrike

RRJETI I STACIONEVE HIDROMETRIKE



Ministria e Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor
Agjencia e Kosovës për
Mbrotjtjen e Mjedisit



Sistemi Informativ Mjedisor / GIS

Emri i Hartës:
Rrjeti i Stacioneve Hidrometrike
Burimi i të dhënave: IHMK / AKMM
Projeksioni: UTM-WGS 84
Zona: 34 HV
Data: nëntor, 2007
Pishtime
Adresa: Rr. Nazim Gafuri nr.31
info@sim@k-s-gov.net

LEGJENDA

- Kufiri i Kosovës
- ▼ Stacionet Hidrometrike
- Lumë
- Rrethelje Lumore

Tabela 40. Analizat fiziko-kimike të ujërave sipërfaqësore sipas profileve të në pellgjet e Kosovës 2005/06/07

VLERAT MESATARE TE ANALIZAVE FIZIKO-KIMIKE TË UJËRAVE SIPËRFAQËSORE SIPAS PROFILEVE NE PELLGJET E KOSOVËS -2005/2006/2007										
Lumenjtë	Pikat monitoruese	Vlerat e TDS-mg/l			Vlerat e pH			Vlerat e O ₂ te tretur- mg/l		
		2005	2006	2007	2005	2006	2007	2005	2006	2007
Lepenci	Brezovicë	72.2	78.5	60	8.43	7.29	8.05	12.1	12.52	11.16
	Kaçanik	109	106	121	8.07	8.17	8.20	11.09	11.3	10.95
	Hani i Elezit	128	119	147	7.96	8.07	8.13	11.24	11.5	10.57
Nerodime	Nerodime	105	71.35	107	8.11	8.02	8.24	12.22	13.08	11.36
	Gërlice	203	210	275.2	7.75	7.84	7.82	7.50	8.19	6.194
	Kaçanik	209	223	265	7.81	8.00	8.02	9.52	10.36	9.71
Nerodime pjesa veriore që derdhet në Sitnicë	Ferizaj -te ura	261	204	261	7.67	7.94	7.37	10.43	16.4	13.98
Shtimja	Carralev	189	229	215	8.02	8.12	7.98	10.205	12.52	9.56
	Davidovc	240	227	262	8.09	7.93	7.98	10.07	9.25	8.44
Sitnica	Bablak	171	161	207	7.61	7.83	8.24	8.705	15.19	16.68
	Lipjan	252	225	249	7.83	7.68	7.85	7.09	10.69	12.12
	Vragoli	322	266	325	7.81	7.87	7.78	6.73	8.96	4.94
	Plemetin	278	253	279	8.06	7.93	8.13	7.26	7.05	6.61
	Nedakoc	227	322		7.74	7.78		12.03	7.54	
	Mitrovica	312	286	301	7.88	7.73	7.80	8.16	7.98	7.64
Prishtina	Bresja	356	303	362	7.76	7.75	7.81	5.52	5.56	4.28
Graqanka	Vragoli	833	778	760	7.70	7.67	7.74	10.0	9.05	9.42
Drenica	Baicë	239	219	291	8.11	8.08	8.1	11.38	15.54	10.64
	Vragoli	313	349	382	7.90	8.02	7.94	8.48	9.205	7.31

Lumenjtë	Pikat monitoruese	Vlerat e TDS-(mg/l)			Vlerat e pH -(0-14)			Vlerat e O ₂ te tretur- (mg/l)		
		2005	2006	2007	2005	2006	2007	2005	2006	2007
Llapi	Reqicë	145	127	129	8.18	7.91	8.14	11.28	10.27	10.01
	Podujevë	216	216	217	8.02	7.92	8.05	9.14	8.01	7.79
	Millosev	222	237	208	7.96	7.97	7.98	9.74	10.68	9.57
Ibri	Kushtovë	169	144	159	8.23	8.12	8.49	12.6	14.5	13.1
	Mitrovice	211	156	165	8.27	8.37	8.38	12.97	13.53	13.2
	Kelmend	247	236	256	7.86	7.87	7.94	9.57	9.29	7.43
Morava e Binqës	Viti	79	90	84	7.85	7.97	8.21	12.16	10.46	9.6
	Kllokot	201	183	181	7.81	7.79	7.93	9.26	8.42	8.11
	Uglare	234	291	296	7.69	7.70	7.83	7.23	6.27	5.65
Dardana	Dardan-hyrje	245	289	269	7.90	8.16	8.63	10.325	10.51	11.28
	Dardan-dalje	203	305	347	7.85	7.90	7.94	10.285	8.40	9.3
Drini i Bardh	Radavc	132	124	132	8.00	7.90	8.05	10.19	12.40	11.44
	Klinë	198	180	185	8.14	8.16	8.12	10.9	12.36	12.51
	Gjonaj	174	181	180	8.17	8.13	8.28	10.56	11.51	11.55
	Vërmice	158	145	187	8.15	8.13	8.49	11.21	14.27	12.27
Burimi	Burim	136	129	145	8.01	7.70	8.07	13.76	11.56	13.12
	Zllakuqan	171	166	172	8.1	8.05	8.14	10.41	10.79	12.59
Klina	Llaush	324	299	433	8.17	7.78	7.705	14.12	10.94	6.545
	Klinë	280	318	336	7.96	7.93	7.85	10.43	10.2	9.88
Lumbar. i Pejës	Mbi qytet	115	108	112	8.24	8.20	8.34	9.745	11.7	10.68
	Lagja Dardania	131	126	128	8.16	8.15	8.15	10.84	11.32	12.4

Lumenjtë	Pikat monitoruese	Vlerat e TDS-(mg/l)			Vlerat e pH -(0-14)			Vlerat e O ₂ te tretur- (mg/l)		
		2005	2006	2007	2005	2006	2007	2005	2006	2007
Rimniku	Xërxë	327	345	306	7.97	8.01	8.09	7.62	8.83	7.54
Toplluha	Buqall	201	218	256	8.22	8.25	8.22	11.11	12.5	9.56
	Piran	239	252	223	8.15	8.17	8.23	10.49	11.93	11.13
Lumbar. i Deçanit	Mbi qytet	162	151	102,8	8.18	7.86	8.12	11.55	12.45	10.66
	Kralan	177	158	204	7.88	8.17	8.17	10.50	11.65	10.21
Mirusha	Volljak	265	281	314	7.93	7.95	7.90	10.36	11.52	10.7
Ereniku	Junik	90	75	92.4	7.99	7.84	8.13	12.1	12.36	9.975
	Te ura e Terezive	141	141	169	8.01	8.05	8.14	10.7	11.0	11.02
Lumbar. i Prizrenit	Mbi qytet-Prevall	117	67	83	8.12	7.6	7.97	11.96	13.82	10.1
	Vlashnje	150	169	149	7.84	7.85	7.88	9.78	11.09	8.9
Plava	Plavë	Ne këtë periudhë kohore nuk ka monitorim te këtyre lumenjve								
Orqusha	Orqushë									
Restelicë	Restelicë									

Monitorimi i ujërave sipas institutit INKOS

Nga vlerat e prezantuara në tabelen nr.42, mund të vërehet se këto vlera në shumicën e rasteve kanë lëkundje minimale nga viti në vit, për periudhën tri vjeçare 2005-2007. Duke i krahasuar parametrat e matur në vendburimet e lumenjve me parametrat e pikave të tjera monitoruese, vërehet qartë se ku kemi ngritje të vlerave. Nga kjo rezulton se ujërat sipërfaqësore janë të cilësisë së kënaqshme vetëm në burim të tyre. Me rrjedhjen e tyre nëpër vendbanime dhe zona industriale, cilësia e ujërave bie varësisht nga sasia dhe niveli i ndotjes së ujërave që shkarkohen. Ky vlerësim i cilësisë së ujërave sipërfaqësore bazohet vetëm në rezultatet e monitorimit të parametrave fiziko-kimik. Për një vlerësim të pranueshëm të cilësisë së ujërave duhet të merren në konsideratë edhe parametrat biologjik, radiologjik etj.. Përkundër një tradite relativisht të mirë të monitorimit të cilësisë së ujërave, Kosovës i nevojitet krijimi i një sistemi të avancuar të monitorimit, bazuar në kriteret e BE dhe OBSH.

Monitorimi i ujërave në KEK bëhet në mënyrë periodike nga instituti INKOS. Ky monitorim bëhet në lumenjtë dhe efluentët kryesor që dalin nga zona e KEK-ut. Rezultatet mujore nuk janë të mjaftueshme për përcaktimin e shtrirjes së vërtetë të ndotjes. Monitorimi nuk përfshinë metalet e rënda dhe të rralla, të cilat janë elemente me të rëndësishme në spektrin e kërkesave për vlerësimin real të kualitetit të ujit. Programi i monitorimit është gjithashtu i pamjaftueshëm sa i përket pikave dhe frekuencës së monitorimit. Monitorimi bëhet edhe për ujërat nëntokësore në këtë zonë.

Rezultatet e monitorimit të ujërave të shkarkuar nga TCA,TCB në lumin Sitnicë për vitin 2005 dhe 2006 janë paraqitur në dy tabelat vijuese.

Tabela.41. Parametrat dhe kufijtë e lejuar sipas klasave⁶⁹

Nr.	Parametrat	Kufijtë e lejuar			
		Klasa e I	Klasa e II	Klasa e III	Klasa IV
1	Aroma	PA	PA	-	-
2	Ngjyra	PA	-	-	-
3	Temperatura	-	-	-	-
4	Përçueshmëria elektrike	1500	1500	Mbi 1500	Mbi 1500
5	Vlera e Ph	6.5-8.5	6.5-8.5	6.0-9.0	6.0-9.0
6	Nitratet	10	10	Mbi 10	Mbi 10
7	Nitritet	0.05	0.05	0.5	0.5
8	Oksigjeni i tretur	8	6	4	3
9	Ngop. me oksigjen %	90-105	75-90	50-75	30-50
10	Kloruret	200	200	Mbi 200	Mbi 200
11	Mbetja e thatë e pa filtruar	350	1000	1500	1500
12	Mbetje e thatë e filtruar	-	-	-	-
13	Materiet e suspenduar	10	30	80	100
14	Sulfatet	200	200	Mbi 200	Mbi 200
15	Harxhimi i KMnO ₄	8-12	8-12	-	-
16	Fenolët	0.001	0.001	0.3	0.3
17	SHBO5	2	4	7	20

Tabela.42. Parametrat dhe kufijtë e lejuar sipas klasave

Monitorimi i ujërave të shkarkuara nga Termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” në Recipientin – Sitnicë, 2005

Subjekti		Recipientët: Sitnicë,Llap											Termocentrali “Kosova B”										
Nr	Parametrat(mg/l)	Deponia e hirit	Termocentrali “Kosova A”		Ngrohore	Gazifikim								Ujërat sipërfaqësor				Ujërat nëntokësore					
		2.2	3.1	3.2			3.3	3.4	1a	3	4	5	6	7	4.1	4.2	4.3	4.4	P2	Pa	Pb	Pc	Pd
1	Aroma (e nuhatur)	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	
2	Ngjyra (e vërejtur)	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	
3	Temperatura (°C)	12.7	12.6	11	13	12.5	11.8	12	11.5	9.92	11.1	11.2	15.5	22	14.2	14.8	12.5	13.5	12.4	12.1	12.3		
4	Përqu. (S/cm)	1853	634	995	1172	464	568	623	569	479	547	491	424	462	381	401	2832	1415	1369	1615	1329		
5	Vlera pH	10.1	8.6	9.8	8.8	8.1	8.0	8.0	8.3	8.0	8.2	8.9	9.79	8.5	8.3	7.8	8.0	7.9	8	7.9			
6	Nitratet (mg/l)	1.5	3.81	3.57	3.56	1.76	6.33	6.58	6.27	62.9	5.72	5.47	2.72	2.31	2.61	2.76	0.83	2.16	1.3	1.1	1.36		
7	Nitritet (mg/l)	0.0	0.0	0.0	0	0.19	0.0	0.0	0.83	0.0	0.0	0.0	0.15	0.04	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		
8	O ₂ i Tretur(mg/l)	9.15	9.06	8.97	9.12	8.87	8.37	7.54	8.52	9.64	9.7	9.6	8.8	5.47	9.9	9.33	7.6	7.49	8.3	8.22	8.06		
9	Ngop me O ₂ (%)	88.1	87.4	78.7	89.5	85.7	77.3	72.1	82.6	88.8	91.8	90.9	86.2	62.4	89.1	98.2	74.5	73.6	79.9	75.9	78.5		
10	Kloruret	144	38.1	22.3	63.8	138	37	39.1	33.8	22.8	30.2	29.3	27.6	19.3	26.4	27.6	83.9	41.5	36.1	32.3	36.4		
11	Mbetja e thatë e pa filtruar	1641	651	603	446	751	748	743	711	588	598	637	378	2077	1037	543	3980	2499	2633	2227	1710		
12	Mbetja e thatë e filtruar	1530	562	523	338	432	584	570	519	467	468	477	313	577	438	685	3330	2270	2303	2053	1508		
13	Materiet e suspenduara	111	85.4	80	118	325	152	181	186	87.9	141	150	66.3	113	600	181	118	292	271	246	202		
14	Sulfatet	537	87.6	102	84.3	62.8	96.1	126	113	54.3	74.7	67.2	49.7	154	96.3	109	1541	692	739	860	634		
15	H.i KMnO ₄ (mg/l)	79.4	77	16.4	15.2	14.9	25.3	20.7	24.1	15.9	20	17.1	15.9	19.9	17.2	17.1	55.1	17.6	19.7	18.7	15.1		
16	Fenolet	0		0.005		0.01		0.01	0.007			0.01				0.02							
17	SHBO ₅ (mg/l)	2.13	2.4	1.8	1.6	2.4	4.7	4.2	4.7	3.1	4.3	4.5	2.1	3.12	2.24	2.19	1.63	4.1	2.4	3.8	3.04		
18	Vlera "p"mval/l	4.71	0.52	0.08	1.95	0.08	0.04	0.05	0.0	0.03	0.03	0.04	0.42	0.57	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		
19	Vlera "m"mval/l	2.1	4.9	4.1	4.6	4.1	5.1	5	4.47	4.7	4.6	4.6	2	2.21	2.3	2.3	5.7	5.1	5.1	6.6	4.8		
20	Hidroksidet	8.78	0.49	0.0	0.95	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.39	6.1	0.18	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		
21	Karbonatet	2.5	2.0	5.0	63.8	5.0	2.0	3.0	0.0	2.0	1.5	2.5	0.0	6.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0		
22	Bikarbonatet	91.9	262	252	74.6	243	302	305	265	288	278	305	113	99.5	154	188	380	312	317	380	308		

Tabela 43. Ujrat e shkarkuara nga Termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” ne Sitnicë 2006

Monitorimi i ujërave të shkarkuara nga Termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” në Recipientin – Sitnicë,2006

Subjekti		Recipientët: Sitnicë,Llap												Termocentrali “Kosova B”									
Nr	Parametrat (mg/l)	Deponia e hirit	Termocentrali “Kosova A”	Ngrohore		Gazifikim		Ujërat sipërfaqësor										Ujërat nëntokësore					
		2.2	3.1	3.2	3.3	3.4	1a	3	2	4	5	6	7	4.1	4.2	4.3	4.4	4.5	P2	Pa	Pb	Pc	Pd
1	Aroma (e nuhatur)	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa
2	Ngjyra (e vërejtur)	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa	Pa
3	Temperatura (°C)	14.3	11.96	12.9	11.6	12.5	11.32	12.23	16	11.64	10.4	10.99	10.9	15.9	20.4	15.25	13.9	15.4	12.6	14.2	13.3	12.4	12.7
4	Përqu. (S/cm)	947.5	539	448	819	470	585.8	546.7	586	918	423	480	485	422	369	461.8	318	255	2098	1893	1672	1491	1517
5	Vlera pH	8.3	7.9	8.1	7.23	8.34	7.8	7.9	7.9	7.9	8.0	7.8	7.8	8.2	9.7	8.7	8.4	8.3	7.8	7.8	7.84	7.8	7.8
6	Nitratet (mg/l)	1.3	1.3	1.3	2.1	3.1	5.3	5.6	5.9	5	3.8	4.5	4.3	2.7	3.5	2.8	2.6	2.6	1.8	0.9	0.9	1.14	1.05
7	Nitritet (mg/l)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.001	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0003	0.05	0.08	0.003	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
8	O ₂ i Tretur(mg/l)	8.34	9.19	8.9	8.2	8.6	8.1	7.8	7.2	8.1	9.29	9	9.12	8.2	6.3	8	9.3	8.5	6.2	6.1	7.17	7.2	8.3
9	Ngop me O ₂ (%)	80.3	87.7	84	81.9	84.2	77	75	75.6	76	83.7	83.56	85.8	85.7	70.6	80	93.1	87.1	61.6	60.1	70.3	69.9	70
10	Kloruret	36.6	23.6	28	409	35	35.08	36.67	30	35	23.6	27.7	29.5	30.5	25.5	45.17	27.4	27.6	88.7	54.8	50.3	41.2	36
11	Mbetja e thatë e pa filtruar	1198	662	667	783	606	770	690	715	658	463	529	597	565	913	600.8	561	664	4091	2349	1139	1474	2260
12	Mbetja e thatë e filtruar	1026	585	587	699	496	567.5	523	443	495	357	424.6	491	350	378	435.8	429	540	3477	1636	996	1058	1882
13	Materiet e suspenduara	171.2	76.7	80	83.8	110	202.5	168.8	273	162.1	97.5	104.2	106.2	215	536	172.6	132	127	615	713	382	402	378
14	Sulfatet	555.5	83.1	63	173	54.4	105.4	119.4	140	113	49.6	70.95	77.16	78.04	90.5	105.3	75	67.1	1566	1029	907	880	915
15	Harxhimi i KMnO ₄ (mg/l)	73.22	18.2	18	15.4	15.7	16.32	14.86	17.2	17.1	13.1	15.42	16.4	19.05	17	20.73	19.6	16.1	22	16.3	18.6	24	22.4
16	Fenolet	0.009	-	-	0.11	0.01	-	0.026	-	0.015	-	0.008	0.005	0.006	0.003	-	-	0.003	-	-	-	0.003	-
17	SHBO ₅ (mg/l)	2.28	2.5	1.6	17.4	2.8	4.4	4.97	4.96	36.99	2.04	3.2	3.3	2.6	1.88	1.9	1.6	1.3	0.9	3	2.79	1.6	1.9
18	Vlera "p"mval/l	0.00	0.00	0.0	0.10	0.0	0.0	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.8	0.3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
19	Vlera "m"mval/l	3.12	4.18	4.5	3	7.8	4.6	4.9	5.3	4.16	4.43	4.46	4.3	2.2	1.54	2.27	2.07	2.61	6.91	5.69	6.96	7	5.13
20	Hidroksidet	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.4	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
21	Karbonatet	0.0	1	1.5	12.7	2	0.5	3	2.5	1.5	2.5	1.5	1	0.0	12	2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
22	Bikarbonatet	189	255	265	154	263	297.7	292.8	318	264.3	294	294.3	281	157.4	55.2	136.3	159	159	411	376	424	418	313

3. TOKA / DHEU

Ndikimi i vazhdueshëm nga aktivitetet njerëzore sjell deri te degradimi i sipërfaqeve tokësore duke shkaktuar edhe pasoja socio-ekonomike. Sfida është që të parandalohet degradimi i tokave përmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave.

Vlerësimi i gjendjes⁷⁰

Kosova karakterizohet me një llojllojshmëri të tokave duke u bazuar në gjenezën e krijimit të tyre dhe karakteristikave pedologjike, fizike dhe kimike. Sipërfaqja tokësore e Kosovës është e përshtatshme për prodhimtari bujqësore. Llojet e tokave që më së shpeshti i hasim në Kosovë janë: humusore, toka aluviale dhe deluviale, toka shkëmbore etj.


Faktorët kryesor që ndikojnë në humbjen e tokave në Kosovë janë:

-  Vendbanimet (ndërtime të paplanifikuara);
-  Industria (mbeturinat industriale, mihjet sipërfaqësore);
-  Minat e mbetura nga lufta e fundit në Kosovë;
-  Mbeturinat shtëpiake dhe deponitë;
-  Erozioni;
-  Eksploatimi i pakontrolluar i zhavorrit.

Ndotja me metale të rënda

Kjo kategori e ndotjes është prodhuar nga proceset industriale. Metale të rënda dhe shumë toksike të cilat kontribuojnë në ndotje janë: merkuri metalik dhe komponimet organomerkurike si dimetilmerkuri i $\text{Hg}(\text{CH}_3)_2$, arseni, plumbi, kadmiumi, beriliumi etj. Efektet e tyre në organizëm janë tejet negative duke shkaktuar dëmtim të sistemit nervor, sistemit kardiovaskular, sistemin urinar po ashtu, shkaktojnë pneumoni dhe plagë të rënda në lëkurë. Në Kosovë kemi mungesë informacioni për shkallën e kësaj ndotje.

Harta 11. Harta pedologjike



Erozioni dhe rrëketë

Erozioni dhe rrëketë në territorin e Kosovës rrezikojnë natyrën dhe pasuritë shoqërore dhe private të krijuara dhe të planifikuara. Manifestohen me degradimin e tokës bujqësore dhe pyjore, rrjetit rrugor dhe hekurudhor, si dhe objekteve ndërtimore dhe vendbanimeve.

Produktiviteti më i theksuar i aluvioneve është në rrjedhën e sipërme të lumit Ibër (gjendja duhet përmirësuar me masa dhe veprime antierozive). Po ashtu, edhe sipërfaqet e pellgut të Lepencit janë të rrezikuara nga erozioni. Pastaj, vijnë pellgjet e Drinit të Bardhë dhe Moravës së Binçës, ndërsa rreziku me i vogël i erozionit është në pellgun e lumit Sitnicë.

Tabela 44. Gjendja ekzistuese e erozionit

Kategoria	I, II, III	5.973 km ² ose 55.6 %
Kategoria (erozion i dobët)	IV	3.680 km ² ose 34.2 %
Kategoria (erozion shumë i dobët)	V	1.097 km ² ose 10.2 %


Destinimi i shfrytëzimit të tokës

Nga sipërfaqja e tërësishme e Kosovës 1.098.200 ha, 574.231 ha, është tokë bujqësore, 450.249 ha, është tokë pyjore, 12.073 ha, është tokë urbane, 27.796 ha, është tokë trafiku, 12.344 ha, është sipërfaqe ujore, ndërsa 12.814 ha, janë sipërfaqe tjera (10)


Ndryshimi i destinimit të tokës bujqësore vlerësohet si një ndër kërcënimet më serioze që i bëhen të ardhmes së bujqësisë në Kosovë. Mbi 1.000 hektarë tokë bujqësore në vit janë konvertuar në tokë ndërtimore në kohën para vitit 2000, kurse tani ka

vlerësime se kjo shifër është më e madhe dhe me tendencë rritjeje. Fragmentimi i parcelave është problem tjetër i madh, sipërfaqja e përgjithshme për amvisni e ndarë në shumë parcela që shpesh paraqet kufirin e poshtëm të arsyeshmërisë ekonomike për tu prodhuar në ato parcela. Ndotjet industriale nga komplekset industriale, por edhe ndotësit tjerë më të vegjël, paraqesin kërcënim serioz për sipërfaqet tokësore. Po ashtu, edhe kontaminimi i tokës nga deponitë e mbeturinave është burim i ndotjes të sipërfaqes së tokës.

Grafikoni. 32. Struktura e tokës sipas shfrytëzimit në ha



Grafikoni. 33. Struktura e tokës sipas shfrytëzimit në %



Zonat e minuar

Pas përfundimit të luftës, në Kosovë mbetën shumë fusha të minuara, fushëbeteja të papastruara dhe shumë mjete tjera të pashpërthyera. Sipas të dhënave zyrtare të UNMIK-ut në Kosovë janë rreth 1300 caqe të sulmuara nga NATO dhe rreth 620 vende të minuara nga ushtria serbe. Sipas TMK-së, ka ende fusha të paidentifikuara, meqë ushtria serbe nuk i ka dhënë informacionet për të gjitha fushat e minuara si dhe për shkak të shpërndarjes së madhe të mjeteve të pashpërthyera.



Foto: Procesi i deminimit

Tabela. 45. Lista e pastrimit të minave dhe mjeteve të pashperthyera në Kosovë, qershor 1999 - nëntor 2007⁷¹

Viti	M2	ha	Mina Anti-personale	Mina Anti-tank	Bomba kasetore	Mjete eksplozive plasëse
Qershor 1999-2001	32224107	3222.4107	19457	5515	15940	13896
2002	187346	18.7346	200	27	318	5207
2003	799242	79.9242	198	1	398	2155
2004	2730912	273.0912	910	15	772	2554
2005	4318966	431.8966	719	30	977	1378
2006	2754310	275.431	695	84	879	2498
16 .11. 2007	1076679	107.6679	292	14	271	1230
Total:	44091562	4409.1562	22471	5686	19555	28918



Foto: Procesi i deminimit

⁷¹ TMK- www.tmk-ks.org. Zyra e Kordinatorit të TMK-së UNMIK,

4. BIODIVERSITETI DHE ZONAT E MBROJTURA

Ndryshueshmëria midis organizmave të gjallë që jetojnë në ekosistemet tokësore, detare dhe ekosisteme të tjera ujore dhe komplekset ekologjike në të cilat ato bëjnë pjesë; kjo përfshinë diversitetin brenda llojit, midis llojeve dhe ekosistemeve⁷².

E thënë me fjalë të tjera, termi diversitet biologjik shpreh numrin dhe gjithë larinë e organizmave të gjallë në planet. Brenda këtij termi përfshihet diversiteti i gjeneve, llojeve dhe ekosistemeve që janë produkt i një procesi evolutiv prej më se 3 miliard vjet. Njerëzimi dhe mbijetesa e tij varet nga ky diversitet biologjik. Në këtë kuptim termi diversitet biologjik është sinonim i termit “Jeta në planet”.

Vlerësimi i gjendjes

Ndonëse, Kosova është një vend i vogël, shquhet për një biodiversitet të pasur. Pozita gjeografike, faktorët gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima janë disa prej faktorëve që kanë mundësuar që Kosova të ketë një diversitet të pasur biologjik dhe peizazhor me një llojllojshmëri floristike, vegjetative dhe faunistike, ku vlen të theksohet prania e llojeve relikte, endemike si dhe llojeve me rëndësi të veçantë. Sipas studimeve që janë bërë në Kosovë, janë identifikuar rreth 1800 lloje të florës. Supozohet që ky numër është më i madh dhe arrin deri në 2500 lloje. Florën dhe faunën⁷³ e Kosovës e bëjnë të rëndësishme dhe atraktive një numër i madh i llojeve endemike, relikte dhe subendemike. Zonat më të pasura me florë dhe faunë janë “Malet e Sharrit” dhe “Bjeshkët e Nemuna”.⁷⁴ Kosova akoma nuk ka një inventar të plotë të biodiversitetit. Gjatë viteve të kaluara është punuar mjaft në evidentimin e zonave të reja të natyrës dhe marrjen në mbrojtje ligjore të tyre. Numrit të zonave të mbrojtura (52), gjatë periudhës 2006-2007, u janë shtuar edhe 24 zona të reja me sipërfaqe prej 7.25 ha, dhe tani kemi 75 zona të mbrojtura. Sipërfaqja e përgjithshme e zonave të mbrojtura tani është 46.437 ha (4.25 % e territorit të Kosovës). Po ashtu, janë propozuar edhe 195 zona të reja përfshirë këtu edhe “Bjeshkët e Nemuna” për Park Nacional. Me këtë edhe objektivat e dala nga PKVM që kanë të bëjnë me zonat e mbrojtura kanë filluar të realizohen, mirëpo mbetet ende shumë punë për tu bërë.

Zonat e mbrojtura të natyrës dhe biodiversiteti kanë pësuar ndryshime me rritjen e intensitetit të ndikimit të aktivitetit të njeriut në to. Zhvillimi i veprimtarive të shumta dhe të ndryshme në natyrë siç janë: ndërtimi i vendbanimeve, zhvillimi i turizmit malorë, ndërtimi objekteve industriale dhe hoteliere, prerja e pyjeve, shfrytëzimi i inerteve dhe

veprimtaritë tjera shpeshherë janë bërë pa kriter të qëndrueshëm dhe kanë qenë faktorë kërcënues për vlerat e natyrës. Nga këto ndikime nuk janë kursyer as Parku i vetëm Nacional “Malet e Sharrit”, Parku Regjional “Mirusha”, “Shpella e Mermertë” në Gadime, Parku “Gërmia” etj. Po ashtu, nga ky ndikim gjithnjë e më shumë janë vërejt humbje dhe copëtim i habitateve, dëmtim dhe degradim i ekosistemeve, shqetësime të kafshëve të egra në natyrë, zhdukje e llojeve apo kërcenim për zhdukje.

Deri me sot asnjë projekt i dalë nga PKVM nuk është realizuar dhe as që ka filluar të realizohet. Rekomandimet kanë të bëjnë me përballimin me sfidat për ndalimin e mëtejshme të këtij ndikimi negativ, prandaj është i domosdoshëm:

- Forcimi i kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen e natyrës;
- Strategjia dhe plani i veprimit për biodiversitetin;
- Inicimi i projekteve për inventarizim të dala nga PKVM, pasi që edhe më tutje Kosova nuk ka një inventarizim të plotë të florës dhe faunës;
- Krahas zgjerimit të sistemit të zonave të mbrojtura, përparësi duhet kushtuar edhe hartimit dhe zbatimit të planeve të menaxhimit të këtyre zonave me qëllim të gjetjes së modeleve më të përshtatshme;
- Të rritet interesimi për pjesëmarrjen në nismat rajonale dhe evropiane siç është Natura 2000, SPA, Emerald, etj.

Flora dhe vegjetacioni

Në aspektin floristik, në bazë të hulumtimeve të deritanishme janë evidentuar mbi 1800 lloje bimore të florës vaskulare, megjithëse supozohet se numri i tyre është më i madh (rreth 2.500). Në kuadër të llojeve të hulumtuara rreth 200 prej tyre janë endemike, endemorelikte dhe subendemike. Sidomos është i rëndësishëm grupi i endemikëve lokale, numri i të cilëve është ende i pa definuar plotësisht (dihet për katërmbëdhjetë lloje të florës vaskulare), disa prej të cilave kanë përhapje mjaft të kufizuar. Këto lloje endemike si dhe lloje të tjera bimore, ndër të cilat ka edhe bimë me veti mjekuese, janë të përhapura në disa pjesë të maleve të Kosovës. Vende me fito-diversitet më të pasur konsiderohen “Malet e Sharrit” dhe “Alpet Shqiptare” (“Bjeshkët e Nemuna”).

Gjatë vitit 2005 ekipet e IKMN-së kanë filluar të punojnë më intensitet në studimin e llojeve bimore, dhe në veçanti të disa llojeve shtazore. Në këtë aspekt nga Sektori i Biodiversitetit janë studiuar disa lloje endemike dhe disa lloje të rralla dhe të rrezikuara. Ndërsa, disa prej llojeve

⁷² Konventa e biodiversitetit

⁷³ PKVM-Vegjetacioni i Kosovës klasifikohet në 139 asociacione, 63 alianca, 35 rrathë dhe 20 klasë. Kosova ka rreth 230 specie të vertebrateve të egra, përderisa speciet invertebrate nuk janë studiuar sa duhet. Ka rreth 150 lloje fluturash dhe rreth 400 lloje të makrobentosit të ujërave të ëmbla.


⁷⁴ PKVM-Vlerësohet se ka: 8 lloje të ndryshme të peshkut, 13 ujtokësor, 12 lloje zvarranikësh, 154 lloje shpendësh 37 lloje gjitarësh dhe 147 lloje të fluturave ditore.

stenoendemike ndodhen të herbarizuara në herbariumin e IKMN-së.

Disa nga llojet endemike karakteristike për Kosovë janë: *Achillea alexandri* Regis Bornm. et Rud. 1934. (*Barpezmi i mbretit Aleksandër*); *Aconitum pentheri* Hauek 1916. (*Akoniti i Rusolisë*); *Aristolochia merxmuelleri* Greuter et Mayer 1985. (*Petriku i Grojterit*); *Bornmuellera dieckii* Deg. 1900. (*Bornmulera e Degenit*); *Centaurea albertii* Rexhepi 1980. (*Kokoçeli i Albertit*); *Cephalaria pastricensis* Dorfl. et Hayek. 1921. (*Cefalaria e Pashtrikut*); *Convolvulus cochlearis* Griseb. 1844. (*Dredhja e Kosovës*); *Cynoglossum krasniqi* 1986. (*Gjuhëqeni i Krasniqit*); *Dianthus scardicus* (Karafili i sharrit); *Micromeria albanica* (Griseb. ex K. Maly) Silic. 1979. (*Bishtmiu shqiptar*); *Plantago dardanae* Rexhepi et Dimov. 2001 (*Plantago dardane*); *Potentilla doerfleri* Wettst. 1892. (*Zorrëca e Dorflerit*); *Rubus ipecensis* rech. 1935. (*Manaferra e Pejës*); *Sedum flexuosum* (*Rrushqyqja e ephsme*); *Sempervivum kosaninii* Praeger 1930. (*Burgulli i Koshaninit*); *Saxifraga scardica* (*irigëza e sharrit*); *Stipa mayer* Mart. 1971. (*Pendëkaposhi i Mayerit*); *Thymus doerfleri* (*Zhumbrica e Dorflerit*); *Thymus rochlenae* (*Zhumbrica*); *Verbascum scardicum* Bornm. 1922. (*Barpeshku i Sharrit*)

Krahasuar me sipërfaqen që ka Kosova (afër 2.3%) në kuadër të Gadishullin Ballkanik mund të vijmë në një përfundim relativ se fitodiversiteti i Kosovës është i mirë. Për ilustrim po e përmendim vetëm një shembull: deri më tani në Parkun Kombëtar “Malet e Sharrit” janë evidentuar afro 2.000 lloje të bimëve vaskulare. Prej numrit të përgjithshëm të llojeve të evidentuara në “Malet e Sharrit”, 86 lloje janë shpallur ndërkombëtarisht të rëndësishme, 26 lloje janë të përfshira në Listën e Kuqe të Evropës, ndërsa sipas IUCN-së, 32 lloje që gjinden në “Malet e Sharrit” janë në Listën e Kuqe të bimëve të kërcënuara. Vetëm në zonën subalpike dhe alpine të “Alpeve Shqiptare” (“Bjeshkët e Nemuna”) janë evidentuar 797 lloje të bimëve vaskulare, ku 128 prej tyre konsiderohen me karakter endemik.⁷⁵

Grafikoni 34. Numri i llojeve endemike të flores vaskulare të Kosovës



Në florën e Kosovës ekzistojnë edhe një numër i konsiderueshëm i llojeve bimore që konsiderohen të rralla dhe të rrezikuara, nisur nga fakti se një numër i madh i këtyre llojeve bimore janë të përfaqësuara me lloje me areal të ngushtë. Në masë të madhe për shkak të mbishfrytëzimit janë të rrezikuara edhe disa nga llojet bimore mjekësore, aromatike dhe industriale. Me qëllim të mbrojtjes së këtyre llojeve ndjehet nevojë e domosdoshme e përpilimit të një liste të llojeve të rralla dhe të rrezikuara, e cila është në përpunim e sipër dhe do të definohet pas analizës së duhur në terren.

Disa nga llojet bimore që konsiderohen të rralla dhe të rrezikuara në Kosovë janë: *Bershei i rëndomtë* / *Taxus baccata* L.; *Bujgeri* / *Quercus trojana* Eëbb.; *Vidhi i rëndomtë* / *Ulmus campestris* L.; *Panja malore* / *Acer heldreichii* Orph.; *Boshtra* / *Forsythia europea* Deg. Et Bald.; *Vulfonia* / *Wulenia carinthiaca* Jack.; *Tulipani i Sharrit* / *Tulipa scardica* Bornm.; *Troliusi* / *Trollius europeus* L.; *Zambaku* / *Lilium albanicum* Gris.; *Karafili i Sharrit* / *Dianthus scardicus* Eëst.; *Kurorëzë* / *Fritillaria graeca* Boiss. et Sprun.; *Bathra* / *Narcissus poeticus* L.; *Lepjeta* / *Rumex balcanicus* Roth.; *Asheja* / *Ilex aquilifolium* L.; *Xerxolja* / *Daphne blagayana* Freyer.

Edhe pse fitodiversiteti i Kosovës është shfrytëzuar me shekuj, brengosë fakti që kohëve të fundit ky shfrytëzim është jo racional dhe i pa planifikuar, gjë që në të ardhmen mund të rezultojë me pasoja të paparashikuara. Çak i dëmtimeve janë posaçërisht pyjet, por edhe zonat tjera me prani të vegjetacionit primar natyror.

Tabela 46. Numri i disa llojeve të qenieve të gjalla në Kosovë në raport me ato evropiane dhe botërore sipas grupeve kryesore

Grupi	Lloje në Kosovë	Lloje në Evropë	Lloje në Botë
Alga	400 (x)	Te panjohur	>40,000
Kërpudha	104 (x)	16,000	>70,000
Bimë me lule	1800 (2500)	11,415	250,000
Molusqe	X	Te panjohur	80,000
Insekte	129 (x)	40,000	1,000,000
Peshq të ujërave të ëmbla	8	Te panjohur	8,500
Amfibe	14	62	4,000
Reptilë	14	123	6,500
Shpendë	154 (175)	450	9,881
Gjitarë	45	200	4,327

Fauna

Në aspektin faunistik Kosova karakterizohet me një faunë mjaft të pasur, heterogjene, endemike dhe interesante, me një llojshmëri të madhe të llojeve edhe pse hulumtimet në këtë drejtim nuk kanë përfunduar. Hapësirat më të begatshme faunistike në Kosovë janë “Malet e Sharrit”, “Alpet Shqiptare” (“Bjeshkët e Nemuna”) dhe “Pellgjet Ujore”.

⁷⁵ Millaku, F. 1999

Llogaritet se në Kosovë jetojnë mbi 224 lloje të rruazorëve, 150 lloje të fluturave, mbi 500 taksonë të makrozoobentosit të ujërave dhe shumë parruazor tjerë të cilët ende nuk janë të determinuar. Rreziku nga zhdukja u kanoset posaçërisht disa gjitarëve të mëdhenj dhe shumë shpendëve. Në Kosovë ekzistojnë vetëm dy rezervate të faunës së egër: Rusenica në komunën e Therandës (vendbanim i rrëqebullit-Lynx lynx) dhe Kozhnjari në komunën e Deçanit, (vendbanim i dhisë së egër- Rupicapra rupicapra).

Pyjët e larta dhe ekosistemet malore të Kosovës ofrojnë kushte të volitshme për jetesën e popullatave të rëndësishme të gjitarëve të mëdhenj si ariu i murrmë, rrëqebulli, kaprolli, dhia e egër etj., pastaj të shumë llojeve të shpendëve grabitqare dhe këngëtare, mjaft të rëndësishme për ornitofaunën e Kosovës, Ballkanit dhe Evropës. Shqiponja e maleve, faikoi thonjëbardhë, pulëegra janë disa nga llojet më reprezentative të vendit, të cilat kanë edhe status ndërkombëtar të mbrojtjes. Ato gjenden në listën e IUCN-së (Unioni Botëror për Ruajtjen e Natyrës), EU-RL (Lista e kuqe Evropiane), WR-RL (Lista e kuqe botërore). Gjendja e faunës së kurrizorëve të lartë në Kosovë sipas të dhënave dhe informacionit të grumbulluar në terren, është jo e mirë. Ato flasin për një përkeqësim të gjendjes së tyre edhe nga:

-  Gjuetia e paligjshme dhe pa asnjë kriter;
-  Përndjekja dhe kapja me qëllim tregtimi;
-  Shqetësimi i vazhdueshëm prej njeriut;
-  Peshkimi i paligjshëm;
-  Shkatërrimi i habitateve natyrore;
-  Ndikimi i urbanizimit, transportit dhe turizmit.

Mbrojtja e llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës “in situ” është e rregulluar në atë mënyrë që zona speciale janë emëruar rezervate të mbrojtura të llojeve të caktuara të florës dhe faunës (shtatë rezervate bimësh dhe dy rezervate shtazësh). Aktualisht nuk ka ndonjë organizim për menaxhimin e tyre e as plane për mirëmbajtje dhe zhvillim.

Me qëllim të mbrojtjes së llojeve të rrezikuara të faunës në vitin 2003 përmes një vendimi MMPH ka përpiluar një listë ku si lloje raritete, të rralla, të rralluara dhe të rrezikuara të gjitarëve në Kosovë janë shpallur rreptësisht të mbrojtur dhjetë lloje të gjitarëve Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), Rrëqebulli (*Lynx lynx*), Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Macja e egër (*Felis sylvestris*), Dreri (*Cervus elaphus*), Ketri (*Scirius vulgaris*), Kunadhja e artë (*Martes martes*), Kunadhja e bardhë (*Martes foina*) dhe Gjери i lajthive (*Muscardinus avellanarius*).⁷⁶

Deri më tani nuk janë vendosur praktika institucionale për mbrojtjen e llojeve “ex situ”. Mirëpo, përkundër këtij fakti, disa nga këto lloje mbahen në mini-kopshte zoologjike, zakonisht të ngritura nëpër restorante pa kurrfarë kriteresh. Gjatë vitit 2005, IKMN ka vizituar të gjitha këto mini-kopshte zoologjike dhe ka evidentuar llojet e rralla që mbahen në to.

Në Kosovë është evidente mungesa e kopshteve zoologjike të cilat siç dihet përveç vlerave estetike, shkencore, kulturore, rekreative etj. shërbejnë edhe si mënyrë e ruajtjes “ex-situ” (jashtë vendbanimit të tyre natyror) të disa llojeve të shtazëve, por kjo mungesë nuk i arsyeton veprimet e këtyre individëve për mbajtjen e këtyre shtazëve pa respektuar kriteret për funksionimin e tyre. Duke marrë parasysh kushtet që duhet plotësuar me rastin e mbajtjes së shtazëve në izolim siç janë: hapësira dhe mjedisi jetësorë, ushqimi, numri i individëve dhe kushtet për shumim, kontakti me llojet tjera, mundësia e ofrimit të kushteve sa më natyrale, përkujdesja e veterinarit etj., shohim se shumicën e këtyre kushteve nuk i plotësojnë këto mini-kopshte.

Biodiversiteti agrar

Sa i përket biodiversitetit bujqësor ende nuk është kryer inventarizimi dhe mund të supozohet se intensifikimi i përdorimit të gjenotipeve produktive dhe moderne për prodhimtari intensive ka rrezikuar zhdukjen e disa llojeve dhe varieteteve autoktone.

Prania e OMGJ-ve

Edhe pse në Kosovë ende nuk është krijuar bazë ligjore për sigurinë biologjike dhe aktet normative lidhur me procedurat, përdorimin, mbikëqyrjen dhe licencimin e OMGJ-ve dhe substancave që përmbajnë OMGJ, nuk ekzistojnë veprimtari, zyrtarisht të regjistruara, për përdorimin e materialeve të modifikuara gjenetiki dhe prodhimin e tyre për qëllime komerciale.

Zonat e mbrojtura të natyrës

Mbrojtja e natyrës përmes zonave të mbrojtura është instrument mjaft i rëndësishëm për ruajtjen e biodiversitetit. Deri më tani janë marre nën mbrojtje ligjore 75 zona të natyrës dhe janë propozuar 195 të tjera. Zonat e mbrojtura përfshijnë sipërfaqen prej 46.437 ha, (4.25 % e territorit të Kosovës).⁷⁷ Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: **11 rezervate të natyrës** (Bifurkacioni i lumit Nerodime, Rezervati i Arnenit, Maja e Ropsit, Rusenica, etj.), një **Park kombëtar** (Malet e Sharrit), **59 monumente të natyrës** (Burimi i Drinit

⁷⁶ Vendimi i MMPH, 2003, cito numrin


⁷⁷ Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, 2007

Bardhë, Shpella e Gadimes, Gryka e Rugovës, Ura e fshajtë, trunget e vjetra, etj.), 2 *Parqe regionale të natyrës* (Gërmia dhe Mirusha) dhe 2 *Park Pylli* (Pishat e Deçanit dhe Rahavane).

Tabela 47. Zonat e Mbrojtura të Natyrës


Nr	Emërtimi	Nr. i zonave	Sipërfaqja /ha
1	Rezervate të natyrës	11	847
	R.N. Bimore	7	
	R.N. Shtazore	2	
	R.N. Speciale	3	
2	Park Kombëtar	1	39
3	Monument Natyre	59	4.874
	M.N. Spelologjike	4	
	M.N. Hidrologjike	10	
	M.N. Gjeomorfologjike	5	
	M.N. Botanike	36	
	M.N. Memoriale	3	
	Muzeu i kristaleve në Stantërg	1	
4	Park regional	2	1.681
5	Park Pylli	2	35
	Totali	75	46.437

Grafikoni 36. Numri i vizitave në zonat e mbrojtura janar-tetor 2006




Gjatë periudhës 2006-2007 janë marrë nën mbrojtje edhe 24 zona të reja, 11 në territorin e Komunës së Drenasit dhe 13 në territorin e Komunës së Skenderajt. Me marrjen në mbrojtje të këtyre zonave, sipërfaqja e zonave të mbrojtura është rritur 7.25 ha.

Grafikoni 35. Kronologjia e mbrojtjes së vlerave të natyrës në Kosovë



Harta 12. Harta e zonave të mbrojtura të natyrës



Menaxhimi i zonave të mbrojtura

Menaxhimi i zonave të mbrojtura të natyrës bëhet për qëllime: të kërkimeve shkencore; të mbrojtjes së llojeve të egra, habitateve dhe ekosistemeve; të ruajtjes së diversitetit gjenetik dhe të llojeve; të përkujdesjes së shërbimeve mjedisore; të mbrojtjes së veçorive specifike të trashëgimisë natyrore dhe kulturore; të turizmit dhe rekreacionit; etj

Statusi i zonave të mbrojtura të natyrës do të definohet me aktet nënligjore për në pajtim me Ligjin të cilat do të përcaktojnë shkallën e mbrojtjes dhe parimet e menaxhimit sipas secilës kategori. Për çdo zonë të mbrojtura të natyrës përcaktohet shkalla e I, II dhe III e mbrojtjes.

Akti për shpalljen e zonës së mbrojtur të natyrës do të përcaktoj qëllimet e menaxhimit dhe masat e veçanta për mbrojtjen e natyrës dhe teknikat të cilat do të aplikohen në zonën e mbrojtur të natyrës. Pas nxjerrjes së aktit për shpalljen e zonës së mbrojtur të natyrës nxirret plani i menaxhimit nga organi që e vënë nën mbrojtje dhe i cili aprovohet nga Ministria.

Menaxhimi me Parkun Nacional “Mali Sharr” bëhet nga drejtoria e Parkut e cila e ka selinë në Prizren. Parku Regional Gërmia menaxhohet nga ndërmarrja publike “Hortikultura”, ndërsa Shpella e Gadimës menaxhohet nga një organ që nuk është në mbikëqyrje të Qeverisë. Ndërsa rezervatet *Maja e Ropsit*, *Gubavci*, *Gazimestani*, *Kozhnjeri*, *Malet e Prilepit*, *Bifurkacioni i lumit Nerodime*, *Kamilja*, si dhe *Parku regional Mirusha* nuk kanë organe menaxhuese. Monumentet e tjera të natyrës menaxhohen nga autoritetet komunale përkatëse..

Ende nuk është kry procesi i harmonizimit dhe kategorizimit të zonave nga klasifikimi i mëhershëm me ligjin e ri të natyrës, kështu që shpesh hasim në emërtime të ndryshme për një zonë. Është duke u punuar regjistri qendror i zonave të mbrojtura dhe me këtë rast do të largohen nga kjo listë zonat(monumentet) që i kanë humbë vlerat për të cilat janë marrë nën mbrojtje, ose edhe nuk ekzistojnë fare. .

Zonat e mbrojtura të natyrës shpesh janë kërcënuar nga faktorë të natyrave të ndryshme. Zhvillimi veprimtarive të shumta dhe të ndryshme në natyrë siç janë: ndërtimi i vendbanimeve, zhvillimi i turizmit malorë, prerja e pyjeve, gurthyesit, etj, shpeshherë janë bërë pa një kriter të qëndrueshëm për ruajtjen e natyrës. Ky shfrytëzim i natyrës dhe i vlerave të saja ka atakuar ekosistemet dhe diversitetin biologjik në masë të konsiderueshme.

Nga kjo nuk janë kursyer as zonat e mbrojtura me vlera të veçanta të trashëgimisë natyrore si: *Parku Nacional*

Sharrit”(Ndertimi i Fshatit turistik në Prevallë), Parku Regional “Mirusha”(ndërtimi i objekteve hoteliere), Parku Gërmia (ndërtimi qendrës protokollare), Kanioni te Ura e Fshajte (ndërtimi objekteve hoteliere), Shpella e Gadimes (menaxhimi jo adekuat, thyeraje kristaleve etj)”, Bifurkacioni Nerodimes (ndërrhyrja në shtratin e lumit), etj.

Parku Nacional “Malet e Sharrit”

Parku Nacional Malet Sharrit veçohet si zonë kryesore për vlera botanike, faunistike, ekologjike, turistike, rekreative, sportive edukative dhe kulturore të Kosovës. Malet e Sharrit kanë diversitet biologjik mjaft të theksuar. 25 liqene në lartësi mbidetare mbi 1900 m. të cilët përfaqësojnë vlerat e veçanta natyrore të Masivit të Sharrit. Liqeni më i madh është Liqeni i Livadhit (2173 m.).

Nga aspekti floristik këto male hyjnë në radhën e maleve më të pasura të Kosovës dhe Gadishullit Ballkanik dhe paraqesin një thesar të specieve bimore ku janë prezent një numër i madh i llojeve bimore endemike dhe reliktesh, duke përfshirë edhe llojet bimore të rralla dhe të rrezikuara. Deri tani në këto male janë konstatuar afro 2000 lloje bimore dhe 68 bashkësi bimore. Në kuadër të vegetacionit pyjor hasim lloje të ndryshme të dushkut, ahut, bredhit, hormoqit, pishës së bardhë, pishën endemike dhe relikte të maleve të larta: rrobulli (*Pinus heildreichii*) dhe molika (*Pinus peuce*), panja endemike malore (*Acer heildreichii*), lisi i rëndomtë (*Taxus baccata*), çetinaku (*Pinus mugo*) etj.

Territori i Sharrit me biotopet e ndryshme është shumë i pasur në pikëpamje faunistike. Në të janë prezente lloje të veçanta të shtazëve, të cilat ekskluzivisht janë të lidhura për biotope specifike,që dmth.se përhapja e tyre është e ngushtë dhe i përkasin llojeve endemike. Ndërsa llojet e tjera që hasen në biotope të ndryshme janë të përhapjes së gjerë. Fauna e Sharrit dhe në përgjithësi fauna e Kosovës deri sot nuk është hulumtuar sa duhet, mirëpo në bazë të të dhënave të literaturës mund të konstatohet se fauna e Sharrit përbëhet prej: 7 lloje Peshq, 9 lloje amfibe, 10 lloje reptilë, 154 lloje shpendë dhe 30 lloje gjitarë.

Në vitin 1986 nga Kuvendi i Kosovës një pjesë e Malit Sharr është shpallë si Park kombëtar. Sipërfaqja e Parkut kombëtar përfshinë 39. 000 ha dhe dhe shtrihet në kufijtë e katër komunave: Prizren (19.500 ha), Shtërpçë (15.210 ha), Therandë (2730 ha) dhe Kaçanik (1560 ha).

Zonat e propozuara për mbrojtje

Gjatë periudhës 2000- 2006 Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) - ka bërë njohjen dhe evidentimin e vlerave të reja të natyrës në 16 Komuna edhe atë në: Gjakovë, Skenderaj, Drenas, Burim, Rahovec, Kastriot, Vushtrri, Gjiilan, Malishevë, Mitrovicë, Klinë, Podujevë, Fushe Kosove, Therandë, Lipjan dhe Viti. Gjatë këtij procesi janë evidentuar dhe janë propozuar për mbrojtje mbi 219 vlera të reja që i përkasin kategorive të ndryshme të mbrojtjes, shumica prej tyre janë monumente natyre me karakter botanik, hidrologjik, geomorfologjik etj.

Në vitin 2003 është nisur iniciativa për shpalljen në mbrojtje edhe të një parku të dytë nacional - Bjeshkët e Nemuna. Në Institutin Për Mbrojtjen e Natyrës është punuar arsyeshmëria profesionale në bashkëpunim me Departamentin Biologjisë dhe Gjeografisë nga Universiteti i Prishtinës, si dhe bashkëpunim me institucionet e tjera. Shpallja e territorit të Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional me sipërfaqe rreth 60.000 ha është në procedim e sipër, pritët miratimi i ligjit për parqe nacionale nga Kuvendi i Kosovës. Me marrjen në mbrojtje të kësaj zone dhe zonave të tjera të propozuara, sipërfaqja e zonave të mbrojtura do të rritet deri në 10 % .

Prej gjithsej 219 zonave të propozuara gjatë vitit 2006 -2007 janë marrë nën mbrojtje 24 zona të prej tyre edhe atë : 11 në territorin e Komunës së Drenasit dhe 13 në territorin e Komunës së Skenderajt. Sipërfaqja e përgjithshme e zonave të mbrojtura është rritur për 7.25 ha. Ndërsa kanë mbetur për procedim të mëtejshëm edhe 195 zona.


Në qershor të vitit 2004, Qeveria e Kosovës e ka miratuar Strategjinë e Kosovës për Mjedisin (SKM). Në mbështetje të këtij dokumenti dhe detyrimeve që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit gjatë vitit 2006 është hartuar edhe Plani i Kosovës për veprim në mjedis 2006 - 2010 (PKVM). Nga 6 projektet për biodiversitetin në kuadër të këtij plani deri më tash asnjëri prej tyre nuk ka gjetur mbështetje.

Në Kosovë gjatë vitit 2007 ka filluar projekti me titull “Monitorimi progresiv për vendet e Evropës Juglindore (“para kandidat”)” i cili ka për qëllim të monitoroj përafrimin e legjislaturës mjedisore vendore me atë të Bashkimit Evropian.

Po ashtu në implementim e sipër është edhe projekti dy vjeçar me titull “Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në Kosovë” i cili do të mbështes zhvillimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve në Parqet nacionale të Kosovës si dhe identifikimi e zonave që i plotësojnë kriteret e rrjetit Natura 2000.

Harta 13. Harta e zonave të evidentuara për mbrojtje

Harta e Zonave të Evidentuara për Mbrojtje



Sistemi Informativ Mjedisor / GIS

Emri i Hartës: Zonat e Natyrës të
Evidentuara për Mbrojtje
Burimi i të dhënave: AKMM / SIM
Projeksioni: UTM-WGS 84
Zona: 34 HY
Data: nëntor, 2007 Prishtinë
Adresa: Rr. Nazim Gaturri nr.31
info@sim.gov.net

LEGJENDA

Kufiri Komunal

Kufiri i P.N. Ejeshtët e Nënma

Hidronomument

Bionomument

Rezervat natyre

Gjeomomument

Shpellë

Parku i ketrinë

Ujëvare

Ministria e Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësior
Agjencia e Kosovës për
Mbrojtjen e Mjedisit



5. MBETURINAT

Vlerësimi i gjendjes

Mbeturinat janë lëndë komplekse dhe heterogjene të cilat krijohen gjatë aktiviteteve të përditshme të njeriut, në punë, banesë, sipërfaqe publike, shkolla, industri, dyqane dhe aktivitete të tjera. Zhvillimi i teknologjisë ka rezultuar me krijimin e llojeve të ndryshme të mallrave të paketuara dhe ambalazuara dhe me materiale të ndryshme që pas shfrytëzimit të tyre, paketimi dhe ambalazhi kalojnë në mbeturinë.

Edhe pse në Kosovë ka një numër të grumbulluesve të mbeturinave nuk mund të flasim për grumbullim apo trajtim të mirëfilltë të mbeturinave. Iniciativat për grumbullimin e llojeve të veçanta të mbeturinave me leverdi ekonomike për grumbulluesit dhe trajtuesit nuk mungojnë, por janë të pakta. Kryesisht grumbullohen lloje të ndryshme të metaleve, automjete të hedhura dhe në sasi më të vogël letra, plastika dhe qelqi.

Mungon infrastruktura e selektimit të mbeturinave, edhe pse ka pasur disa iniciativa që kanë ngelur në formë projektesh. Për trajtimin e mbeturinave të plastikës përmes riciklimit janë ndërtuar impiante në Rahovec dhe Podujevë, të cilat prej mbeturinës së ricikluar prodhojnë produkte të ndryshme. Ndërsa, riciklimi i baterive bëhet në Zvečan dhe Janjevë. Në Janjevë, gjithashtu behet edhe riciklimi i mbetjeve metalike. Një praktikë e mirë e riciklimit të mbetjeve të qelqit aplikohet në Therandë. Janë disa impiante për riveshjen e gomave të vjetra. Riciklimi i gomës dhe prodhimi i produkteve të ndryshme prej gomës së ricikluar bëhet në Vlashnje të Prizrenit. Duke u bazuar në inspektimin, monitorimin si dhe të dhënat e marra nga terreni, rezulton se në Kosovë krijohet sasi e madhe e mbeturinave, dhe administrimi i tyre nuk është në nivelin e duhur, me ç' rast shumë lëndë sekondare së bashku me mbeturina hedhen në deponi ku varrosen përgjithmonë.

Hedhja e mbeturinave në vende joadekuate është pasojë e nivelit të ulët të vetëdijes së qytetarëve. Kjo dukuri i jep pamje të shëmtuar hapësirës. Mbeturinat kundërmojnë dhe krijojnë parakushte për përhapjen e sëmundjeve dhe epidemive të ndryshme. Problem aktual është edhe mungesa e deponive për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme.

Problemet tjera në menaxhimin e mbeturinave janë edhe: Koordinimi i dobët në mes AKM-së pushtetit qendror, komunave dhe ndërmarrjeve menaxhuese të mbeturinave, zbrazëtitat ligjore, mungesa e fondeve, shkalla e ulët e vetëdijesimit, mungesa e trajtimit të mbeturinave, deponitë e egra etj.



Foto: Deponia Regjionale Prishtinë




Foto: Deponia Regjionale Gjiilan



Foto: Deponia Regjionale Kustovë - Mitrovicë

HARTA E DEPONIVE REGIONALE



Mbeturinat komunale

Sistemi i menaxhimit të mbeturinave në Kosovë nuk ofron të dhëna të plota për gjenerimin, mbledhjen, trajtimin dhe mënjanimin e mbeturinave. Rreth 90 % e popullsisë urbane mbulohet me mbledhjen e organizuar të mbeturinave edhe pse ka mungesë të pajisjeve dhe vendeve të dedikuara për hedhjen e mbeturinave. Grumbullimi i organizuar i mbeturinave në zonat rurale mbulon me pakë se 10 % të territorit.

Sasia mesatare e gjenerimit të mbeturinave në Kosovë sillet rreth 2 kg./ kokë banori në ditë.⁷⁸

Grafikoni 37. Paraqitja grafike % e llojeve të mbeturinave




Tabela 48: Llojet e mbeturinave që gjenden në Kosovë

Llojet e mbeturinave	Mesatarja ditore në kg./ banorë	Sasia vjetore Kg./ banorë	Sasia vjetore në tonelata
Mbeturinat e amvisërisë	0.277	101	232541
mbeturinat komerciale	0.250	91.25	209875
Mbeturinat medicinale	0.0024	0.876	2014.5
Mbeturinat e hirit dhe ngjyrës	0.907	331	761426.5
Mbeturinat e ndërtimit/ shkatërrimit	0.200	73	167900
Mbeturinat tjera(ambalazh)plastikë, gomë, pesticide, elektronikë, dru etj.	0.360	131.4	302220
Total	2	729	1675977

Deponitë sanitare

Sipas vlerësimeve në Kosovë prodhohen rreth 0.277 kg mbeturina shtëpiake për kokë banori në raportin ditor, por nëse shtohen edhe mbeturinat tjera jashtë ekonomisë familjare, atëherë sasia e përgjithshme sillet rreth 2 kg/ kokë banori në ditë. Gjendja e deponive sanitare në Kosovë pas luftës është përmirësuar falë donacioneve nga AER-it, COOPI, DANIDA dhe Qeveria e Kosovës, të cilët kanë mbështetur programin për rehabilitimin, mbylljen e deponive komunale, konstruktimin dhe ndërtimin e deponive të reja regjionale. Përkundër faktit se deponitë regjionale janë ndërtuar me standarde të kënaqshme, për shkak të menaxhimit jo adekuat gjendja aktuale e tyre nuk është e mirë. Parregullsitë më të shpeshta në menaxhimin e deponive janë : mos trajtimi i ujërave rrjedhëse, mos mbulimi i mbeturinave me shtresën e dheut sipas standardeve dhe probleme tjera teknike.

Foto 1. Deponia e Prishtinës



⁷⁸ Raporti për gjendjen e mbeturinave në Kosovë 2003/2004 MMPH

Tabela 49. Deponitë sanitare në Kosovë

Deponitë Sanitare:	Regjioni	Tipi i Deponisë	Sip ha.	Banorë	Periudha kohore	Donator
Prishtinë	Prishtinë, F. Kosovë, Lipjan Obiliq, Glogoc,	Regjionale	40	724.251	15	AER
Gjilan	Gjilan, Kamenicë, Viti, Ferizaj, Novobërdë	Regjionale	24	242.195	15	AER
Prizren	Prizren, Suharekë Malishevë, Rahovec Gjakova	Regjionale	24	316.728	15	AER
Podujevë	Podujevë	Komunale	5	131.300	15	AER
Mitrovicë	Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj	Regjionale	7	250.000	15	Danida
Pejë	Pejë, Deçan, Klinë, Istog	Regjionale	3.6	250.000		COOP
Sharr	Sharr	Komunale	1.2	27.000	16	AER
Ferizaj	Ferizaj, Shtime, Kaçanik, Shtërpç, Hani i Elezit	Stacion transferi		210.120		AER
Zveçan	Zveçan	Komunale			15	AER
				2.151.159		

Foto 2. Deponia e Prizrenit



Foto 3. Deponia e re e Prizrenit



79 Të dhënat nga KLMC dhe ndërmarrjet menaxhuese të deponive sanitare, tetor 2007

Foto 4. Derdhja e ujrave nga baseni i deponisë së Prishtinës



Foto 5. Mbeturina të pa mbuluar në Deponin e Gjilanit



Foto 6. Derdhja e ujërave nga deponia ne drejtim të vendbanimit

Tabela 50. Sasia e mbeturinave (në tonelata) në deponitë sanitare regionale të Kosovës-2006⁷⁹

Nr.	Deponitë Sanitare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
1	Prishtinë	3013	3412	3561	6586	6421	6239	5843	6432	7100	7514	7432	6654	70207
2	Gjilan / Ferizaj	2868.64	2850.44	3880.84	3813.52	3908.14	3411.65	3925.6	4585.47	4506.95	4240.28	3661.31	5690.47	44492.27
3	Prizren	2124.75	1906.45	2207.85	3417.95	3604.54	2525.6	2698.4	3292.4	3108.4	2886.6	2453.9	2029.2	32256.04
4	Podujevë	539.74	531.71	775.37	837.07	732.34	678.02	805.73	905.45	839.79	888.4	638.8	556.46	8728.88
6	Pejë	1543.8	1252.6	1560.9	1388.5	1613.7	1606.7	1911.4	2007.2	1954.5	1880.5	1656.7	1478.5	19855
7	Sharr	267.4	266	289.8	321	379.4	378	427	485.8	389.2	408.8	343	330.4	4286.8
8	Mitrovicë													24000
	Totali	10357.39	10219.2	12275.76	16346.92	16659.12	14838.97	15611.53	17708.32	17898.48	17818.58	16185.71	16739.07	203825.99

Tabela 51. Sasia e mbeturinave në deponitë sanitare regionale dhe komunale të Kosovës për vitin 2007 të shprehura në TON

Nr.	Deponitë Sanitare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali në TON
1	Prishtinë	3,665.45	4,273.73	5,032.07	5,017.46	5,239.63	4,854.54	4,938.13	5,264.28	5,005.82	6,256	6,413	5,703.90	61,664.35
2	Gjilan	6,542.97	5,668.02	2,959.12	4,515.92	4,359.10	3,451.13	3,915.47	4,251.47	3,858.33	4,186	3,585	3,342.09	49,940.08
3	Prizren	2,160.90	1,662.70	2,051.45	2,503.50	2,980.40	2,890	3,407	3,975	3,501	2,546	3,033	2,054.29	32,755.92
4	Podujevë	628.6	529.7	359.56	306.5	481.7	408.78	361.4	931.92	601.7	599.05	591.15	493.27	6239.33
6	Pejë	1341.5	1200.4	1371	1463.5	1574.6	1279.2	1642.9	1887.6	1628.5	1685.4	1582.7	1603.4	18,260.70
7	Sharr	322	301	343	350	427	434	560	616	420	427	410	407	4,242.00
8	Mitrovicë													28,420
9	Lypjan													5228
	Totali													206,750.38

78 Raporti për gjendjen e mbeturinave në Kosovë 2003/2004 MMPH

Paketimi dhe ambalazhimi

Përparimi i shkencës dhe teknologjisë ka rezultuar që në treg të kemi mallra të paketuara dhe ambalazuara në madhësi dhe forma të ndryshme. Pas shfrytëzimit të këtyre mallrave të gjitha paketimet dhe ambalazhet bëhen mbeturinë, me ç' rast rritet sasia e mbeturinave të krijuara. Ky lloj i mbeturinës nuk grumbullohet ose grumbullimi i saj është shumë i vogël, kështu që një sasi e madhe e lëndëve sekondare humbet nga hedhja e paketimeve dhe ambalazheve në kontejnerët e mbeturinave komunale.

Letra

Grumbullimi i letrës së vjetër dhe riciklimi i saj është i rëndësishëm për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave, ruajtjen e resurseve natyrore, kursimin e energjisë dhe zvogëlimin e shpenzimeve.

Nga letra që grumbullohet prej kompanive një sasi shumë e vogël e mbeturinës riciklohet në vend, ndërsa pjesa më e madhe eksportohet jashtë vendit, ku ndërrohet me lëndë të parë ose shitet. Sasia tjetër përfundon në deponi së bashku me mbeturinat komunale.

Metalet

Metalet e ndryshme duke i përfshirë edhe hekurishtet janë mbeturina që grumbullohen në mënyrë të organizuar, kryesisht për përfitime ekonomike. Përpunimi i këtyre mbeturinave nuk bëhet në Kosovë, por shumica eksportohet jashtë vendit. Nga riciklimi i metaleve ruhen resurset natyrore, zvogëlohet sasia e mbeturinave dhe kursehet energjia elektrike. Në Kosovë ka shumë qendra të grumbullimit të metaleve.

Qelqi

Mbeturinat nga qelqi deri më tani grumbullohen në masë të vogël, përveç shisheve të birrës së Pejës 0.5 litërshe të cilat ripërdoren nga vetë kompania. Mbeturinat e qelqit nuk ndahen në burim dhe nuk riciklohen për shkak të mungesës së tregut dhe të impianteve. Një praktikë e mirë e riciklimit të mbetjeve të qelqit aplikohet në Therandë. Grumbullimi, ripërdorimi dhe riciklimi i tyre zvogëlon shfrytëzimin e resurseve natyrore, energjinë, dhe është mundësi e mirë e hapjes së vendeve të reja të punës.

Plastika

Plastika nuk mund të zërthehet në mënyrë të natyrshme, ajo është biologjikisht e pazbërthyeshme. Periudha kohore e përdorimit të materialeve nga plastika është e shkurtër, por nga ana tjetër krijon probleme afatgjate për mjedisin. Mbeturinat nga plastika grumbullohen në sasi shumë të vogël në Kosovë.

Ambalazhi i substancave të rrezikshme

Në veprimtari të ndryshme përdoren substanca të cilat janë shumë të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Ambalazhet e këtyre substancave janë të shumta në numër, por atyre që duhet kushtuar kujdes të veçantë janë: ambalazhet e vajrave, ambalazhet e acideve dhe materieve tjera që përdoren në amvisëri, shishet dhe paketimet e ambalazheve të pesticideve të shpenzuara, ambalazhet e barnave, ambalazhet e ngjyrave dhe yndyrave, ambalazhet e freoneve etj. Në Kosovë nuk bëhet grumbullimi, klasifikimi dhe trajtimi i organizuar i këtyre ambalazheve. Këto mbeturina përzihen me mbeturinat komunale ose hedhen në vende jo të dedikuara për mbeturina.

Trajtimi i ambalazheve duhet të bëhet përmes trajtimit termik, me djegien e tyre në temperatura të larta pa mbetje të hirit ose me mbetje minimale të tij.

Mbeturinat e rrezikshme

Si rezultat i prodhimitarisë industriale, ndërprerjes së prodhimit dhe aktiviteteve të tjera hasen edhe shumë materie të rrezikshme. Në tabelën vijuese janë prezantuar të dhëna për llojet e këtyre mbeturinave, lokacionet e grumbullimit dhe sasinë e tyre deri në vitin 2006.

Ekzistojnë dy impiante për riciklimin e mbeturinave plastike: "Pista" Rahovec dhe "Plastika" Podujevë. Edhe fabrikat që prodhojnë gypa të PVC mbeturinat e krijuara i fusin në ripërdorim.

Tabela 52. Lloji i mbeturinave të rrezikshme, lokacionet e grumbullimit dhe sasia e tyre, 2006⁷⁹

Mbeturina – materie të rrezikshme	sasia/ njësia	lokacioni	komuna	shënimet u siguruan nga:
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	49045 m ³	Kosova A	Kastriot	REC/MMPH
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	186 ton	Kosova A	Kastriot	REC/MMPH
Burime radioaktive	34 njësi	Kosova A	Kastriot	REC/MMPH
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	25505 m ³	Shkitorja Trepça	Mitrovicë	DANIDA/MMPH
Hipoklorur kalciumi	6.5 ton	Shipol	Mitrovicë	MMPH/KFOR
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	6300 t + 165 fuqi	Metalurgjia	Mitrovicë	PIM/MMPH
Mbeturinat dhe substancat kimike të lëngëta	600 l	Metalurgjia	Mitrovicë	PIM/MMPH
Mbeturinat dhe substancat kimike të lëngëta	2000 l	Industria kimike	Mitrovicë	PIM/MMPH
Mbeturinat dhe substanca kimike të ngurta	10 ton	Tuneli i parë	Mitrovicë	PIM/MMPH
Burime radioaktive	3 fuqi	Tuneli i parë	Mitrovicë	PIM/TMK/MMPH
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	8500 kg	Parku Industrial	Mitrovicë	PIM/TMK/MMPH
Mbeturina dhe substanca kimike të lëngëta	42900 l	Parku Industrial	Mitrovicë	PIM/TMK/MMPH
Vajrat PCB	4 -trafo	Fabrika e plumbit	Zveçan	DANIDA/MMPH
Mbeturina të substancave kimike të ngurta	136 ton	Fabrika e plumbit	Zveçan	DANIDA/MMPH
Tretësira te ndryshme	2 ton	Metalac	Janjevë	MMPH- KFOR
Mbeturina të substancave kimike të ngurta	7.0 m ³	Metalac	Janjevë	MMPH- KFOR
Mbet. E filmave fotografik	3000 kg	IMK-Fabr.	Ferizaj	MMPH
Koka te rentgenit	3 cope	IMK-Fabr.	Ferizaj	MMPH
Mbeturina me substanca kimike të lëngtë	20 ton	Fabrika e Këmb.	Ferizaj	MMPH
Mbet. E filmave fotografik	2.5 t	Fabrika e veglave	Ferizaj	MMPH
Ngjyra tekstili, substanca kimike	9100 kg	Sharr-tex	Sharr	KFOR –TMK
Mbeturina të substancave kimike të ngurta	4370 kg	Sharr-tex	Sharr	KFOR –TMK
Vajra te përdorura	1200 l	„ Adi”	Lipjan	

79 Divizioni i mbeturinave, MMPH

MBETURINA KIMIKE TË NGURTA	22.2 TON	FABRIKA E LËKURKËPUCVE	PEJË	MMPH
Mbeturina dhe Substanca kimike të lëngtë	17340 l	Fab.autopjesëve	Pejë	KFOR/MMPH
Mbeturina dhe Substanca kimike të ngurta	200 kg	Fab.autopjesëve	Pejë	KFOR/MMPH
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	6180 kg	Fabrika e Sharteksit	Sharr	KFOR –TMK
Mbeturina dhe substanca kimike të lëngtë	3265 l	Fabrika e Sharteksit	Sharr	KFOR –TMK
Substanca kimike të ngurta	231.8 kg	Laboratori Kishnicë		KFOR –TMK
Fuqi plastike me acide	9 fuqi	Laboratori Kishnicë		KFOR –TMK
Kuti të plastikës të panjohura	9 fuqi	Laboratori Kishnicë		KFOR –TMK
Substanca shishe pa etiketë	15 copë	Laboratori Kishnicë		KFOR –TMK
Mbeturina dhe substanca kimike të ngurta	5 ton	Fabrika e tekstilit	Gjakovë	KFOR – TMK
Barna te skaduar	më shumë se 10 ton	Barnatorja qendrore	Prishtinë	
Barna te skaduar	1 ton	Shtëpia e shëndetit	Ferizaj	MMPH
Barna te skaduar	200 kg	Genti Farm (barnatore)	Objekt privat-Çagllavice	MMPH
Barna te skaduar	15 ton	Depo te Farmakosit	Prizren	MMPH
Barna te skaduar	5 ton	Shtëpia e shëndetit	Dardane	MMPH
Barna te skaduar	3 ton	Shtëpia e shëndetit	Shterpcë	MMPH
Barna te skaduar	5 ton	QMF(Shtëpia e shëndetit)	Prizren	MMPH
Barna te skaduar në forme tabletash	1236 copë	Depoja e kompanisë Agani	Prishtinë	MMPH
Barna të skaduar në formë ampulash	5269 copë	Depoja e kompanisë Agani	Prishtinë	MMPH
Barna me afat të skaduar (antibiotik)	8729 copë	Depoja e kompanisë Agani	Prishtinë	MMPH
Barna me afat të skaduar (shurupe)	4581 copë	Depoja e kompanisë Agani	Prishtinë	MMPH
Insekticide me afat të skaduar	143 cop	Depoja e kompanisë Agani	Prishtinë	MMPH
Barna të skaduar	10 ton	Depoja qendrore e barn. nga lista	Millosevë	MMPH

MBETURINA MEDICINALE	5 TON/VIT	QKMF	THERANDË	MMPH
Mbeturina medicinale	40 ton/vit	QKMF	Gjakovë	MMPH
Mbeturina medicinale	14.2 ton/vit	QKMF	Sharr	MMPH
Mbeturina medicinale	2 ton/vit	QKMF	Deçan	MMPH
Mbeturina medicinale	60 ton/vit	QKMF	Prishtinë	MMPH
Mbeturina medicinale	27 ton/vit	QKMF	Pejë	MMPH
Mbeturina medicinale	5.5 ton/vit	QKMF	Gjilan	MMPH
Mbeturina medicinale	14 ton/vit	QKMF	Vushtrri	MMPH
Mbeturina medicinale	2 ton/vit	QKMF	Burim	MMPH
Mbeturina medicinale	8 ton/vit	QKMF	Prizren	MMPH
Mbeturina medicinale	22 ton/vit	QKMF	Mitrovicë	MMPH
Mbeturina medicinale	24 ton/vit	QKMF	Viti	MMPH

Mbeturinat industriale

Shumë substanca në forma të ndryshme agregate kanë mbetur një kohë të gjatë pa u përdorur nëpër stabilimente, depo dhe reparte industriale. Me kalimin e kohës disave prej këtyre substanca kimike iu ka skaduar afati apo janë degraduar duke ndryshuar përbërjen e tyre dhe konsiderohen si substanca me rrezikshmëri të lartë.

Gomat e përdorura të automjeteve në vendin tonë importohen ose grumbullohen me qëllim të ripërpunimit përmes riveshjes së tyre, dhe disa kompani mbeturinat e mbetura nga riveshja e gomave i shfrytëzojnë për prodhimin e produkteve të ndryshme nga goma.

Tabela. 53. Sipërfaqet e deponive të mbeturinave industriale dhe sasia e tyre

Nr.	Lokacioni	Sipërfaqja e deponisë e shprehur në ha	Sasia e shprehur mili.ton
1	Djerrina ne PIM	35	1.52
2	Djerrina Zvecan (Gornje polje)	50	12
3	Djerrina Leposaviq (Bostaniste)	10	3.6
4	Djerrina Kizhnica (Badovc)	18	7.7
5	Djerina Stan terg (Zarkov potok)	10	3.6
6	Deponia e hirit dhe zgjyrës në KEK	160	42
	Totali	283	70.4

Automjetet mbeturinë

Automjetet mbeturinë janë të gjitha llojet e automjeteve motorike që dalin nga përdorimi. Grumbullimi i automjeteve të hedhura bëhet nga disa kompani private. Këto kompani, automjetet mbeturinë, i trajtojnë në dy mënyra: duke i grumbulluar si mbeturina metalike për shitje të cilat kryesisht shiten në vende të rajonit si dhe duke i demontuar për ripërdorimin e pjesëve të tyre.

Deri më tani asgjësimi përfundimtar i gomave të përdorura nuk është bërë në mënyrë të organizuar nga institucionet duke marrë parasysh kriteret për mbrojtjen e mjedisit. Asgjësimi i gomave bëhet në mënyrë spontane në shumicën e rasteve në vendbanime, duke mos respektuar asnjë kriter të mbrojtjes së mjedisit.

Gomat mbeturinë

Gomat e automjeteve nuk kategorizohen si mbeturinë e rrezikshme, por disa lloje specifike të gomës mund të kenë Aktivitete për reduktimin e rrezikut nga substanca të këtilla deri më tani janë bërë në disa ndërmarrje, kryesisht duke u mbështetur nga donacionet dhe aktivitetet e KFOR-it dhe TMK-së. Po ashtu, nga BKK bazuar në PKVM, janë ndarë mjetet për realizimin e projektit për ndërtimin e deponisë për mbeturinat dhe materiet e rrezikshme. përbërës të tretshëm dhe të rrezikshëm. Pas 40.000 km. udhëtim gomat e automjetit duhet të zëvendësohen, kështu që për një vit dalin jashtë përdorimit me dhjetëra mijëra goma automjesh.

Nga djegia e pakontrolluar e gomave lirohen substanca të rrezikshme për mjedisin si psh dioksina. Djegia e gomave të automjetit shoqërohet me shumë nxehtësi, për këtë arsye, përdoren si lëndë djegëse për prodhimin e çimentos. Nëpërmjet temperaturës prej 1000 gradë celsius që arrihet në këto furra, dyoksidi i squfurit që lirohet lidhet me çimenton dhe në këtë mënyrë ai bëhet i padëmshëm, ndërsa djegia e gomave në furra joadekuate për pjekjen e gëlqeres paraqet rrezik për mjedisin.

Mbeturinat e prodhimit

Në mbeturinat e prodhimit bëjnë pjesë: Vajrat mbeturinë, bateritë dhe akumulatorët, mbeturinat medicinale dhe infektive, mbeturinat elektrike dhe elektronike si dhe barërat me afat të skaduar.

Vajrat mbeturinë

Mbeturina mjaft problematike janë vajrat e përdorura, të cilët janë ndotësit më potencial të dheut dhe ujërave në Kosovë. Vajrat hedhen dhe derdhen në çdo vend, në rrugë, në punëtori bile edhe në oborre të shtëpive, ato ndizen në vatra të thjeshta për ngrohjen e lokaleve, punëtorive etj. Në vendin tonë vajrat e përdorura ende nuk grumbullohen dhe nuk trajtohen.

Fabrika "Silcapor" në Kaçanik e përdor vajin e përdorur për lyerjen e kallëpeve. Po ashtu, ende nuk kemi një pasqyrë reale të gjendjes së prezencës së vajrave dhe mbeturinave me përmbajtje të PCB, PCT dhe PBB, të cilat janë të njohura me rrezikshmëri shumë të madhe për shëndetin dhe mjedisin. Brenda vitit në Kosovë përafërsisht vaj mbeturinë krijohen 1.749.700 litra, duke mos llogaritur sasinë e vajit të automjeteve të KFOR-it dhe UNMIK-ut.

Bateritë e hedhura dhe të shpenzuara

Mbeturina me rrezik të lartë për mjedisin janë edhe bateritë të cilat hasen kudo në Kosovë. Ekzistojnë shumë lloje baterish të cilat konstruktohen nga materiale të ndryshme dhe të mbushura me elektrolit të llojllojshëm. Shumica e metaleve dhe elektroliteve të baterive janë të njohur me veti toksike të larta dhe kancerogjene.

Disa bateri të automjeteve grumbullohen në qendrat grumbulluese të mbeturinave metalike, mirëpo një sasi e madhe e tyre dhe llojet e tjera të baterive kryesisht hedhen pa kriter. Bateritë e konsumuara janë mbeturina që kërkojnë trajtim të veçantë.

Mënyra se si veprohet me to paraqet ndotje të vazhdueshme dhe rrezikshmëri shumë të lartë. Riciklimi i baterive të automjeteve bëhet në "Trepçë" -Zvečan

Mbeturinat medicinale dhe infektive

Mbeturinat medicinale dhe infektive janë mbeturina me rrezikshmëri të llojit të veçantë, që gjatë manipulimit apo në kontakt me to rrezikohet shëndeti i njeriut dhe mjedisi. Këto mbeturina krijohen në spitale dhe objekte tjera shëndetësore, por edhe nga ngordhja apo vrasja e qenve si dhe nga thertoret e kafshëve etj.

Edhe ky lloj i mbeturinave nuk trajtohet në mënyrë të duhur. Nga monitorimi në terren dhe të dhënat që i kemi, këto mbeturina nuk grumbullohen, nuk transportohen dhe nuk deponohen sipas normave dhe standardeve të parapara.

Në Kosovë ekzistojnë qendra të cilat posedojnë pajisje (furra) për djegien e mbeturinave spitalore. Konsiderohet se në këto pajisje (furra) bëhet djegia e 20-30% e mbeturinave të krijuar medicinale, ndërsa pjesa tjetër hedhet në kontejner të mbeturinave komunale. Për djegie të mbeturinave medicinale dhe infektuese në vendin tonë jjanë katër furra teknikisht më të avancuara të cilat gjenden në: Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë dhe Pejë. Këto furra janë të thjeshta me djegie një shkallësh.

Sipas shënimeve të spitaleve dhe shtëpive shëndetësore në tërë vendin brenda ditës krijohen rreth **5500 kg mbeturina spitalore, ndërsa gjatë tërë vitit krijohen 2.014.500 kg apo 2.014.5 ton. Kjo vlerë, kur të llogaritet për kokë banori, në raportin ditor është 0.0023 kg mbeturinë spitalore.**

Mbeturinat që krijohen nëpër spitale kanë filluar të grumbullohen në kontejner të dedikuar enkas për këto lloje të mbeturinave, por ekzistojnë raste kur grumbullimi dhe trajtimi i mbeturinës spitalore nuk bëhet si duhet, sidomos në sektorin privat i cili fare nuk është nën kontroll.

Pjesërisht, këto mbeturina trajtohen edhe duke u groposur (varrosur) në gropa nëpër deponitë e mbeturinave komunale, si psh. qentë e vrarë varrosen, ndërsa eshtrat dhe mbeturinat e tjera të thertoreve hedhen në deponi pa ndonjë trajtim të veçantë. Gjithashtu, ato hedhen edhe në vende si përroska, lumenj, male etj.

Mbeturinat elektrike dhe elektronike

Kohëve të fundit është duke u shtuar sasia e mbeturinave elektrike dhe elektronike që janë të dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Këto mbeturina krijohen nga aparatet e ndryshme shtëpiake dhe industriale të cilat tani për tani përfundojnë në deponitë e mbeturinave komunale ose në qendrat grumbulluese të metaleve.

Rreziku nga ky lloj i mbeturinave vjen nga elementet përbërës të tyre të cilat janë: lloje të plastikës, kablllo, elemente të metaleve të rënda, llamba elektronike, tretës dhe komponime të shumta kimike, qelq fluoreshent, mjete impregnuese, ngjyra, rezervuar të gazrave për ftohje etj.

Barërat me afat të skaduar

Kosova pas luftës trashëgoi një sasi të konsiderueshme të barërave me afat të skaduar të cilat ishin akumuluar me vite nëpër barnatore dhe në fabrikën e vetme për prodhimin e barërave. Po ashtu, pas lufte në Kosovë kishte një vërshim të futjes së barërave në cilësinë e ndihmave humanitare, por edhe për qëllime fitimi. Këto barna kanë hyrë pa ndonjë kontroll të cilësisë, sasisë dhe llojit të tyre, njëkohësisht edhe me afat pothuaj të skaduar.

Kryesisht, barnat gjenden nëpër magazinat e barnatoreve shtetërore dhe në magazinat e doganës, në "Farmakos-Prizren" në kompaninë „AGANI" dhe magazinën qendrore e cila është në mbikëqyrje të Ministrisë së Shëndetësisë etj.

Ekzistojnë mbi 100 ton barna me afat të skaduar të cilat duhet trajtuar (shkatërruar) me metoda dhe në mënyrë specifike. Po ashtu, sasi të konsiderueshme gjenden të magazinuara edhe në hapësirat e spitaleve të Kosovës. Janë bërë përpjekje që shkatërrimi i barnave të bëhet në vatrat e blloqeve të KEK-ut, por për kundër marrëveshjes së firmosur nga KEK-u dhe departamenti farmaceutik i MSH kjo nuk u realizua.

Vlen të theksohet se edhe barnat e papërdorura të pacientëve që shërohen në shtëpi janë një ndotje mjaft serioze.

Pesticidet me afat të skaduar dhe ambalazhet e pesticideve

Në Kosovë rregullisht hyjnë pesticide që janë të nevojshme për luftimin e sëmundjeve dhe patogjenëve në agrikulturën kosovare. Shumë prej këtyre pesticideve nuk mund të shiten apo përdoren me kohë dhe kështu u skadon afati duke u shndërruar në mbeturina të rrezikshme.

Ky problem ende nuk ka gjetur trajtim efektiv përkundër angazhimeve të sektorit për pesticide në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Divizionit për Administrimin e Mbeturinave në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor. Gjithashtu, problem të vazhdueshëm paraqet ambalazhi i pesticideve më rastin e përdorimit të tyre nga fermerët kosovarë.

MBZHR, është organizuar rreth mbledhjes dhe konfiskimit të preparateve me afat të skaduar që të mos përdoren për mbrojtjen e kulturave bujqësore, po ashtu është parandaluar shitja dhe keqpërdorimi i tyre.

Mbledhja dhe riciklimi i mbeturinave

Mbledhjen e mbeturinave në Kosovë e bëjnë ndërmarrjet publike të cilat administrojnë mbeturinat komunale. Këto kompani administrohen nga AKM-ja dhe janë përgjegjëse për grumbullimin, mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave komunale (urbane) deri në deponi.

Trajtimi i mbeturinave është problem mjaft i komplikuar dhe i shtrenjtë. Ai ndikon dukshëm në uljen e nivelit të përgjithshëm të mbeturinave. Për momentin në Kosovë nuk kemi të bëjmë me aktivitete të mëdha gjatë të cilave trajtohen mbeturinat, mirëpo ka tendenca të mirëfillta për trajtimin e mbeturinave.

Aktivitetet e ministrisë janë të fokusuar në parandalimin, grumbullimin, ndarjen, trajtimin (riciklimin, ripërdorimin, kompostimin etj) dhe deponimin e mbeturinave. Tani për tani mund të flasim për disa pika që merren me trajtimin e mbeturinave në Kosovë të cilat janë të organizuara nga iniciativat private.

Në këtë rast mund të përmendim riciklimin e plastikës në Rahovec, Mitrovicë, grumbullimin e letrës në Xërxë, Lypjan, Fushë Kosovë, Prizren, Prishtinë, shisheve të qelqit në Pejë, grumbullimi dhe riciklimi i qelqit në Therandë, metaleve të ndryshme në disa qendra të Kosovës (Prishtinë, Ferizaj, Lypjan, Mitrovicë, Gjakovë, Pejë, Janjevë, Podujevë etj.). gjithashtu, kohëve të fundit kemi iniciativë edhe për fillimin e kompostimit në disa qendra të Kosovës, ndër të cilat mund të përmendim atë në Klinë.

Transporti ndërkufitar i mbeturinave

Qarkullimi ndërkufitar i mbeturinave bëhet në përputhje me dispozita ligjore të ligjit për mbeturina si dhe të rregullores së CE 259 / 93/ EEC, Konventës së Bazelit si dhe sipas rregullave të transportit rrugor (ADR), transportit hekurudhor (RID) dhe transportit ajror.

Nga Kosova mund të eksportohen mbeturina për të cilat nuk ekzistojnë objekte për trajtimin e tyre, por gjithashtu, lejohet edhe importimi i mbeturinave jo të rrezikshme në Kosovë, vetëm atëherë kur ekzistojnë objekte dhe pajisje adekuate për trajtim dhe lejohen nga Ministria.

Burimet e rrezatimeve radioaktive

Në ndërmarrje të ndryshme prodhuese, institucione shëndetësore, shkolla, ndërtesa të banimit, deponi etj. ndodhen një mori e burimeve të rrezatimeve radioaktive të të gjitha llojeve⁸⁰ (α , β , γ dhe x). Këto burime ndodhen në:

-  Në aparate të rëntgenit dhe izotopet radioaktive që përdoren në mjekësinë diagnostikuese;
-  Në aparate që përdoren për shqyrtime në industri (radiografi etj.);
-  Izotopet radioaktive që përdoren në industri si nivel matës;
-  Burime me izotope radioaktive në rrufepritësit dhe detektorët e zjarrit;
-  Deponitë e grumbullimit të mbetjeve metalike etj.

Veç kësaj, radioizotope të ndryshme që ndodhen në mjedis (ushqim, ajër, tokë, materiale ndërtimore, infrastrukturë etj.) paraqesin shqetësim për rrezikun e mundshëm në ndikimin në shëndetin e njeriut.

Pas bombardimeve të fundit nga NATO në vitin 1999, në tërë territorin e Kosovës kanë ngelur numër i madh i mjeteve të pashpërthyer, të cilat paraqesin rrezik permanent për jetën e popullatës.

Bazuar në shqyrtimet e deritashme të disa nga llojet e burimeve të rrezatimeve radioaktive në territorin e Kosovës janë identifikuar këto lloje: Co60, Cs137,134, Sr90, Eu152,124, Am241, Ra226, Rn222, J131, Au198, Te99, Se75, H3, C14.

Për shembull: Shumë izotope radioaktive që janë përdorur në industri për qëllime të ndryshme (KEK< TREPÇË etj.) kanë ngelur jashtë kontrollit adekuat. Në ish Gazifikimin në Kastriot, kanë ngelur në një deponi për ruajtjen e burimeve këto lloje të izotopeve të Co60:

-  12 burime me aktivitet fillestar A0=3,70 GBq
-  18 burime me aktivitet fillestar A0=0,74 GBq dhe
-  4 burime me aktivitet fillestar A0=1,48 GBq.

⁸⁰ Shërbimi i Mbrojtjes nga Rrezatimi, Instituti i mjekësisë së Punës, sh.a., Kastriot
⁸¹ Measure of Radiation in Gasification plant, 2006, Raport mjedisor, KEK, 2006

Matjet e dozave të radioaktivitetit nga KFOR⁸¹ tregojnë këto vlera :

-  prapa paravanit mbrojtës të betonit: 4-104,23`
μSv/h
-  para paravanit të murit mbrojtës: 4-23,12
μSv/h
-  jashtë mureve të deponisë: 0,11-0,18
μSv/h.

Kjo fushë e rëndësishme është ende e pastudiuar në Kosovë, andaj është i domosdoshëm inicimi i një projekti gjithëpërfshirës për identifikimin e të gjitha burimeve të rrezatimit jonizues dhe jojonizues, i cili projekt do të definonte menaxhimin e këtyre burimeve që nga blerja, transporti, përdorimi, deponimi dhe parandalimi i rreziqeve që vjen nga prezenca e tyre.

⁸¹ Measure of Radiation in Gasification plant, 2006, Raport mjedisor, KEK, 2006

6. MJEDISI DHE SHËNDETI

Në jetën e njeriut ndikojnë shumë faktorë të jetës së përditshme si: mënyra e jetesës, ushqimi, kushtet e punës dhe ndotja e mjedisit. Njeriu i ekspozohet ndotjes së ajrit, ujit dhe dheut, mes tjerash edhe përmes ushqimit, mbeturinave, kemikateve dhe prodhimeve të ndryshëm që ai përdorë në punë ose në shtëpi. Ndikimi fizik i mjedisit në shëndet mund të sjell sëmundje të ndryshme si: sëmundje të zemrës, frymëmarrjes, kancer të lëkurës etj. Ndikimet e ndryshme kimike mund të sjellin çrregullime hormonale, çrregullime në rritje dhe zhvillim, kancer, alergji etj. Rëndësia e mjedisit të shëndoshë është e pazëvendësueshme për shëndetin e njeriut. Edhe pse ka të dhëna për ndikimet e mundshme të mjedisit në shëndet, megjithatë ka pak të dhëna përmes të cilave mund të argumentohet ndikimi i posaçëm i tij në shëndet. Problem i veçantë në këtë drejtim është mbledhja e të dhënave të tilla të cilat do të argumentonin këtë.

Vlerësimi i gjendjes

Kosova ka një gjendje jo të mirë të shëndetit të popullatës. Vetëm rreth 70 %, e popullatës janë të kyçur në sistemin e ujësjellësit. Rreth 65 % e popullatës rurale pinë ujë nga pusët ku shumica e tyre janë jo higjienike. Më pak se 40 % e popullatës ka qasje në rrjetin e kanalizimit dhe të ujësjellësit. Rastet e sëmundjeve ngjitëse dhe parazitare kanë shënuar rënie të ndjeshme që nga periudha e pasluftës e deri me sot. Edhe numri i personave të sëmurë nga TBC-ja është në rritje. Sëmundjet më të shpeshta kronike janë sëmundjet e sistemit kardio-vaskular.

Sëmundjet si Hepatiti A, meningjiti, diabeti dhe sëmundjet ngjitëse të zorrëve janë ende në shkallë të lartë.


Gjatësia e pritur e jetës

Derisa në shumicën e vendeve të Evropës mesatarja e moshës së popullsisë po mplaket Kosova bën një përjashtim. Popullsia e Kosovës është e re, ku një e treta i takojnë grup moshës më të ulët se 15 vjeç dhe rreth gjysma nën moshën 25 vjeç. Mesatarja e moshës është 22 deri 23 vjeç. Një tregues tjetër i nivelit të shëndetit publik është numri i vdekjeve të foshnjave të porsalindura, që është 18,9 ‰ duke qenë kështu më i larti në Evropë. Shkaqet e vdekjes së 63% të të porsalindurve janë sëmundjet infektive. Në një raport tjetër të publikuar nga UNDP (2002) shkalla e mortalitetit të porsalindurve arrin deri në 34-35 në 1000 të lindur gjallë që është shumë më e lartë se shifra prej 18 ‰. Mesatarja e pritur e jetesës në Kosovë është 68.8 vjet (67.8 për meshkuj dhe 69.9 për femra).


Cilësia e ujit të pijes

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP) rregullisht ndërmerr aktivitetet me qëllim të vendosjes së një kontrolli të shtuar mbi cilësinë e ujërave të pijshëm. Në bazë të monitorimit të burimeve të ujit të pijshëm për vitin 2006/2007 IKSHP ofron të dhënat si më poshtë: Në tab.xx. tregon se ndotja e ujërave të pijshëm është me i madh nga kontaminimi bakteriologjik me 73.6% krahasuar me kontaminimin kimik i cili është 66.0%. Kjo statistikë është nxjerr nga matjet që janë bërë në shkolla, ambulanca dhe puse(bunarë) individuale gjatë vitit 2006.

Grafikoni 38. Përqindja me e madhe e papërshtatshmërisë bakterore e ujit prej ujësjellësve të Kosovës për vitin 2007 prinë Komuna e Klinës mbi 90% çka është një indikator i keq për cilësinë e ujit të pijes. Në një situatë jo të mirë janë edhe Komuna e Malishevës me 40% dhe Mitrovica me mbi 30%.




Grafikoni 39. Tregon papërshtatshmërinë bakterore e të ujit për pije ne regionin e Prishtinës mbi 30% për muajt Janar/Mars,2007



Grafikoni 36- tregon papërshtatshmërinë bakterore të ujit për pije ne regionin e Prishtinës mbi 30% për muajt Janar/Mars,2007

Grafikoni 40.



Epidemitë (Sëmundjet ngjitëse)

Ndonëse, ka pasur një rënie të ndjeshme të numrit të rasteve të sëmundjeve ngjitëse gjatë periudhës 2005-2006, numri i rasteve vazhdon të jetë ende në shkallë të lartë. Duhet veçuar sidomos numrin e lartë të rasteve me diarre akute, pneumoni dhe tuberkuloz. Po ashtu, është shqetësues edhe numri i rasteve të evidentuara me Tularemi, Brucelozë, Ethe hemorragjike dhe Ethe ekzantemike.

Tabela 54: Numri i rasteve të sëmundjeve ngjitëse gjatë periudhës 2005-2006 (Statistikat e shëndetësisë 2006, ESK)

Sëmundjet ngjitëse	2005	2006
ITPR-Pneumonia	17.335	16.486
Diarre akute	39.604	43.231
Infektimet me parazit intestinal	369	276
Skabiesti	506	588
Varicela	5.041	4.850
Dyshimi në influencë	35.220	17.659
Sindromi meningjital	298	1.278
Sindromi i diarresë në gjak	88	117
Paraliza akute flacide (PAF)	5	2
Sindromi i etheve hemorragjike	11	5
Sindromi i etheve ekzantemike	49	49
Parotiteti epidemik	156	476
Verdhëza akute A	766	746
Verdhëza akute B	208	152
Pertussis	38	68
Tularemia	102	105
Brucelozë	41	58
Tuberkulozi (TBC)	1.102	1.122
Sëmundjet tjera ngjitëse	5.780	4.770
Gjithsejtë	102.723	92.040

Cilësia e ajrit

Burimet industriale të ndotjes në Kosovë paraqesin rrezik të madh shëndetësor si pasojë e ndotjes mjedisore të shkaktuar nga shkarkimet e plumbit, kadmiumit, zinkut, bakrit dhe substancave tjera toksike në ajër. Monitorimi i organizuar dhe i vazhdueshëm nuk kryhet. Një studim i kryer në vitin 2000 mbi nivelin e plumbit në gjak te punëtorët e shkrotores dhe te banorët e Mitrovicës dhe vendeve përreth, tregon për nivelin shumë të lartë të Plumbit në gjak, posaçërisht te punëtorët dhe fëmijët. Komunikacioni i dëndur paraqet edhe një burim tjetër serioz të ndotjes. Për shembull, në qytetin e Prishtinës ka probleme të dukshme me ndotje nga pluhuri, gjë që në qytete tjera është më pak evidente.

Sëmundjet profesionale

Në Kosovë ende nuk është vendosur sistemi vëzhgues në shëndetësi (përveç për sëmundjet infektive). Po ashtu, ka mangësi në regjistrin e sëmundjeve jo ngjitëse dhe sëmundjeve profesionale. Aktualisht në disa mjedise mungojnë shërbimet e mirëfillta shëndetësore në punë. Nuk ka zbatim apo inspektim të sigurtisë dhe mbrojtjes shëndetësore në punë. Qasja preventive nuk është zbatuar deri më tani dhe nuk kryhet regjistrimi i pacienteve përveç në Qendrën mjekësore të KEK-ut, në Obiliq dhe Gjakovë.

Realizimi i objektivave

Deri me tani në kuadër të kornizës ligjore për shëndetin publik janë miratuar këto ligje: Ligji për Inspektoratin Sanitar (2003/39), Ligji i Shëndetësisë së Kosovës (2004/31) dhe Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit (2004/42), ndërsa janë në procedure edhe Ligji i Inspektoratit Shëndetësor dhe Ligji për Zhurmën.

Mungon Plani i Veprimit për Shëndetësi dhe po ashtu, mungon sistemi për informim shëndetësor. Në përgjithësi Kosova ka nivel të ulët të edukimit në sferën e shëndetit publik e veçanërisht në viset rurale. Nuk ka të dhëna të plota për projekte dhe investime në fushën e shëndetit publik.

Tabela 55: Morbiditeti nga disa lloje të sëmundjeve gjatë periudhës 2005-2006, në QKUK dhe në Spitalet rajonale (Statistikat e shëndetësisë 2006, ESK)

Lloji i sëmundjes	2005			2006		
	QKUK	Spitalet rajonale	Gjithsejtë	QKUK	Spitalet rajonale	Gjithsejtë
Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes	3166	6962	10128	3482	26028	29510
Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut	2621	5139	7760	2548	17678	20226
Sëmundjet e lëkurës dhe sistemit nënlëkuror	481	1453	1934	341	5918	6259
Tumoret	1148	462	1610	981	1619	2600
Sëmundjet e sistemit urogjenital	989	2198	3187	897	11019	11916
Sëmundjet infektive dhe parazitare	2146	3014	5160	2538	1423	3961

III.

Çështje të përgjithshme

1. VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS

“Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis” (“VNM”) studimi për të përcaktuar pasojat që një projekt mund të shkaktojë në mjedis, është njëri ndër instrumentet kryesore për parandalimin e ndotjes dhe mbrojtjen e mjedisit. Parimet kryesore mbi VNM në Kosovë i definon Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, ndërkaq procedura e VNM-së është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ Nr. 9/2004 të nënshkruar nga Ministri i MMPH.

Nga 420 veprimtari ekonomike me ndikim në mjedis (te cilat kanë aplikuar për leje mjedisore), 390 posedojnë pëlqime mjedisore. Veprimtarit sipas aktivitetit të cilat posedojnë pëlqim mjedisor janë paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela 56. Pëlqimet Mjedisore sipas veprimtarisë

Pëlqimet Mjedisore sipas veprimtarisë					
Nr.	Veprimtaria	Pozitiv	Negativ	Të pa definuara	Gjithsejt
1	Guror	95	4	1	100
2	Seperacion	22	3	0	25
3	Zhavorë	36	4	0	40
4	Bazë asfalti	12	0	0	12
5	Betonjera	25	0	0	25
6	Farmaceutika	3	0	0	3
7	Çimentues	5	0	0	5
8	Metale	4	1	0	5
9	Fabrikë	11	0	0	11
10	Tjerat	43	0	0	43
11	Pompë	107	11	1	119
12	Rregullimi i shtratit të lumit	1	0	0	1
13	Kanalizimi	10	0	0	10
14	Ujësjiellësi	0	0	0	0
15	Ndertime	7	0	0	7
16	Hidrocentral	1	0	0	1
18	Prodhim	3	0	0	3
19	Meturina të rrezikshme	2	0	3	5
20	Qymyri	3	2	0	5
Totali		390	25	5	420

Korniza Ligjore

Kosova ka legjislacion të ri mjedisor dhe të përafërt me standardet e BE-së. Ky legjislacion mbështetet në parimet e legjislacionit evropian dhe është hartuar në bashkëpunim me ekspertët e huaj.

Megjithatë, legjislacioni mjedisor vazhdon të plotësohet dhe përmirësohet për të iu përgjigjur në mënyrë sa më efektive zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit.

Plotësim i kuadrit ligjor për mjedisin nga Qeveria është parë si instrument i rëndësishëm për zhvillimin e politikave mjedisore.

Nga MMPH, është iniciuar procedura për ridraftimin e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.2003/9 dhe Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 2006/2

Në procedurë për miratim në Parlament është: Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisë.

Gjithashtu nga grupet punuese janë në përgatitje edhe këto projektligje:

Ligji për Parqet Kombëtare, Ligji për Mbrojtjen nga Rrezatimi Jonizues dhe Siguria Nukleare, Ligji për Parandalimin e Integruar dhe Kontrollimin e Ndotjes së Mjedisit (IPPC), Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM).

Për plotësimin e kuadrit ligjor dhe lehtësimin e zbatimit të legjislacionit mjedisor janë hartuar edhe akte nënligjore, shiko tabelën në vijim..

Tabela 57. Lista e ligjeve të aprovuara në kuvendin e Kosovës 2003 - 2007, të cilat lidhen ngushtë me mjedisin⁸²

Nr	Emërtimi i Ligjit	Nr. i Ligjit
1.	Ligji për Mbrojtjen e Ambientit	2003/9
2.	Ligji për Pyjet e Kosovës	2003/6
3.	Ligji për Farërat	2003/10
4.	Ligji për Plehrat Artificiale	2003/22
5.	Ligji për Planifikimin Hapësinor	2003/30
6.	Ligji për Pesticide	2003/35
7.	Ligji për Shëndetësi	2004/31
8.	Ligji për Tregti me Naftë dhe Derivatet e saja	2005/22
9.	Ligji për Energjinë	2004/21
10.	Ligji për Ujërat	2004/41
11.	Ligji për plotë ndryshim të Ligjit 2003/3 për Pyje	2004/40
12.	Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja	2004/48
13.	Ligji për Blegtorinë e Kosovës	2004/39
14.	Ligji për Ujitjen e Tokës Bujqësore	2005/49
15.	Ligji për Kujdesin ndaj Kafshëve	2005/24
16.	Ligji për Mbrojtjen e Natyrës	2006/22
17.	Ligji për Tokat Bujqësore	2006/37
18.	Ligji për Mbeturinat	2006/31
19.	Ligji për Gjuetinë	2006/41
20.	Ligji për Minierat dhe Mineralet	
21.	Ligji për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera	2007/4
22.	Ligji për Veprimtarinë Hidrometeorologjike	2007/2
23.	Ligji për Trashëgiminë Kulturore	2006/52
24.	Ligji për Hulumtime Gjeologjike	
25.	Ligji për Peshkatari dhe Akuakulturë	2006/58
26.	Ligji për Mbrojtjen e Bimëve	2007/6
27.	Ligji për Mbrojtjen e Varieteteve të Bimëve	
28.	Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma	
29.	Ligji për Kimikate	2008/8
30.	Ligji për Bujqësi Organike	
31.	Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik	
32.	Ligji për Transport Rrugor	

Tabela 58. Ligjet

EMRI I AKTEVE NËNLIGJORE	NR. DHE KOHA E NËNSHKRIMIT	FAZA KU NDODHET AKTI
LIGJI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT		
Për themelimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit	Nr.02/2004-MMPH, datë 18.02.2004	Është nënshkruar nga Kryeministri
Për organizimin e agjencisë së Kosovës për mbrojtjen e mjedisit	Nr.22/03-MMPH	Është nënshkruar nga Ministri
Për dhënien e lejes ekologjike	Nr.26/05-MMPH , datë 07.11.2005	Është nënshkruar nga Ministri
Për licencimin e personave dhe ndërmarrjeve për hartimin e raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis	Nr.03/2004-MMPH	Është nënshkruar nga Kryeministri
Për vlerësimin e ndikimit në mjedis	Nr.09/2004-MMPH	Është nënshkruar nga Kryeministri
Për kadastrën e emisioneve të ndotësve në mjedis Formularët dhe Udhëzimet për plotësimin e formularëve	Nr.2004/09-MMPH, datë 03.08.2005	Është nënshkruar nga Ministri
LIGJI PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA		
Mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes	Nr.06/2007 23.05.2007	Është nënshkruar nga Kryeministri
Udhëzimi Administrativ - për normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga burimet e lëvizshme		Në zyrën ligjore
Udhëzimi Administrativ - vlerat kufitare – normat e cilësisë së ajrit		Në zyrën ligjore
Udhëzimi Administrativ - për cilësinë e derivateve të naftës		Është kryer nga MTI-a.
Udhëzimi Administrativ - për materiet që e dëmtojnë mbështjellësin e ozonit		Në proces të hartimit të draftit
Për kriteret për përcaktimin e pikave monitoruese numrin dhe shpejtësinë e matjeve, metodologjinë e punës, formën dhe kohën e raportimit të të dhënave.		Në proces të hartimit të draftit
LIGJI PËR MBETURINA		
Për administrimin e vajrave të përdorura mbeturinë	Nr.03/07-MMPH , 20 janar 2006	Është nënshkruar nga Ministri
Për administrimin e automjeteve të hedhura dhe mbeturinat e tyre	20 dhjetor 2006	Është nënshkruar nga Ministri
Për mbeturina nga bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar	Nr.02/07-MMPH , 20 dhjetor 2006	Është nënshkruar nga Ministri
Për mbeturinat nga konstruktimi dhe demolimi	Nr.05/07-MMPH , 20 dhjetor 2006	Është nënshkruar nga Ministri
Për bifenileve dhe trefenileve të polikloruara.		Duke pritur nënshkrimin e Ministrit
Për asgjësimin e mbeturinave nga produktet medicinale		Duke pritur procedimin në zyrën ligjor të Qeverisë
Për mbeturina medicinale		Duke pritur procedimin në zyrën ligjor të Qeverisë
Për administrimin e deponive		Duke pritur procedimin në zyrën

Për mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike		Në grupin punues të MMPH zyra Ligjore-Draftuar
Për mbeturinat e rrezikshme		Shqyrtimi në Gr.Punues të MMPH Zyra Ligjore-Draftuar
Për licencimin e administrimit të mbeturinave		Në proces të hartimit të draftit
Kushtet për caktimin e lokacionit dhe ndërtimin e deponive		Duke pritur procedimin në zyrën ligjore të Qeverisë
LIGJI PËR MBROJTJEN E NATYRËS		
Për formën dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit qendror të zonave të mbrojtura të natyrës.	Nr. 04 / 2006 MMPH Shtator	Është nënshkruar nga Ministri.
Për kriteret dhe procedurat për shfrytëzimin e shpellave.		Në procedurë për shqyrtim në nivel ndërministror.
Për mënyrën e shënimit të zonave të mbrojtura të natyrës	Nr. 01/07 25.01.2007	Është nënshkruar nga Ministri.
Për planet e menaxhimit të zonave të mbrojtura të natyrës.	Nr 11/07 02/11/2007	Është nënshkruar nga Ministri.

Përafrimi i legjislaturës mjedisore të Kosovës me atë të Bashkimit Evropian

Politika e përgjithshme kombëtare e Kosovës përfshinë edhe procesin e integrimi evropiane. Ndër sfidat kryesore në këtë proces është edhe mjedisi, plotësimi i standardeve mjedisore evropiane dhe përafrimi i legjislaturës kombëtare mjedisore

Me atë evropiane. Në periudhën 2006 - 2007, Komisioni Evropian ka monitoruar progresin e harmonizimit të legjislaturës mjedisore të Kosovës me atë të EU dhe zbatimin e saj.

Tabela 59. Rezultatet e monitorimit të progresit të harmonizimit të legjislaturës mjedisore me atë të EU-së

Fusha	Direktiva e EU	Niveli i harmonizimit (%)
Legjislatura horizontale	Direktiva për VNM (85/337/EEC)	86
	Direktiva për VSM (2001/42/EC)	19
	Direktiva për informimin mjedisor (2003/4/EC)	32
	Direktiva për pjesëmarrjen e publikut (2003/35/EC)	30
Kualiteti i Ajrit	Direktiva kornizë për kualitetin e ajrit ambiental (96/62/EC)	59
	Direktiva për vlerat kufitare të SO ₂ , NO ₂ , NO _x , grimcave pezull (particulate matter) dhe plumbit në ajrin ambiental (99/30/EC)	41
	Direktiva për Benzenin dhe Monoksidin e Karbonit (2000/69EC)	41
	Direktiva për Ozonin (2002/3/EC)	52
	Direktiva për Arsenin, Kadmiumin, Merkurin, Nikelin, dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin ambiental (2004/107/EC)	20
Menaxhimi i mbeturinave	Direktiva për mbeturinat (2006/12/EC)	91
	Direktiva për mbeturinat e rrezikshme (91/689/EC)	47
	Direktiva për ambalazhet mbeturinë (94/62/EC)	55
	Direktiva për deponitë (99/31/EC)	58
	Direktiva për incinerimin e mbeturinave (2000/76/EC)	43
Kualiteti i ujit	Direktiva kornizë për ujërat (2000/60/EC)	25
	Direktiva për ujërat e ndotura urbane (91/271/EEC)	15
	Direktiva për ujin e pijes (98/83/EC)	35
	Direktiva për nitratet (91/676/EEC)	16
Mbrojtja e Natyrës	Direktiva për zogjtë e egër (79/409/EEC)	64
	Direktiva për habitatet (92/43/EC)	75
Kontrolli i ndotjes industriale	Direktiva për Controllin e integruar të ndotjes (96/61/EC)	18
	Direktiva për impiantet me djegie të mëdha (2001/80/EC)	36
Kimikatet	Direktiva për substancat e rrezikshme (67/548/EEC)	53

Investimet në Mjedis

Prej vitit 1999, deri në muajin dhjetor të 2007, për qeshtjet mjedisore në Kosovë, përfshirë: Investime kapitale (ndërtime), mirëmbajtje, trajnime dhe çështje të tjera, ka pasur dy lloje të investimeve:

1. Investime nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës / MMPH dhe
2. Donacione (UNEP, GTZ, BGS, AER, WB, KfW dhe Zyra Zvicrrane)

Nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, përkatësisht Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Mjedis janë investuar gjithsejtë 1031699.00€, ndërsa nga donatorët janë bere investime në fusha të ndryshme mjedisore gjithsejtë.

Tabela 60. Investimet nga donatorët në çështjet e Mjedisit.

1999 / 2008	Shuma në milion
Donatori	Total €
UNEP	0.001
GTZ	0.000
BGS	0.001
AER	95.450
WB	10.500
KfW 2000-2006	32.850
ZZ	29.290
Gjithsejt	168.09

Sqarimi

BGS	:	British Geological Survey
UNEP	:	United Nations Environment Programme
GTZ	:	German Organization for Development
AER	:	Agjensioni European për Rindërtim
WB	:	World Bank
KfW	:	Banka Zhvillimore Gjermane
ZZ	:	Zyra Zvicrrane

Programet edukative mësimore në lëmin e mbrojtjes së mjedisit

Edukimi mjedisor nuk është thjesht vetëm një nga të drejtat e njeriut, por është edhe parakusht për një zhvillim të qëndrueshëm të një shoqërie. Është mjeti kryesor për përdorim të mirë të burimeve natyrore. Edukimi mjedisor është një proces i përhershëm dhe i vazhdueshëm që fillon nga fëmijëria e hershme e deri në edukimin e brezave të rritur. Fatkeqësisht edukimi mjedisor tek ne ende nuk ka arritur nivelin e kënaqshëm dhe ende konsiderohet dytësor në procesin edukativo-arsimor.

Planet dhe programet e edukimit dhe arsimimit në nivele të ndryshme të shkollimit nuk përfshijnë në masë të duhur përmbajtjen mjedisore të bazuar në zhvillimin e qëndrueshëm.

Në kuadër të plan programeve mësimore për shkollat fillore koncepti për edukatën mjedisore transmetohet përmes lëndëve tjera mësimore sikur janë: Natyra dhe Shoqëria, Edukata Qytetare, Biologjia, Kimia, Gjeografia etj. Viteve të fundit në plan programet e ciklit të lartë të shumicës së shkollave fillore dhe në shkollat mesme, është përfshirë lënda Mbrojtje e Mjedisit si lëndë zgjedhore. Megjithatë, edukimi mjedisor në arsimin fillor është i mangët dhe i pamjaftueshëm.

Në një numër të vogël të shkollave të mesme dhe fillore ekzistojnë grupe të organizuara mjedisore që merren me aktivitete të ndryshme nga lëmi i mbrojtjes së mjedisit.

Si aktivitete në lëmin e edukimit mjedisore që MMPH së bashku me MASHT-in ka organizuar nëpër shkolla fillore janë: mbajtja e orëve edukative mjedisore, organizimi i seminareve mjedisore me arsimtarë, organizimi i fushatave mjedisore ndërgjegjësuëse, ekspozitave me përmbajtje mjedisore dhe aktivitete tjera.

Në plan programet e studimeve bazë dhe studimeve posdiplomike të Fakulteteve të Universitetit Publik të Prishtinës që nga viti 1999 e deri me sot, është shtuar dukshëm numri i programeve studimore në lëmin e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të tij si në përfshirjen e lëndës së mbrojtjes së mjedisit në kuadër të drejtimeve të caktuara, ashtu edhe me hapjen e drejtimeve të posaçme për mbrojtjen e mjedisit. Plan programe në lëmin e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të tij në studime bazë janë përfshirë në kuadër të Departamentit të Biologjisë të FSHMN-së, ndërsa në kuadër të studimeve të magistraturës plan programe të drejtimeve mjedisore janë hapur në kuadër të Departamentit të Gjeografisë, Kimisë dhe Biologjisë të FSHMN-së dhe në Fakultetin Xehetar-Metalurgjik. Lënda e mbrojtjes së mjedisit si lëndë

Departamenteve të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore është e përfshirë edhe në shumicën e plan programeve të drejtimeve të Fakultetit Teknik, kurse lënda e Zhvillimit të Qëndrueshëm është përfshirë në kuadër të disa drejtimeve të Fakultetit Ekonomik. (ëëë.uni-pr.edu, Pasqyra 2005-2006)

Për dallim nga Universiteti publik, në Universitetet private, përveç në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, ku është përfshirë drejtimi për Energji dhe Ambient dhe Universitetin Riinvest, ku është përfshirë drejtimi Menaxhimi i Burimeve dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm, në Universitetet tjera nuk ka drejtime të mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të tij. Në disa prej këtyre universiteteve ka vetëm lëndë zgjedhore nga lëmi i mbrojtjes së mjedisit.

Një hap i rëndësishëm në kuadër të përfshirjes së plan programeve mësimore dhe ngritjes së cilësisë së studimeve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit janë edhe dy memorandume bashkëpunimi: Memorandumi i bashkëpunimit në mes MMPH-së dhe FSHMN-së i cili ka për qëllim të promovojë përpjekje të përbashkëta të këtyre dy institucioneve në mbrojtjen dhe avancimin e çështjeve mjedisore, si dhe përkundër kësaj, niveli i përfshirjes së mbrojtjes dhe menaxhimit të mjedisit në plan programet e studimeve bazë dhe studimeve posdiplomike dhe kualiteti i këtyre plan programeve ende nuk i kënaq nevojat dhe kërkesat që dalin përballë problemeve të mëdha mjedisore që ka Kosova.

Informimi dhe Pjesëmarrja e Publikut

Informimi dhe pjesëmarrja e publikut nga MMPH shihen si përparësi të politikës për mbrojtjen e mjedisit. Angazhimet e saj në këtë periudhë janë realizuar në kuadër të kërkesave që shtron Konventa e Aarhusit si dokumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar për garantimin e pjesëmarrjes aktive të publikut në mbrojtje të mjedisit. Këto kërkesa janë paraparë edhe në nenin 5 të pikës (1) dhe (m) të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit 2003/9.

Informimi dhe pjesëmarrja e publikut janë të domosdoshme për zgjidhjen e problemeve mjedisore. Publiku është një burim informacioni për gjendjen e mjedisit, ai luan një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e këtyre problemeve duke ndikuar në autoritet vendore për zbatimin e rregullave për përmirësimin e cilësisë së mjedisit.

Publiku nëpërmjet komisioneve të ndryshme dërgon të institucioni mendimin e tij rreth përcaktimit të përparësive, duke kontribuar kështu në veprimet që do

të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes së mjedisit. Po ashtu, pjesëmarrja e publikut u jep qytetarëve informacion të saktë dhe të plotë për problemin mjedisor që ekziston në zonën e tyre.

MMPH është transparent për publikun, përcjell dhe shqyrton ankesat për problemet mjedisore. Aplikon forma të ndryshme të bashkëpunimit si bashkëpjesëmarrje në hartimin legjislativ (strategjisë, planit të veprimit, ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me mjedisin), bashkëpjesëmarrje në projektimin dhe zbatimin e fushatave mjedisore që organizohen me rastin e shënimit të festave të ndryshme mjedisore. Vlen të përmendet fushata “Kosova Shtëpia ime” etj. Gjithashtu ofron seminare, tryeza të rrumbullakëta dhe takime të tjera për problemet mjedisore.

Informimi i publikut kryesisht është realizuar përmes dhënies së informacionit për mediat elektronike e të shkruara, në lidhje me veprimtarinë e MMPH-së, me kremtimin e ditëve të shënuara mjedisore, si dhe me ecurinë e projekteve të ndryshme për mjedisin. Po ashtu, është përgatitur një numër i konsiderueshëm pllakate e fletëpalosjesh ndërgjegjësuere për mjedisin, të cilat janë shpërndarë nëpër një numër të konsiderueshëm organizatash joqeveritar, në disa shkolla fillore dhe te mesme si dhe në publik të gjerë në disa qytete të Kosovës etj.

Organizatave Joqeveritare Mjedisore

Historiku i lëvizjes së mirëfilltë mjedisore i ka rrënjët e veta që para luftës kur është formuar Lëvizja e të Gjelbërve të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe kohore janë organizuar edhe disa aktivitete të vogla e sporadike të Grupit të Ekologëve të Rinj të Kosovës. Mirëpo, për një zhvillim të mirëfilltë të shoqërisë civile mjedisore mund të flitet vetëm pas vitin 1999, kur fillon edhe themelimi i OJQ-ve të para mjedisore. Fluksi më i madh i formimit të OJQ-ve mjedisore është shënuar gjatë viteve 2000-2002, ndërsa pas kësaj periudhe ka pasur një rënie të numrit të OJQ-ve, si rrjedhojë e rënies së burimeve të financimit të OJQ-ve.

Zhvillim i rëndësishëm në fushën e zhvillimit të shoqërisë civile mund të konsiderohet formimi i rrjetit të OJQ-ve mjedisore Sharri Net⁸³ në vitin 2002. Një hap tjetër i fuqizimit të OJQ-ve mjedisore është formimi i koalicionit të parë të OJQ-ve mjedisore “Koalicioni për Aarhusin”, që dha një kontribut të çmuar për përfshirjen e parimeve të Konventës së Aarhusit në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit 2003/9.

⁸³ www.sharri.net

⁸⁴ NGO Directory of South Eastern Europe Kosovo chapter, REC, 2006

Burim kryesor i financimit për OJQ-t mjedisore janë grantet direkt nga organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Prej këtyre donatorëve duhet veçuar: Agjencia Evropiane për Rindërtim, SIDA, Qeveria Holandeze, UNEP etj. Viteve të fundit listës së donatorëve për OJQ-t mjedisore i janë shtuar edhe Banka Botërore, Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur, etj. Grantet për projekte mjedisore menaxhohen kryesisht nga ana e REC, Zyra në Kosovë. Shumica absolute e graveve deri me tani ka qenë prej 2,500-10,000 EUR, por ka pasur raste të graveve edhe deri 25,000 EUR.

Nuk ka ndonjë burim të drejtpërdrejtë financimi nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, por ka raste kur MMPH ka mbështetur OJQ-të përmes bashkëpunimit në projektet e ndryshme mjedisore.

Sipas vlerësimeve të fundit të bëra në vitin 2006⁸⁴, në Kosovë janë aktive 30 OJQ mjedisore të regjistruara, që është dyfishi i numrit në krahasim me regjistrimin e parë të vitit 2001. Numri më i madh i OJQ-ve aktive mjedisore janë në Prishtinë (6), Pejë (5) dhe në Mitrovicë (3) etj. Sipas të dhënave të këtij hulumtimi në gjysmën e komunave të Kosovës nuk ka OJQ mjedisore të regjistruara.

Në kuadër të këtyre OJQ-ve ka rreth 956 të punësuar në krahasim me 326 sa kishte në vitin 2001. Derisa numri i anëtarëve të OJQ-ve ka pësuar një rënie, numri i vullnetarëve të angazhuar në OJQ-të mjedisore ka pasur ngritje, që mund të jetë rezultat i definimit më të kujdesshëm të rolit të anëtarësisë në këto organizata. Nëse i referohemi buxhetit që operohet nga OJQ-t mjedisore, Kosova radhitet ndër vendet me buxhetin total vjetor më të ulët në rajonin e Evropës Juglindore (EUR 382,500).

Në fushat e aktiviteteve me prioritet të OJQ-ve mjedisore radhiten: edukimi mjedisor, mbrojtja e natyrës, zhvillimi i qëndrueshëm, menaxhimi i mbeturinave, ekoturizimi, problemet e shfrytëzimit të ujit etj. Ndërkaq, aktivitetet më të shumta të zhvilluara në projektet mjedisore të OJQ-ve janë: fushatat për ngritjen e vetëdijes për mjedisin, edukimi dhe shpërndarja e informatave për mjedisin. Nuk vërehet ndonjë aktivitet i OJQ-ve të shoqërisë civile në fushën e ndryshimeve klimatike që aktualisht konsiderohet si problemi më serioz i njerëzimit në nivelin global. Shumica e OJQ-ve ballafaqohen me probleme dhe vështirësi të ngjashme siç janë: mungesa e fondeve për mjedisin, stafi i vogël dhe jo i specializuar, mungesa e kushteve dhe pajisjeve për veprim, profilizimi jo i qartë etj.

Ndërsa nga analiza e nevojave të OJQ-ve duhet veçuar nevojën për trajnime në organizimin dhe qëndrueshmërinë e Organizatave Joqeveritare Mjedisore dhe rritjen e mundësive për resurse në zhvillimin e projekteve mjedisore.

Institucionet Mjedisore në Kosovë

Hapat e parë të mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit në Kosovë fillojnë në fund të viteve të 60, ndonëse iniciativa për mbrojtjen ligjore të vlerave të natyrës ka pasur edhe më herët. Në vitin 1968 formohet njësia për mbrojtjen e natyrës në kuadër të Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Kosovës.

Me vendimin mbi ndarjen e Seksioni për Mbrojtjen⁸⁵ e Natyrës nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, u themelua Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe vazhdoi punën me të njëjtin emër, sipas Ligjit mbi Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.⁸⁶ Ndërsa në vitin 1988 Kuvendi i Kosovës nxjerr ligjin për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Vlerave Natyrore dhe të Vlerave të Krijuara me Punë të Ambientit të Njeriut⁸⁷ ku në nenin 78 paragrafi 2 të këtij Ligji është përcaktuar veprimtaria e Entit . Në bazë të këtij Ligji një vit më vonë Kuvendi i Kosovës nxjerr Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit.⁸⁸ Pas luftës, me krijimin e rrethanave të reja të qeverisjes në Kosovë, në bazë të Rregullores 1999/1 "i gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv i vihet UNMIK-ut". Në vitin 2000 ish Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit regjistrohet në Administratën e Përkohshme Civile të OKB-së me emërtimin " Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës" me seli në Prishtinë.⁸⁹ Në maj të vitit 2000 themelohet Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit⁹⁰, dhe në kuadër të tij, inkorporohen dhe veprojnë edhe institucionet ekzistuese: Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës,⁹¹ dhe Drejtoria e Parkut Kombëtar "Malet e Sharrit".

Pas zgjedhjeve të para të përgjithshme të njohura ndërkombëtarisht, të vitit 2001, ngritën institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, që janë:

Kuvendi i Kosovës si organi më i lartë ligjvënës në Kosovë, i përbërë nga 120 deputetë. Në kuadër të Kuvendit ngritët Komisioni funksional për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor i përbërë fillimisht nga 11 anëtarë, i cili në vitin 2005 fuzionohet me komisionin tjetër për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural me 15 anëtarë.

Qeveria e Kosovës e përbërë nga 14 ministri⁹² në kuadër të të cilës është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ndër të tjera është përgjegjëse që "të krijojë politikën, të zbatojë ligjet dhe të mbikëqyr aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë edhe resurset e ujit, ajrin, tokën, bioiversitetin". Po ashtu, MMPH-ja në fushëveprimtarinë e saj vendos norma dhe standarde si dhe mbikëqyr implementimin e tyre, monitoron dhe konstaton gjendjen e mjedisit, menaxhon shfrytëzimin e infrastrukturës, promovon fushatat për edukim mjedisor, por edhe vetëdijesimin e popullatë për mjedisin, si dhe promovimin e sjelljes së teknologjive të pastra.

Ministritë tjera me të cilat lidhet drejtpërdrejt puna e ministrisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit janë:

- ✎ Ministria e Shëndetësisë ndikimi i ndotjes në shëndetin e popullatës;
- ✎ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ndotja industriale;
- ✎ Ministria e Ekonomisë dhe Financave- implikimet financiare në zvogëlimin e ndotjes;
- ✎ Ministria e Shërbimeve Publike-shërbimet komunale
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural pylltaria, bujqësia, ujitja
- ✎ Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit vlerësimi i ndotjes nga burimet e lëvizshme.
- ✎ Ministria e Energjisë dhe Minierave kufizimi i ndotjeve nga KEK-u dhe pikat e karburantit.

⁸⁵ Vendimi për ndarjen e seksionit për mbrojtjen e natyrës ("GZK"42/72)

⁸⁶ Ligji për themelimin e Entit Krahinor për Mbrojtjen e Natyrës ("GZK" 15/81)

⁸⁷ Ligji për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore të krijuara me punë të ambientit të njeriut ("GZK"39/88)

⁸⁸ Ligji për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit ("GTZ" nr.38/89)

⁸⁹ Nr i regjistrimit të përkohshëm të subjektit afarist 80156359, data 14.08.00 me emërtim "Instituti për Mbrojtjen e natyrës dhe Ambientit të Kosovës "

⁹⁰ Rregull.2000/32 për themelimin e Departamentit Administrativ për Mbrojtjen e Ambientit përgjegjës për udhëheqjen e përgjithshme të çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit në Kosovë , si dhe zbaton urdhërat e politikës në fushën e mjedisit në Kosovë.

⁹¹ Ligji për veprimtarinë hidrometeorologjike në Kosovë.

⁹² Rreg.2001/19 mbi Degën e Ekzekutiv të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë , me ndryshimet me Rreg. 2002/5 mbi ndarjen e Ministrisë dhe Planifikimit Hapësinor .

Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit

AKMM-ja është themeluar në vitin 2003, pas miratimit të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit nga Kuvendi i Kosovës. Në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit 2003/9, në kuadër të Agjencisë përfshihen: Instituti i Mbrojtjes së Natyrës së Kosovës (MNK) dhe Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK).⁹³

Detyrat e Agjencisë (neni 39, pika 2 dhe 3), përkushtohet në monitorimin e gjithmbarshëm të mjedisit e në bazë të saj informimin e publikut dhe institucioneve vendore, por edhe ndërkombëtare për gjendjen e mjedisit në Kosovë, si dhe projekte kërkimore e shkencore nga fusha e mjedisit.

Inspektorati mjedisor

Inspektorati mjedisor është institucioni që përkujdeset për zbatimin e plotë të legjislacionit të miratuar mjedisor. Funksionon në kuadër të MMPH-së dhe punën e kryen kryesisht në terren.

Institucionet e UNMIK-ut

Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit⁹⁴ Po ashtu, lidhshmëria e punës së Ministrisë ekziston edhe me Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit (AKM), kryesisht sa i përket kompanive publike, kur janë në pyetje resurset natyrore dhe shfrytëzimi i tyre.

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ëase and ëater Regulatory Office ëëRO) funksionon në kuadër të Shtyllës së IV-të të UNMIK-ut.

Niveli lokal i qeverisjes

Zyrtarët komunalë u përgjigjen strukturave komunale, kurse me nivelin qendror kontaktojnë përmes koordinatoreve rajonale të Ministrisë në 5 qendrat rajonale. Vetëm një komunë në Kosovë ka drejtori të posaçme për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në 25 të tjera janë sektorët e mjedisit në kuadër të drejtorive të ndryshme, kurse në një komunë ky sektor nuk figuron në asnjë drejtori komunale. Vetëm një komunë ka rregullore të posaçme komunale për mjedisin, në 15 komuna ai trajtohet nëpërmes rregulloreve të tjera, ndërsa në 11 nuk ka rregullore të tilla.⁹⁵

Institucionet Profesionale - Institucionet tjera ekzistuese puna e të cilave lidhet ngushtë me mbrojtjen mjedisit janë:

Instituti i Shëndetit Publik të Kosovës - që ka të bëjë me shëndetin e popullatës e para së gjithash monitorimin e cilësisë të ujit për pije.⁹⁶

Instituti INKOS i KEKut, - në kuadër të të cilit vepron Enti për Mbrojtjen e Mjedisit, përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit në KEK.

⁹³ Me Ligjin për hidrometeorologji të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, IHMK ka dalë jashtë strukturës së AKMM-së

⁹⁴ Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit

⁹⁵ Pytësor mbi Situatin mjedisore në komunat e Kosovës, MMPH 2002

⁹⁶ UNMIK / JIAS IA 2/99 mbi testimin dhe zbatimin e standardeve minimale për kualitetin e ujit të pijshëm në Kosovë.

2. REKOMANDIME

Aspektet Socio Ekonomike

-  Ndërtimi i politikave mbi shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore;
-  Finalizimi i planit hapësinor kombëtar;
-  Hartimi i planeve rregullative dhe planeve urbanistike;
-  Ndalimi i ndërtimeve ilegale;
-  Zhvillimi i infrastrukturës duke respektuar trendët e lëvizjes së popullatës;
- Ruajtja e sipërfaqeve tokësore.

Energjetika

-  Promovimi i shfrytëzimit të burimeve të ripërtitshme për prodhimin e energjisë elektrike;
-  Promovimi dhe fuqizimi i efciences energjetike;
-  Evitimi i humbjeve të energjisë elektrike;
-  Respektimi i kriterëve dhe standardet mjedisore në procesin e ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike;
-  Hartimi i programeve për reduktim të ndotjes;
-  Respektimi i parimit mbi përdorimin e “teknologjisë më të mirë në disponim”;
-  Inspektimi dhe identifikimi i problemeve mjedisore të kapaciteteve ekzistuese prodhuese të energjisë elektrike;
-  Përmirësimi i monitorimit të emisioneve në mjedis nga kapacitetet prodhuese energjetike ekzistuese.

Industria

-  Kontrolli i plotë i procesit të lejdhënies mjedisore;
-  Implementimi i IPPC;
-  Inspektimi, kontrolli dhe ndalimi i aktiviteteve që funksionojnë pa leje mjedisore;
-  Kontrolli dhe parandalimi i dëmeve në mjedis që shkaktohen nga gurëthyesit dhe rehabilitimi i zonave;
-  Promovimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore;
-  Ngritja e sistemeve të monitorimit për industrinë e caktuara;
-  Aplikimi i teknologjive të pastra;
-  Instalimi i impianteve për trajtimin e ujërave që shkarkohen nga aktivitetet industriale.

Bujqësia

-  Ruajtja e tokave bujqësore;
-  Promovimi i bujqësisë organike;
-  Promovimi i prodhimeve ekologjike;
-  Kontrolli i cilësisë së produkteve;
-  Ngritja e sistemeve të kontrollit dhe monitorimit të përdorimit të pesticideve;
-  Ngritja e sistemeve të kontrollit dhe monitorimit të përdorimit të plehrave.

Pylltaria

-  Ndalimi i shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve pyjore;
-  Ndalimi i prerjeve ilegale;
-  Gjetja e alternativave për përdorim të lëndës së parë për ngrohje dhe evitimi i përdorimit të drurit;
-  Promovimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të pasurive pyjore;
-  Marrja e masave për mbrojtje nga zjarret;
-  Pyllëzimet.

Transporti

-  Hartimi i strategjisë për zvogëlimin e ndotjes nga komunikacioni;
-  Përmirësimi i infrastrukturës rrugore;
-  Ndërtimi i rrugëve transit dhe shmangia nga vendbanimet urbane;
-  Promovimi i transportit publik alternativ (tramvaj, tren etj.).

Kimikatet

-  Përgatitja e Strategjisë për menaxhimin e kimikateve;
-  Fuqizimi i bazës ligjore, procedurave dhe udhëzimeve për menaxhimin e kimikateve;
-  Ngritja e sistemit për menaxhimin e kimikateve;
-  Ngritja e sistemi për regjistrimin, vlerësimin dhe autorizimin e kimikateve;
-  Ngritja e procedurave për mbikëqyrjen e transportit ndërkufitar të kimikateve dhe për shkëmbim të të dhënave;
-  Ngritja e programeve për monitorimin e ndotësve të qëndrueshëm organik (POPs).

Ajri

-  Përgatitja dhe zbatimi i programeve siç parashihi në ligjin për mbrojtjen e ajrit;
-  Instalimin e rrjetit të integruar të monitorimit të ajrit;
-  Zbatimi i monitorimit të emisioneve në ajër nga burimet statike;
-  Zbatimi i mekanizmave të avancuar për përcjelljen e gjendjes së ajrit;
-  Zbatimi i modeleve të avancuara softuerike për vlerësimin e gjendjes së ajrit;
-  Kontrolli dhe ndërmarrja e masave lidhur me tejkalimet e vlerave kufitare të emisioneve;
-  Përgatitja dhe zbatimi i programeve lidhur me ndryshimet klimatike, gazrat serrë dhe prekursorët e dëmtimit të shtresës së ozonit;

Ujërat

- Promovimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve ujore;
-  Evitimi i humbjeve teknike të ujit;
-  Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza;
-  Përfshirja e popullatës në sisteme të organizuara të ujësjellësve;
- Përfshirja e popullatës në sisteme të organizuara të kanalizimeve;
-  Përforsimi i rrjetit të monitorimit të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor;
-  Përforsimi i rrjetit të monitorimit të ujit të pijes;
-  Ndërtimi i akumulacioneve të reja ujore.

Toka (Dheu)

-  Instalimi i rrjetit të integruar të monitorimit të dheut;
-  Përgatitja e bazës ligjore mbi ruajtjen e dheut;
-  Identifikimi i zonave të ndotura dhe hartimi i programeve për rehabilitim;
-  Monitorimi i erozionit.

Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura

-  Zgjerimi i sipërfaqeve të mbrojtura;
-  Hartimi i planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura; Inventarizimi i plotë i florës, faunës dhe përgatitja e listës së kuqe të llojeve;
-  Definimi dhe shënjimi i kufijve të zonave të mbrojtura;
-  Hartografimi i plotë i zonave të mbrojtura.

Mbeturinat

-  Hartimi i planit strategjik për menaxhimin e mbeturinave;
-  Fuqizimi i institucioneve menaxhuese të mbeturinave;
-  Definimi i përgjegjësive dhe kompetencave;
-  Kompletimi i bazës ligjore për menaxhimin e mbeturinave;
-  Promovimi i riciklimit të mbeturinave;
-  Vetëdijesimi i popullatës lidhur me hedhjen e mbeturinave në vende adekuate dhe për kryerjen e obligimeve ndaj kompanive shërbyese;
-  Forcimi i institucioneve lokale lidhur me menaxhimin e mbeturinave;
-  Ndalimi i hedhjes së mbeturinave në deponi ilegale dhe në fushë hedhurina;
-  Hartimi i programeve për zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat;
-  Përforsimi i ndërmarrjeve menaxhuese të deponive.
-  Vetëm në QKU, në vitin 2005 janë regjistruar mbi 3000 raste të sëmundjeve të sistemit të frymëmarrjes, ndërsa në vitin 2006, rreth 3 mijë e 500 raste. Po ashtu, në vitin 2005 janë regjistruar mbi 2150 raste të sëmundjet infektive dhe parazitare, ndërsa në vitin 2006 rreth 2540 raste. Kjo tregon se rastet e sëmundjeve që janë të lidhura me problemet e mjedisit janë në rritje;
-  Kosova ka nivelin më të lartë të vdekjeve të foshnjave të porsalindura në Evropë me rreth 19 ‰, ku e 63 % e këtyre vdekjeve janë pasojë e sëmundjeve infektive.

4. Problematikat kryesore mjedisore që identifikohen nga Raporti për gjendjen e Mjedisit

Zbrazëtira ligjore

- ✎ Mungesa e disa ligjeve bazë si Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligjit për Vlerësim Strategjik Mjedisor, Ligjit për IPPC etj;
- ✎ Transpozimi i pjesshëm i ligjeve tona me Direktivat e BE-së;
- ✎ Mungesa e strategjisë për monitorimin e mjedisit, strategjisë së biodiversitetit, mungesa e planeve të veprimit për problemet themelore mjedisore;
- ✎ Definimi jo i qartë i kompetencave të institucioneve sipas ligjit etj.

Menaxhimi i Mjedisit

- ✎ Numri i vogël i institucioneve menaxhuese të mjedisit;
- ✎ Mungesa e planeve menaxhuese për zonat e mbrojtura;
- ✎ Implementimi jo i kënaqshëm i ligjeve ekzistuese;
- ✎ Mos respektimi i ligjit nga institucionet menaxhuese të mjedisit;
- ✎ Definimi jo i qartë i kompetencave të organeve menaxhuese mjedisore;
- ✎ Centralizimi i menaxhimit të mjedisit.

Mungesa e fondeve

- ✎ Numri i vogël i projekteve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit;
- ✎ Buxheti i limituar për mjedisin;
- ✎ Mungesa e ekofondit dhe fondeve tjera mjedisore;
- ✎ Menaxhimi jo efikas i fondeve ekzistuese;
- ✎ Mungesa e mekanizmave për thithjen e fondeve ndërkombëtare etj.

Monitorimi i mjedisit

- ✎ Mungesa e sistemit të monitorimit të ujit (monitorimi i pjesërisht);
- ✎ Mungesa e plotë e sistemit të integruar të monitorimit të ajrit;
- ✎ Mungesa e plotë e sistemit të monitorimit të dheut;
- ✎ Mungesa e softuerëve Corinair;
- ✎ Mungesa e laboratorëve mobile monitoruese etj.

Menaxhimi me mbeturinat

- ✎ Raporti identifikon se gjendja në deponitë e Kosovës nuk është e mirë;

- ✎ Numër i madhe i deponive të egra;
- ✎ Mungesa e mekanizmave efikase për grumbullimin dhe seleksionimin e mbeturinave;
- ✎ Mungesa e riciklimit të mbeturinave;
- ✎ Inkasimi i ulët për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.

Mungesa e të dhënave

- ✎ Nuk ka bazë të të dhënave për ujin, ajrin, dheun, mbeturinat, vajrat, mbeturinat tjera industriale etj;
- ✎ Mungesë të regjistrave EPR;
- ✎ Mungesë së të dhënave për çështje të caktuara mjedisore.

Shfrytëzimi i resurseve natyrore

- ✎ Shfrytëzim të pa pakontrolluar të inerteve nga shtretërit e lumenjve;
- ✎ Numër të madh të gurëthyesve;
- ✎ Prerje ilegale të pyjeve;
- ✎ Shfrytëzim pa kriter të resurseve ujore;
- ✎ Shfrytëzim të paqëndrueshëm të resurseve minerale;
- ✎ Mungesë e iniciativave dhe projekteve për shfrytëzimin e resurseve të ripërtrishme.

Shfrytëzimi i hapësirës

- ✎ Ndryshimi i destinimit të shfrytëzimit të tokës;
- ✎ Zgjerimi i vendbanimeve;
- ✎ Zgjerimi i komunikacionit rrugor;
- ✎ Krijimit të zonave të reja industriale;
- ✎ Fragmentimi i parcelave etj.

Bashkëpunimi me publikun

- ✎ Numri i vogël i broshurave informative;
- ✎ Mos përfshirja e publikut në vendimmarrje;
- ✎ Përfshirja e vogël e publikut në debate për çështje mjedisore;
- ✎ Mungesa e qendrave informative mjedisore;
- ✎ Mungesa e zyrave informative në zonat e mbrojtura.

Probleme tjera:

- ✎ Mungesa e impianteve për trajtimin e ujërave të zeza;
- ✎ Mungesa e ekspertëve për lëmi të caktuara mjedisore;
- ✎ Bashkëpunimi jo i mjaftueshëm në mes të institucioneve;
- ✎ Mungesa e hulumtimeve shkencore në fushën e mjedisit;
- ✎ Mungesa e programeve kualitative mjedisore në institucionet arsimore të Kosovës etj.

3. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E RAPORTIT NË FAKTE DHE SHIFRA

Ajri dhe ndryshimet klimatike

-  Në territorin e Kosovës (Prishtinë, Mitrovicë, Obiliq) gjatë periudhës 2004-2007, në disa raste është shënuar tejkalim i vlerave maksimale të lejuara të blozës, pluhurit dhe SO₂.
-  Vetëm përmes KEK-ut, Kosova i kontribuon ngrohjes globale me rreth 5.5 milion ton CO₂ brenda vitit. Vlerësohet se po aq sasi e CO₂ lirohet brenda një viti edhe nga komunikacioni dhe burimet tjera.

Uji

-  70 % e popullatës së Kosovës, furnizohet me ujë nga ujësjellësi publik;
-  Rreth 92 % e popullatës nëpër qytete pinë ujë të kloruar;
-  Rreth 60 % e popullatës rurale pinë ujë nga puset ku vetëm 1.2 % e tyre trajtohen me klor;
-  Rreth 30 % e popullatës ka qasje në rrjetin e kanalizimit.

Mbeturinat

-  Derisa rreth 90 % e popullsisë urbane mbulohet me mbledhjen e organizuar të mbeturinave, popullsia e zonat rurale mbulohet me vetëm rreth 10 %.
-  Sasia mesatare e gjenerimit të mbeturinave në Kosovë sillet rreth 2 kg./kokë banori në ditë.

Pylltaria dhe Biodiversiteti

-  Vetëm gjatë vitit 2007 rreth 6.682 ha e pyjeve të Kosovës është përfshirë nga zjarri. (Vlera e humbur e masës drusore në këmbim me euro është 2.942.338).
-  Nga prerjet ilegale të pyjeve mesatarisht gjatë vitit Kosova humb 10.471 m³ dru. Rreth 222.000 m³ të drurit teknik dhe drurit për djegie eksploatohet nga të dyja sektorët në vit. Ndërkohë që shtimi vjetor i masës drusore të pyjeve të Kosovës është 116.500 m³/vit, kurse pyllëzimet mesatare vjetore në Kosovë janë rreth 240 ha.
-  Në periudhën kohore 2004-2007 në Kosovë është shtuar numri i zonave të mbrojtura (mbi 20 zona të reja), por njëkohësisht është rritur ndikimi në këto zona. (Ndërtimet në Mirushë, Fshati turistik në Prevalë etj).

Bujqësia

-  Përderisa dendësia e banimit në Kosovë është rreth 204 banorë /km², sipërfaqja e tokës bujqësore për kokë banori është vetëm rreth 0.15-0.18 ha tokë, që është shumë më e vogël krahasuar me mesataren e BE-së (0.52 ha/banorë).
-  Vlerësohet se qindra hektarë tokë bujqësore në vit konvertohen në tokë ndërtimore.
-  Mesatarisht rreth 4 milion e 800 mijë kilogram pesticide përdoren brenda vitit në Kosovë, dhe ende nuk ka program specifik të monitorimit të përdorimit të pesticideve dhe të plehrave kimike.

Energjia

-  Krahasuar me vitin 2004 konsumi i energjisë së përgjithshme në Kosovë është rritur për 18 %;
-  Në konsumin e përgjithshëm të energjisë (2003-2006) nafta dhe nënproduktet e saj janë kontribuuesit kryesor me rreth 60%, energjia elektrike me 25,87 %, druri me rreth 20 %, thëngjilli me 2,67 %, ngrohja qendrore me rreth 1% dhe energjia solare me 0.1 %;
-  Edhe pse vlerësohet se Kosova ka potencial për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e energjisë alternative, vetëm 2 % e energjisë elektrike prodhohet nga këto burime, ndërsa 98 % e energjisë elektrike prodhohet nga thëngjilli.

Transporti

-  Kosova ka rreth 200 mijë automjete të regjistruara;
-  Mesatarisht në vit regjistrohen rreth 17 mijë automjete të reja;
-  Në periudhën 2005-2006, numri i fluturimeve nga aeroporti i Prishtinës ka arritur në rreth 5000 fluturime për vit. (Një ilustrim i thjeshtë: një aeroplan i tipit Boing 707 për 8 orë fluturim shpenzon sasinë e oksigjenit që e prodhojnë rreth 25 mijë hektarë pyje).

Shëndeti publik

-  Numri i rasteve me sëmundje ngjitëse dhe me epidemi në Kosovë, është ende në shkallë të lartë. Vetëm me diarre akute gjatë vitit 2005 kanë qenë rreth 40 mijë raste kurse gjatë vitit 2006 rreth 43 mijë. Numri i rasteve me pneumoni gjatë periudhës 2005-2006 ka qenë rreth 17 mijë. Rreth 100 raste në vit evidentohen me Tularemi, ndërsa më shumë se 1000 raste me TBC;

Shoqëria civile

- Në Kosovë për dallim nga viti 2002-2006, është dyfishuar numri i OJQ-ve, aktive mjedisore, por janë zvogëluar donacionet për mjedisin. Në rreth 50 % te komunave të Kosovës nuk ka asnjë OJQ mjedisore aktive. Shumica e OJQ-ve karakterizohen me staf të vogël dhe të pa specializuar, me mungesë të kushteve dhe pajisjeve për veprim, profilizim jo të qartë etj.

Edukimi Mjedisor

- Edhe përkundër faktit se niveli i përfshirjes së mbrojtjes së mjedisit në plan programet arsimore-edukative si në arsimin e ulët ashtu edhe në studimet bazë dhe studimet posdiplomike ka shënuar rritje të theksuar, numri dhe kualiteti i këtyre plan programeve ende nuk i kënaq nevojat dhe kërkesat që dalin përballë problemeve të mëdha mjedisore që ka Kosova.